• Да се направи увид и во работните простории на полициските службеници по случаен избор или по проценка забелешки: _____

• Увид во просториите за разговор и испитување - Дали просториите за распит/испитување имаат одредени обележја со цел заплашување или тортура? (користење лампи со кои може да се заслепи лицето, постоење палки и други средства за заплашување и/или нанесување физички или душевни страдања)
забелешки: _____

• Да се направи преглед на возилата со кои се врши превозот на лица на кои слободата им е ограничена забелешки: _____

• Проверка на други помошни простории (подруми, магацини, гаража и др.) забелешки: _____

ЧЕКОР 5: Разговор со задржани лица во моментот на посетата и со други службени лица

Тимот самиот ги избира лицата лишени од слобода со кои сака да разговара. Тимот треба да се осигура дека нема да разговара исклучиво со оние лица кои бараат да зборуваат со тимот, туку ќе вклучи и други лица по случаен избор или по проценка.

Разговорот со задржаните или приведени лица се спроведува во форма на интервју (согласно со Образец Б.2.), во целосна доверливост, без присуство и надзор од службените лица и со помош на преведувач доколку е потребно. Тимот исто така го врши и изборот на просторијата во која ќе се спроведе разговорот со лицата лишени од слобода.

Понатаму тимот разговара со службените лица вработени во полициската станица. Селекцијата на лицата со кои ќе се изврши разговор ја прави самиот тим, а во согласност со проценката направена на самото место, како и со времето кое го имаат на располагање службените лица, поточно разговорот со службеното лице не треба да го попречи нормалното одвивање на работните задачи и активности во рамки на полициската станица. Разговорот со овие лица се спроведува согласно Образец Б.1. Се препорачува разговорот да се изврши со неколку службени лица на различна хиерархиска поставеност во рамките на полицискиот систем. Разговорот секогаш треба да се води преку позитивен и конструктивен дијалог со почит кон интегритетот на службеното лице.

Тимот особено внимание при разговорите со лицата лишени од слобода и со службените лица посветува на темите поврзани со остварувањето на правата на лицата лишени од слобода кои им се загарантирани во полициската постапка, поточно дали на повиканите, задржаните или приведените лица им е повредено некое од следните законски права:

- известување за причините за лишувањето од слобода на јазик што го разбира
- поука за правото на бранител
- укажување лекарска помош
- известување член на семејството
- известување на дипломатско-конзуларно претставништво доколку е странски државјанин
- известување центар за социјална работа доколку станува збор за малолетно лице и постапување на инспектор за малолетници
- храна, вода и др.

■ Користи ги обрасците Б.2. (разговор со задржано лице) и Б.1. (разговор со службено лице)

ЧЕКОР 6: Разговор со раководно лице

Посетата тимот ја завршува со повторна средба со командирот или со друго раководно лице во полициската станица. Целта на овој разговор е накратко да се презентира утврдената состојба и конкретните проблеми идентификувани за време на посетата.

Исто така, за време на овој разговор треба да се предочат следните чекори што ќе следат по завршувањето на посетата, вклучително и подготвувањето писмен извештај што ќе биде доставен до раководното лице на полициската станица и до соодветните хиерархиско надредени полициски структури.

■ Користи го Образец Б.1.

ДРУГИ ЗАБЕЛЕШКИ:

Потпис од лицето кое го пополнило прашалникот:



AVOKATI I POPULLIT
MEKANIZMI PARANDALUES NACIONAL

RAPORTI VJETOR

Maj 2012, Shkup

PËRMBAJTJA

Shkurtesat

1. MANDATI DHE KOMPETENCAT E MEKANIZMIT PARANDALUES NACIONAL	101
A. Koncepti i torturës, trajtimi brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues	101
B. Protokolli Fakultativ i Konventës Kundër Torturës dhe Formave tjera të Trajtimit Brutal, Jonjerëzor, Nënçmues ose Ndëshkues (OPKAT)	102
C. Autorizimet e Mekanizmit Parandalues Nacional (MPN) konform OPKAT-it dhe roli i tij në shoqëri	104
2. MEKANIZMI PARANDALUES NACIONAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË	106
A. Themelimi i MPN në Republikën e Maqedonisë	106
B. Aktivitete promovuese dhe edukative	107
C. Përforcimi i kapaciteteve të Seksionit për parandalimin e torturës (MPN)	108
Ç. Dukshmëria dhe transparenca në punë	109
D. Aktivitete ndërkombëtare	109
3. VIZITA PARANDALUESE NË VITIN 2011	111
A. Stacionet policore	114
B. Institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe enti edukues-korrektues	126
C. Vende tjera të vizituara	143

Shkurtesat

EEK	Enti Edukues-Korrektues
KEDNj	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
IP	Institucion publik
KKT	Komiteti i KB-së Kundër Torturës
INK	Institucion Ndëshkues-Korrektues
KPT	Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
PNDQP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Qytetare dhe Politike
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
AP i RM	Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë
MPN	Mekanizmi Parandalues Nacional
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KB	Kombet e Bashkuara
OPKAT	Protokolli Fakultativ i Konventës së KB-së Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese
RNPR	Reparti për Ndikim të Përforcuar Riedukues
NPT	Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës
SP	Stacion policor
SPKP	Stacion policor me kompetencë të përgjithshme
RM	Republika e Maqedonisë
SPB	Sektori për Punë të Brendshme
DUDNj	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
UNHCR	Komisariati i Lartë i KB-së për Refugjatë
QPS	Qendra për Punë Sociale

4. MBROJTJA E TË MITURVE NË VENDET E PRIVIMIT NGA LIRIA 148

5. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME 156

6. PIKËPAMJE PËRFUNDIMTARE 160

Aneksi 1: Pasqyra e aktiviteteve të Mekanizmit Parandalues Nacional në vitin 2011 162

Aneksi 2:

Formulari A – Lista për kontrollin e përmbushjes së standardeve, të drejtave dhe kushteve në institucionet ndëshkuese-korrektuese (INK) dhe Entin Edukues-Korrektues (EEK) 164

Formulari B – Lista për kontrollin e përmbushjes së standardeve, të drejtave dhe kushteve, në stacionet policore 181



Të nderuar,

Përpara Jush është Raporti i parë vjetor për punën dhe vizitat e realizuara në vitin 2011 nga Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional.

Mekanizmi Parandalues Nacional filloi me punë në muajin prill të vitit 2011 si Seksion i veçantë për parandalimin e torturës dhe trajtimeve tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese, në përbërje të Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë. Rëndësia e këtij Mekanizmi qëndron në faktin se e ka fituar autorizimin si organ parandalues nacional dhe obligimin që rregullisht t'i vizitojë vendet e privimit nga liria, me qëllim të përcaktimit të gjendjeve dhe trajtimit me personat e privuar nga liria. Ky hap revolucionar na mundëson që në vazhdimësi ta monitorojmë gjendjen nëpër këto vende, të veprojmë me kohë sipas indikacioneve për torturë, në mënyrë adekuate t'i identifikojmë rreziqet dhe të kërkojmë shmangien e tyre.

Mekanizmi Parandalues Nacional, për një kohë relativisht të shkurtër, arriti të zë vendin e vet në shoqërinë tonë, roli i tij të jetë i dukshëm, ndërsa kompetencat dhe autorizimet të jenë identifikuese për organet e pushteti shtetëror. Së këtejmi, janë dhënë rezultatet e para konkrete përmes 18 vizitave të realizuara për të cilat janë hartuar raporte të veçanta me rekomandime përkatëse të cilët u janë dërguar organeve dhe institucioneve kompetente.

Por, ne nuk ndalemi këtu. E krijuam bazën, ndërsa gjatë periudhës së ardhshme kohore vazhdon sigurimi i plotë i të gjitha parakushteve të domosdoshme të cilat do të mundësojnë që ky Mekanizëm të zhvillohet në mënyrë përkatëse, të sigurojë profesionalizëm gjithëpërfshirës në punën e tij dhe ta realizojë obligimin për karakterin multidisiplinar të vizitave, këqyrjes dhe bisedave me personat e privuar nga liria.

Ju ftoj që seriozisht t'i rishqyrtoni dhe t'i merrni parasysh të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e Mekanizmit Parandalues Nacional. Vetëm në këtë mënyrë, si dhe përmes angazhimeve të përbashkëta për zbatimin efikas të rekomandimeve, Mekanizmi do ta realizojnë objektivin e Protokollit Fakultativ të Konventës Kundër Torturës, në kontekst të parandalimit të torturës dhe formave tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Me respekt,

Avokati i Popullit
Ixhet Memeti

1 MANDATI DHE KOMPETENCAT E MEKANIZMIT PARANDALUES NACIONAL

A. Koncepti i torturës, trajtimi brutal, jonjerëzor, nënçmues dhe ndëshkues

Me miratimin e Konventës së KB-së Kundër Torturës, nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, në muajin dhjetor të vitit 1984, përfundimisht u realizuan përpjekjet shumëdekadëshe për ndalimin absolut dhe universal të torturës. Edhe pse paraprakisht në disa akte universale ndalimi i torturës u përcaktua në mënyrë eksplicite, siç është Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj) dhe Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Qytetare dhe Politike (PNDQP), me Konventën Kundër Torturës të KB-së për herë të parë, në nenin 1, u dha përkufizimi i qartë për torturën.

Ky përkufizim, në mënyrë eksplicite i veçoi tri elemente të cilët e bëjnë veprën të patolerueshme dhe të ndëshkueshme:

- ekzistimi i qëllimit për të shkaktuar **dhimbje fizike, psikike ose vuajtje,**
- realizimi i **qëllimit** në drejtim të **marrjes së informatës, pranimit, frikësimit ose presionit,** dhe
- akti të jetë kryer nga **personi zyrtar,** i cili ka qenë person që vepron në cilësi zyrtare ose person i autorizuar nga ai.

Edhe pse Konventa e KB-së nuk ofron përkufizim të qartë për trajtimin brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues, megjithatë në praktikë, Komiteti i KB-së Kundër Torturës (KKT), duke i shqyrtuar raportet e shteteve-anëtare dhe duke vepruar sipas ankesave dhe komunikimeve individuale, konsideron se nuk ekziston përkufizim i qartë i akteve të përmendura më lartë, konform të cilëve do të dalloheshin nga tortura¹.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj), e miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1950, në mënyrë të prerë ndalon që dikush t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues². Edhe pse është njëri nga nenet më të shkurtër të Konventës, neni 3 është thelbësor për zhvillimin e shoqërisë demokratike, duke vendosur parimin për ndalimin absolut të torturës, ndërkaq përveç aspektit thelbësor përmban edhe aspektet procesuale, më saktësisht obligimin që shteti të ndërmerr hetime efektive dhe në kohë për pohimet për ekzistimin

¹ Paragrafi 3, Komenti i përgjithshëm i Komitetit të KB-së Kundër Torturës nr. 2 (CAT/C/GC/2), 24 janar 2008

² Neni 3, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës, 04 nëntor 1950

e torturës ose formave tjera të trajtimit jonjerëzore.

Ky nen, çdoherë duhet të lexohet në korrelacion me nenin 15 të Konventës, paragrafi 2 i të cilit nuk toleron asnjë shmangie nga parimi i ndalimit absolut të torturës në raste të gjendjes së luftës ose të gjendjes së jashtëzakonshme. Ndalimi absolut i torturës është konfirmuar edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në lëndën: "Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar"³ në mënyrë të prerë thotë se KEDNj e përcakton ndalimin e torturës dhe trajtimit jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues si kategori absolute, pa dallim të sjelljes ose akteve të kryera nga viktimat³. Neni 3 duhet të lexohet në korrelacion edhe me nenin 1 të KEDNj, përmes së cilit theksohen obligimet pozitive të shtetit për ta siguruar përmbushjen e të drejtës së garantuar me nenin 3, si dhe obligimin i cili përcakton se shtetet-anëtare janë përgjegjëse për çdo shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me KEDNj të çdo personi që është nën juridiksionin e tyre.

Për ta kuptuar tërësisht konceptin e torturës, është e rëndësishme të ceket edhe roli i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Jonjerëzor, Nënçmues ose Ndëshkues (KPT). Edhe pse KPT nuk është organ hetues, e as gjyqësor, ai e kryen funksionin e parandalimit jashtëgjyqësor në drejtim të mbrojtjes së personave të cilët janë privuar nga liria dhe mbrojtjes e cila orientohet kah tortura dhe format e tjera të keqpërdorimit, me çka e plotëson punën dhe është mekanizëm komplementar i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. KPT-ja vepron në mënyrë parandaluese përmes sistemit të vizitave të regullta dhe vizitave ad hoc, ndërsa shteti aderues ndaj Konventës Evropiane për Parandalimin e Torturës e ka për detyrë që Komitetit t'i mundësojë qasje dhe lëvizje në territorin e tij pa kurrfarë kufizimesh, qasje deri te të dhënat për vendet e privimit nga liria dhe qasje deri te vendet e privimit nga liria sipas zgjedhjes së KPT-së.

B. Protokollit Fakultativ Kundër Torturës dhe Formave tjera të Trajtitit Brutal, Jonjerëzor, Nënçmues ose Ndëshkues (OPKAT)

Edhe pse obligimi për ndalimin e torturës dhe formave tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues është përcaktuar në mënyrë eksplicite me një sërë dokumente dhe konventa ndërkombëtare, gjendja në botë akoma nuk e ka arritur shkallën e çrrënjësjes së plotë të torturës. Duke e pasur parasysh luftën shumëdekadëshe kundër torturës dhe nevojën për ngritjen e vetëdijes dhe përgjegjësisë së autoriteteve shtetërore, në drejtim të ndalimit të plotë dhe absolut të kësaj të keqe, shtetet-anëtare të OKB-së, konsideruan se është e domosdoshme ndërmarrja e masave plotësuese

³ Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar, 18 janar 1978, seria A nr. 25

në mënyrë që të arrihen objektivat e Konventës Kundër Torturës. Ato konsideruan se mbrojtja e personave të privuar nga tortura dhe format e tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues, mund të përforcohet me mjete jashtëgjyqësore me karakter parandalues, përmes vizitave të rregullta nëpër vendet e privimit nga liria. Në këtë kontekst, u zhvillua ideja për miratimin e Protokollit Fakultativ të Konventës së KB-së Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese (OPKAT).

Në muajin mars të vitit 2002, teksti i OPKAT-it u paraqit para Komisionit të KB-së për të Drejtat e Njeriut me propozim-rezolutë të hartuar nga Kosta Rika, që më pas edhe zyrtarisht, pas disa debateve dhe diskutimeve, të miratohet më datë 18 dhjetor të vitit 2002 nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. OPKAT huri në fuqi në vitin 2006, pasi e ratifikuan 20 shtetet-anëtare të OKB-së.

OPKAT-i krijoi një sistem me dy nivele të parandalimit të torturës – në nivel ndërkombëtar u formua Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës (NPT), ndërsa në nivel nacional shtetet e morën obligimin që një vit pas ratifikimit të OPKAT-it të themelojnë mekanizëm parandalues nacional (MPN), i cili do t'i ndërmerr kompetencat në përputhje me Protokollin Fakultativ. Roli i NPK në mënyrë të konsiderueshme dallon nga mandati i organeve tjera të themeluara me instrumentet për të drejtat e njeriut: NPT realizon vizita në vendet e privimit nga liria, jep rekomandime për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara dhe MPN-ve u jep këshilla dhe udhëzime në aspekt të rolit parandalues të cilin e kanë në shoqëri.

Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës (NPT) përbëhet nga 25 anëtarë, të cilët zgjidhen nga radhët e personave me virtyte të larta morale, me përvojë profesionale në fushën e zbatimit të të drejtave, ndërsa në veçanti në fushën e të drejtës penale, menaxhimit me burgjet ose në kuadër të policisë apo në fusha të ndryshme relevante për veprimin me personat e privuar nga liria⁴.

Shtetet aderuese ndaj OPKAT-it e kanë për detyrë që në territorin e tyre ta pranojnë Nënkomitetin për Parandalim dhe t'u lejojnë qasje në vendet e privimit nga liria, t'ua sigurojnë të gjitha informatat relevante të cilat mund t'i kërkojë NPT-ja, si dhe t'i rishikojnë rekomandimet e Nënkomitetit për Parandalim dhe të vendosin dialog me të për masat e mundshme për zbatim⁵. Ndonëse themelohet si mekanizëm i ri, megjithatë në pjesë të caktuara, mandati dhe kompetencat e NPT-së ndërthuren edhe me mekanizma tjerë të OKB-së, siç janë: Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Komiteti Kundër Torturës dhe Raportuesi Special për Torturë, kështu që me rëndësi thelbësore është komunikimi i ndërsjellë dhe koordinimi i aktiviteteve të tyre.

⁴ Neni 5 i Protokollit Fakultativ të Konventës së KB-së Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese (OPKAT), Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (A/RES/57/199) nga data 18.12. 2002.

⁵ Neni 12 nga Protokollit Fakultativ të Konventës së KB-së Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese (OPKAT), Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (A/RES/57/199) nga data 18.12. 2002.

Në përputhje me nenin 16 të OPKAT-it, NPT-ja në mënyrë konfidenciale do t'ia kumtojë rekomandimet dhe pikëpamjet e veta shtetit aderues, ndërkaq e publikon edhe raportin e vet, bashkë me të gjitha komentet e shtetit aderues konkret, gjithmonë kur një gjë e tillë kërkohet nga ai nga ana e shtetit aderues.

C. Autorizimet e Mekanizmit Parandalues Nacional (MPN), konform OPKAT-it dhe roli i tij në shoqëri

Risia e vërtetë e cila u vendos me OPKAT-in është formimi i mekanizmeve parandalues nacional. Rëndësia e këtij mekanizmi qëndron në faktin se për herë të parë i besohet autorizimi parandalues një trupi nacional i përbërë nga ekspertë, si dhe obligimi që rregullisht të realizojë vizita nëpër vendet ku bëhet privimi nga liria dhe t'i konstatojë gjendjet dhe veprimet me personat e privuar nga liria. Ky hap revolucionar mundëson monitorim të vazhdueshëm të gjendjeve në këto vende, veprimin në kohë sipas indikatorëve për torturë, identifikimin përkatës të rreziqeve dhe kërkesës për eliminimin e tyre. Duke e marrë parasysh përbërjen e tij, MPN-ja ka mundësi që përmes prizmit multi-disiplinar ta shqyrtojë ndikimin e të gjithë faktorëve në kontekst nacional, t'i konstatojë gjendjet dhe në mënyrë përkatëse të përpilojë rekomandime të cilët do të jenë real, të matshëm dhe të realizueshëm. Së këtejmi, ky Mekanizëm fillimisht përherë duhet të udhëhiqet dhe veprorë në përputhje me standardet ndërkombëtare, të drejtën zakonore dhe praktikën gjyqësore të gjykatave dhe organeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në pjesën e mbrojtjes nga tortura dhe trajtimit me personat e privuar nga liria.

Mekanizmi Parandalues Nacional, në përputhje me OPKAT-in, ka kompetencë⁶:

a) rregullisht ta kontrollojë veprimin me personat e privuar nga liria në vendet e privimit nga liria, siç është përcaktuar në nenin 4, me qëllim të përforcimit, nëse është e nevojshme, të mbrojtjes së tyre nga tortura dhe format e tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues;

(b) organeve relevante t'u jep rekomandime me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe veprimin me personat e privuar nga liria dhe pengimin e torturës dhe formave tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues dhe ndëshkues, duke i pasur parasysh normat relevante të Kombeve të Bashkuara;

(c) të paraqes propozime dhe pikëpamje në lidhje me legjislacionin ekzistues ose projektligjet.

Në mënyrë që Mekanizmi Parandalues Nacional të mund t'i zbatojë në

praktikë kompetencat e tij, OPKAT-i në nenin 20 i jep MPN-së autorizime për⁷:

(a) qasje deri te të gjitha informatat të cilat kanë të bëjnë me numrin e personave të privuar nga liria, siç është përcaktuar në nenin 4, si dhe deri te numri i vendeve dhe lokacionet e tyre;

(b) qasje deri te të gjitha informatat, të cilat kanë të bëjnë me veprimin me ata persona, si dhe kushtet e privimit të tyre nga liria;

(c) qasje deri te të gjitha vendet e privimit nga liria dhe instalimet në objektet e tyre;

(ç) mundësi për biseda pa mbikëqyrje me personat e privuar nga liria, pa dëshmitarë edhe atë personalisht ose me përkthyes, nëse një gjë e tillë konsiderohet e domosdoshme, si dhe për çdo person tjetër për të cilin mekanizmat parandalues nacional konsiderojnë se mund të japin informata relevante;

(d) liri për t'i zgjedhur vendet të cilat dëshiron t'i vizitojë dhe personat me të cilët dëshiron të bisedojë;

(dh) liri të kontaktojë me NPT, t'i dërgojë informata dhe të mbajë takime me të.

Mekanizmi Parandalues Nacional e ka për detyrë t'i ruaj në konfidencë informatat të cilat janë shkëmbyer me të nga ana e organeve të pushtetit shtetëror dhe personat e privuar nga liria dhe nuk guxon të publikojë kurrfarë të dhënash personale pa pëlqimin e dhënë qartë nga personi.

⁶ Neni 19 Protokollit Fakultativ të Konventës së KB-së Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese (OPKAT), Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (A/RES/57/199) nga data 18.12. 2002.

⁷ Neni 20 Protokollit Fakultativ të Konventës së KB-së Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese (OPKAT), Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (A/RES/57/199) nga data 18.12. 2002.

2 MEKANIZMI PARANDALUES NACIONAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

A. Themelimi i MPN në Republikën e Maqedonisë

Republika e Maqedonisë, më datë 01.09.2006, e nënshkroi Protokollin Fakultativ të Konventës Kundër Torturës. Në periudhën që pasoi u mbajt një tryezë e rrumbullakët dhe takime në të cilët në një vend u mblodhën përfaqësues nga: institucionet qeveritare, sektori qytetar dhe Avokati i Popullit, me qëllim të analizimit të të gjitha çështjeve të hapura, të shqyrtimit të praktikave dhe përvojave pozitive nga vendet e tjera, në kontekst të themelimit të këtij mekanizmi në nivel nacional. Duke i pasur parasysh propozimet të cilat u dhanë në drejtim të implementimit të nenit 17 të OPKAT-it nga ana e Republikës së Maqedonisë, subjektet relevante në shtet ndërtuan qëndrim në aspekt të mbështetjes që MPN-ja të themelohet si pjesë përbërëse e Avokatit të Popullit, ndërkaq të respektohen parakushtet themelore për pavarësinë funksionale dhe operative të këtij Mekanizmi.

Më datë 30.12.2008, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e ratifikoi Protokollin Fakultativ Kundër Torturës dhe Trajttimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese, ndërsa Avokatin e Popullit e caktoi të vepronte si Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN) në Republikën e Maqedonisë. Në bashkëpunim dhe me pëlqim paraprak të Avokatit të Popullit, organizatat e regjistruara joqeveritare dhe organizatat të cilat kanë statusin e organizatave humanitare në Republikë mund të ndër marrin disa nga kompetencat e Mekanizmit Parandalues Nacional⁸. Ishte krejtësisht i natyrshëm dhe i pritshëm që roli i Mekanizmit Parandalues Nacional t'i besohet Avokatit të Popullit, para së gjithash duke e pasur parasysh rolin e tij kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve dhe në veçanti rolin e fituar në vitin 2003 në kontekst të monitorimit të gjendjeve dhe respektimit të të drejtave të personave në organet, organizatat dhe institucionet në të cilat kufizohet liria e lëvizjes⁹. Gjatë periudhës kohore 2005-2010, Avokati i Popullit e realizoi këtë kompetencë ligjore përmes këqyrjeve dhe vizitave pa paralajmërim paraprak, ndërkaq me personat e arrestuar, ndaluar ose personat të cilët vuajnë dënimin me burgim bisedonte pa prezencën e personave zyrtarë.

Pas kaktimit të Avokatit të Popullit për Mekanizëm Parandalues Nacional në Republikën e Maqedonisë, institucioni filloi të punojë në ngritjen

⁸ Neni 4, Ligji për ratifikimin e Protokollit Fakultativ të Konventës së KB-së Kundër Torturës dhe Trajttimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 165/2008)

⁹ Neni 31, Ligji për Avokatin e Popullit ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 60/2003)

e vetëdijes për rëndësinë e këtij roli të ri të Avokatit të Popullit tek palët e interesuara. Kështu, gjatë vitit 2009 me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup u mbajtën dy konferenca dhe tri tryeza të rrumbullakëta të cilat iu përkushtuan implementimit të Protokollit Fakultativ, ndërsa në vitin 2010 Avokati i Popullit, në bashkëpunim me sektorin joqeveritar, zbatoi dhe në mënyrë aktive mori pjesë në trajnimet e dedikuara për nëpunës policorë dhe të punësuar në institucionet ndëshkuese-korrektuese.

Pas miratimit të Ligjit për ratifikimin e Protokollit Fakultativ të Konventës së KB-së Kundër Torturës dhe Trajttimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese nga ana e Republikës së Maqedonisë, me të cilin Avokati i Popullit u caktua si Institucion për Parandalimin e Torturës, u ndër morën hapa konkret për themelimin e tij.

Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Avokatin e Popullit, nga muaji shtator 2009, u përforcua roli i Avokatit të Popullit në aspekt të monitorimit të gjendjeve me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave në organet, organizatat dhe institucionet në të cilët liria e lëvizjes është e kufizuar. Me këto ndryshime ligjore, në kuadër të Avokatit të Popullit, u formua Seksioni i veçantë detyrë themelore e të cilit është mbrojtja nga tortura dhe format e tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Mekanizmi Parandalues Nacional në Republikën e Maqedonisë, mandatin dhe kompetencat e tij i absolvon nga Protokollin Fakultativ i Konventës së KB-së Kundër Torturës dhe Trajttimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese dhe Ligji për Avokatin e Popullit, ndërkaq ka hartuar edhe Rregulloren të posaçme për kryerjen e parandalimit dhe Metodologjinë për mënyrën e zbatimit të vizitave parandaluese. Mekanizmi Parandalues Nacional aktivitetet e veta i zbaton në përputhje me programin vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit.

Mekanizmi Parandalues Nacional në Republikën e Maqedonisë filloi të funksionojë më datë 01 prill të vitit 2011, ndërsa në përbërje të tij ka tre këshilltarë për parandalimin e torturës dhe trajttimeve tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese.

B. Aktivitete promovuese dhe edukative

Fill pas themelimit të Mekanizmit Parandalues Nacional, nisi zbatimi i aktiviteteve promotive dhe edukative në drejtim të informimit të publikut të gjerë me rolin e MPN në shoqëri. Këto aktivitete u mbështetën nga Misioni i OSBE-së në Shkup dhe Projekti "Tuining" ku mori pjesë zyra e Ombudsmanit të Spanjës dhe Mediatorit të Francës.

Në kontekst të promovimit publik, Avokati i Popullit mbajti konferencë për shtyp në të cilën u promovua Mekanizmi i ri për Parandalimin e Torturës.

Njëkohësisht, MPN-ja dërgoi njoftim me shkrim pranë organeve dhe institucioneve kompetente për autorizimet e veta, realizoi takime me ud-

hëheqës të institucioneve relevante, përpiloi fletëpalosje në tetë gjuhë dhe përmbledhje të rregullave relevante në tri gjuhë, ndërkaq pati edhe prezantim për mandatin dhe kompetencat para studentëve në katër fakultete të shkencave juridike në Republikë, si dhe në Fakultetin për Siguri.

Në pjesën e promovimit të Mekanizmit Parandalues Nacional, u mbajtën katër tryeza të rrumbullakëta në nivel lokal me mbështetjen e Misionit të OSBE-së dhe SIDA-s dhe një tryezë e rrumbullakët dyditore në nivel qendror përmes Projektit "Tuining", me qëllim dhe në kontekst të njohjes së të punësuarve në organet dhe institucionet e privimit nga liria me rolin dhe mandatin e MPN-së.

Përfaqësues i Mekanizmit Parandalues Nacional mori pjesë në tryezën e rrumbullakët me temë: "Të drejtat dhe praktikatat me refugjatë", në organizim të UNHCR-së Shkup dhe Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, ku mbajti fjalim me temën: "Kompetencat e Avokatit të Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional", me theks të veçantë për mënyrën e zbatimit të vizitës në Qendrën për Azilkërkues.

C. Përforcimi i kapaciteteve të Seksionit për parandalimin e torturës (NPM)

Në vitin 2011, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së dhe përmes Projektit "Tuining", të mbështetur nga Bashkimi Evropian, ku marrin pjesë zyrat e ombudsmanëve të Spanjës dhe Francës, me qëllim të përforcimit të kapaciteteve të seksioneve të formuara të reja, ndërsa veçanërisht të Seksionit për parandalimin e torturës dhe trajtimeve tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese (Mekanizmi Parandalues Nacional), u realizuan dy udhëtime studimore në Spanjë dhe Poloni ku u vizituan disa vende të privimit nga liria.

Në Shkup u mbajtën dy takime pune me MPN të Spanjës, në të cilët u diskutua për mënyrat e zbatimit të vizitave të rregullta nëpër vendet ku personat privohen nga liria, qasja parandaluese e vizitave, metodologjia e përgatitjes së raportit vjetor dhe raporteve të veçanta të Mekanizmit Parandalues Nacional, si dhe çështje të tjera të cilat janë me interes për këto organe parandaluese, të cilat janë formuar në përputhje me OPKAT-in. Si pjesë e aktiviteteve të përbashkëta me MPN të Spanjës u realizua edhe vizita në Stacionin Policor Gazi Babë.

Me qëllim të forcimit të MPN-së u zbatuan edhe dy trajnime të cilat u mbështetën nga Misioni i OSBE-së në Shkup dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Trajnimi i parë, i cili kishte të bënte me realizimin e vizitave parandaluese në INK, u realizua në Burgun Prilep dhe u drejtua nga z. Alesh Butala – ish-anëtar i KPT-së, pranë Këshillit të Evropës. Trajnimi i dytë u orientua kah realizimi i vizitës parandaluese në institucionin psikiatrik në Spitalin Psikiatrik Shkup, nën drejtimin e z. Vladimir

Ortakov, nënkryetar i parë i atëhershëm në KPT-së.

Ç. Dukshmëria dhe transparenca në punë

Mekanizmi Parandalues Nacional, në ueb faqen e Avokatit të Popullit, i prezantoi të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2011, si dhe kohë pas kohë u paraqit me njoftime edhe nëpër media. Avokati i Popullit, si Mekanizëm Parandalues Nacional publikoi informata të shkurtra për të gjitha aktivitetet e veta, vizitat e realizuara dhe iniciativat e dhëna, në linkun e mëposhtëm:

http://www.ombudsman.mk/ombudsman/MK/nacionalen_preventiven_mehanizam

MPN-ja konsideron se transparenca në punë e ngrit vetëdijen tek qytetarët e Republikës së Maqedonisë dhe shërbimet e organeve dhe institucioneve për privim nga liria për gjendjen në vendet e privimit nga liria dhe për trajtimin dhe realizimin e të drejtave të kësaj kategorie të personave.

D. Aktivitete ndërkombëtare

Në kuadër të aktiviteteve ndërkombëtare, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), në Ohër u mbajt konferenca rajonale për "Rolin e ombudsmanëve në luftën kundër diskriminimit dhe parandalimit të torturës".

Mekanizmi Parandalues Nacional mori pjesë në takimet në: Talin, Estoni, të organizuara dhe mbështetura nga Këshilli i Evropës me temë: "Grumbullimi dhe kontrollimi i informatave gjatë kohës së vizitave nga MPN", si dhe në Baku, Azerbajxhan, me temë: "Mbrojtja e kategorive të vulnerabile në vendet e privimit nga liria". Të dy takimet e punës, si dhe Takimi i tretë vjetor i Rrjetit Evropian të Mekanizmave Parandalues Nacional ishin pjesë të Projektit të Këshillit të Evropës për formimin e rrjetit aktiv të trupave parandaluese nacionale.

Në takimin e tretë vjetor të Rrjetit Evropian të Mekanizmave Parandalues Nacional, Mekanizmi Parandalues Nacional i Maqedonisë u prezantua me temën: "Si të arrihet realizimi i rekomandimeve – Dialogu dhe bashkëpunimi midis organeve nacionale dhe organeve ndërkombëtare për parandalimin e torturës".

Në aktivitetet ndërkombëtare, nën patronazhin e Këshillit të Evropës, MPN-ja e Maqedonisë bashkë me kolegët e MPN-së shqiptare realizuan vizitë pune të MPN-së në Republikën e Sllovenisë ku realizuan vizitë të përbashkët në një institucion ndëshkues-korrektues.

Përfaqësues i MPN-së mori pjesë edhe në Forumin Botëror për shënimin e pesë vjetorit të hyrjes në fuqi të Protokollit Fakultativ të Konventës kundër

Torturës, në organizim të Asociacionit për Parandalimin e Torturës (APT). Forumi i mbledhi në një vend të gjithë aktorët relevantë në nivel ndërkombëtar dhe nacional në fushën e parandalimit nga tortura.

Delegacioni i Ombudsmanit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile nga Republika e Kosovës realizuan takim me z. Ixhet Memetin, Avokat i Popullit i Republikës së Maqedonisë dhe shef i Mekanizmit Parandalues Nacional (MPN), si dhe me anëtarët e Mekanizmit Parandalues Nacional. Qëllimi i vizitës ishte njohja me procesin e themelimit të Mekanizmit Parandalues Nacional në Republikën e Maqedonisë, procesin e ratifikimit të Protokollit Fakultativ të Konventës kundër Torturës dhe sidomos hapjen e seksionit të veçantë parandalues në përbërje të Avokatit të Popullit.

3 VIZITA PARANDALUESE NË VITIN 2011

Në vitin 2011, MPN-ja realizoi gjithsej 18 vizita parandaluese, prej të cilave numri më i madh ose 12 ishin nëpër stacione policore me kompetencë të përgjithshme, tri në institucione ndëshkuese-korrektuese, një vizitë në entin edukues-korrektues, një në Institucionin Publik për Përkujdesje, Edukim dhe Arsim të Fëmijëve dhe të Rinjve dhe një në Qendrën për Vendosjen e Personave Azilkërkues (Aneksi 1). Të gjitha vizitat u zbatuan në përputhje me planin vjetor paraprakisht të përcaktuar dhe të aprovuar nga Seksioni për parandalimin e torturës dhe trajtimeve tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese.

Nga gjithsej 18 vizita vetëm një u realizua me paralajmërim (Burgu Shkup), ndërsa 17 të tjerat u zbatuan pa paralajmërim, me qëllim të përcaktimit objektiv të gjendjeve në vendet e privimit nga liria dhe vendet ku liria e lëvizjes është ose mund të jetë e kufizuar. Gjatë realizimit të këtyre vizitave, MPN-ja hasi në bashkëpunim konstruktiv nga ana personave zyrtarë dhe realizoi këqyrje papengesë në të gjitha ambientet, si dhe të gjitha bisedat i zhvilloi duke e bërë vet përzgjedhjen e personave, më saktësisht në asnjë rast nuk iu kufizua hapësira e lëvizjes e as liria e përzgjedhjes së personave për bisedë.

Në vitin 2011, MPN-ja nuk arriti t'i vizitojë për së dyti këto institucione – duke e pasur parasysh se MPN-ja filloi me punë në muajin prill të vitit 2011 kështu, që me qëllim që të bëhet vlerësimi i nivelit të implementimit të rekomandimeve, vizitat do të ripërsëriten dhe zbatohen në gjysmën e dytë të vitit 2012.

Të gjitha vizitat u realizuan nga ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional, i përbërë nga tre këshilltarë për parandalimin e torturës dhe trajtimeve tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese.

Metodologjia e realizimit të vizitës parandaluese (Aneksi 2)

Nga praktika e deritanishme e MPN-së, vizitat mund të zgjasin prej një deri tre ditë, në një vend të privimit nga liria. Vizita zbatohet në disa hapa.

Hapi 1: Biseda me personin udhëheqës

Gjatë fillimit të vizitës së rregullt të paparalajmëruar, në një vend të privimit nga liria, biseda zhvillohet me drejtorin (komisarin) ose me person tjetër udhëheqës i cili në atë moment mban pozicionin më të lartë në hierarkinë e institucionit. Biseda zhvillohet në përputhje me formularët: A.1. (në

rast të vizitës së institucionit ndëshkues-korrektues, edukues-korrektues ose vend tjetër të privimit nga liria) dhe B.1. (në raste të vizitës së stacionit policor) – Aneksi 2.

Gjatë kohës së këtyre takimeve, ekipi i MPN-së e informon personin udhëheqës me qëllimet e vizitës, mandatin dhe kompetencën e mekanizmit parandalues, hapat të cilët do të ndërmerren, lirinë e përzgjedhjes së personave të privuar nga liria me të cilët do të bisedojë, të punësuarit me të cilët do të bisedojë, ambientet dhe instalimet të cilët do të vizitohen dhe regjistrat e evidencat të cilat do të kontrollohen.

Hapi 2: Vizita në vendet e ndalimit

Vizita zbatohet me qëllim që të perceptohen kushtet materiale të vendosjes në vendet e privimit nga liria, kushtet në ambientet e përbashkëta, ambientet e punës, ambientet për rekreacion, ambientet e ambulancave, toaletet, ambientet për kontroll dhe ekzaminim, ambientet për zhvillimin e bisedës me mbrojtësin, familjen dhe personat zyrtarë, ambientet për shëtitje në natyrë etj.

Ekipi i këshilltarëve, gjatë vizitës së ambienteve për ndalim, kapaciteteve të vendosjes dhe ambienteve tjera, veçanërisht do të analizojë nëse për çdo person i cili është privuar nga liria është siguruar krevat me dyshek dhe shtroje, mënyrën e vendosjes nëpër dhoma dhe kapacitetin e tyre, numrin maksimal të personave të vendosur në një ambient/dhomë për bujtje, do të bëjë vlerësimin e nivelit të higjienës, nëse ambienti i përmbush standardet minimale për vendosje (sipërfaqe, ndriçim natyror, ngrohje, ventilim etj.).

Hapi 3: Biseda me personat e privuar nga liria

Ky hap zbatohet paralelisht me Hapin 2. Ekipi i MPN-së e ka lirinë e përzgjedhjes së personave me të cilët do të bisedojë, si dhe mundësinë që bisedën ta zhvillojë në mënyrë konfidenciale, pa praninë e personave zyrtarë ose personave të tretë. Biseda me personat e privuar nga liria zbatohet në përputhje me formularët paraprakisht të përcaktuar për bisedë – Formulari pyetësor A.2. për persona të dënuar dhe persona të paraburgosur dhe Formulari pyetësor B.2. për persona të ndaluar në stacion policor.

Hapi 4: Biseda me të punësuarit e shërbimeve

Biseda me personat e punësuar nëpër shërbime, në vendet e privimit nga liria, zbatohet në përputhje me rendin e përcaktuar të pyetjeve për personin e punësuar në shërbimin përkatës, ndërsa konform formularëve: A.1. (në rast të vizitës së institucionit ndëshkues-korrektues, edukues-korrektues ose në vend tjetër të privimit nga liria) dhe B.1. (në rast të vizitës së stacionit policor).

Hapi 5: Këqyrja në evidencë dhe regjistra

Ekipi i MPN-së, gjatë vizitës në vendet e privimit nga liria, realizon këqyrje në regjistrat dhe evidencat përkatëse për personat e dënuar dhe të paraburgosur (konform Formularit A) dhe evidencat dhe regjistrat për personat e ndaluar (konform Formularit B) Aneksi 2.

Hapi 6: Biseda përfundimtare me personin udhëheqës

Biseda zbatohet me personin e njëjtë udhëheqës me të cilin në fillim të vizitës është zhvilluar biseda fillestare apo me person tjetër udhëheqës të pozicionuar në hierarkinë më të lartë të institucionit. Gjatë bisedës përfundimtare, ekipi i MPN-së i prezanton të dhënat dhe vërejtjet e veta fillestare të bëna në pah me personin udhëheqës dhe e informon se analiza e detajuar për vizitën do të pasojë me rekomandime përkatëse në formë të raportit të veçantë, i cili do t'i dërgohet institucionit dhe organit më të lartë të hierarkisë (ministriisë).

Raporti i veçantë

Mekanizmi Parandalues Nacional për çdo vizitë të realizuar harton raporte të veçanta. Raportet e veçanta të MPN-së janë me karakter konfidencial dhe përmbajnë analizën e gjendjeve, konstatimet dhe rekomandimet për tejkalimin e mangësive të konstatuara. Për të gjitha 18 vizitat e zbatuara gjatë vitit 2011 janë hartuar dhe adresuar raporte të veçanta. Çdo raport përmban gjendjet pozitive dhe negative, si dhe rekomandimet në dy nivele:

- pranë organit udhëheqës të institucionit ose entit që është vizituar, në lidhje me gjendjet të cilat janë në kompetencë të atij organi dhe në cilin aspekt mund të tejkalohen gjendjet e konstatuara negative përmes ndërmarrjes së veprimeve dhe masave të caktuara nga ana e vet institucionit ose organit, dhe
- pranë organit më të lartë të hierarkisë (ministra), të cilët kërkojnë përmbushjen e parakushteve të caktuara teknike-materiale, implikime buxhetore, ndryshime të akteve ligjore ose nënligjore, me qëllim të përmirësimit të mangësive të konstatuara.

A. STACIONET POLICORE

Në periudhën nga data 30 qershor deri më datë 31 dhjetor të vitit 2011, Mekanizmi Parandalues Nacional zbatoi gjithsej 12 vizita nëpër stacione policore me kompetencë të përgjithshme (SPKP) të cilat, në përputhje me aktvendimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, janë caktuar si vende për ndalimin e personave¹⁰. Në përputhje me këtë aktvendim, ndalimi zbatohet në të gjitha 38 stacionet policore me kompetencë të përgjithshme të cilët janë kompetentë të kryerjen e drejtpërdrejt të punëve policore për zonë të caktuar, siç është përcaktuar me Ligjin për policinë¹¹.

Vizitat nëpër stacionet policore u zbatuan në përputhje me Programin vjetor të MPN-së dhe Planin për zbatimin e vizitave parandaluese, të aprovuara nga Avokati i Popullit. Gjatë përzgjedhjes së stacioneve policore, MPN-ja udhëhiqej nga disa kritere, por para së gjithash nga përfaqësimi adekuat gjeografik i pjesëmarrjes së barabartë të SPKP-ve me ambiente të vjetra dhe të rinovuara për ndalimin e personave, ndërkaq në drejtim të krijimit të pasqyrës objektive për gjendjen dhe trajtimin e personave të ndaluar në stacionet policore të Republikës së Maqedonisë.

Pas zbatimit të vizitave të ndara, MPN-ja hartoi raporte të veçanta të cilët iu dërguan komisarëve të SPKP-ve përkatëse dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në përputhje me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit, personat zyrtarë në organe, organizatat dhe institucionet në të cilat kufizohet liria e lëvizjes, janë të detyruar të veprojnë sipas sugjerimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe për veprimin ta njoftojnë më së voni në afat prej 30 ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të raportit të veçantë. Konform obligimit të përcaktuar ligjor, Avokati i Popullit si MPN mori përgjigje nga të gjitha 12 stacionet policore të cilët u vizituan gjatë vitit 2011, si dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme në lidhje me rekomandimet e dërguara. Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se sa u përket të gjitha 12 raporteve të veçanta MPN-ja nuk pranoi njoftim kthyes brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të tyre, më saktësisht madje në 8 raste u dërguan urgjenca për shkak të mosrespektimit të afatit të përcaktuar me ligj. Kjo i referohet konstatimit se edhe përkrah zbatimit të edukimit dhe informatave të dërguara për kompetencat dhe mandatin e MPN-së, në Republikën e Maqedonisë në praktikë ekziston nevojë reale për zbatim të vazhdueshëm dhe thellim të aktiviteteve edukative, në veçanti në pjesën e obligimeve të cilat u referohen organeve dhe institucioneve si vende për pranim nga liria.

¹⁰ Aktvendimi për përcaktimin e stacioneve policore për ndalimin e personave Nr. 13.1-33683/1 nga data 17.05.2007 ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 83/2007)

¹¹ Neni 23, Ligji për Policinë ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 114/2006)

Kushtet materiale

Ambientet për ndalim

Gjatë vizitave të zbatuara, u realizua këqyrje në 7 SPKP me ambiente të vjetra për ndalim dhe në 5 SPKP në të cilat ambientet për ndalim janë të reja dhe të rinovuara, në përputhje me Projektin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të realizuar me mbështetje teknike-financiare nga Bashkimi Evropian. Në stacionet policore, ku nuk janë rinovuar dhe as ndërtuar ambiente të reja për ndalim gjendja është shqetësuese. Pjesa më e madhe e këtyre stacioneve policore për ndalim ndodheshin në ambiente bodrumi-qilari, ndërsa në një rast madje dy kate në nivelin përdhes. MPN-ja konsideron se gjendja e këtyre bie ndesh me standardet ndërkombëtare për vendosjen e personave të ndaluar. Ambientet për ndalim nuk i përmbushin standardet minimale në aspekt të madhësisë së vendit për ndalimit. Në Stacionin Policor Makedonski Brod nuk ekziston ambient i veçantë për ndalimin e personave të privuar nga liria me përmbushje minimale të standardeve. Në këtë Stacion ambientet e rinovuara të podrumit nuk shfrytëzohen sepse, për shkak të lagështisë së madhe, ato janë të pashfrytëzueshme, prandaj personat udhëheqës kanë vendosur të shfrytëzojnë një zyrë të vjetër zyrtare si ambient për ndalim, ndërsa një zyrë tjetër zyrtare të parinovuara si ambient ndihmës për ndalim.

Në tri stacionet policore (Aerodrom, Kriva Pallankë dhe Çair) është konstatuar se ambientet për ndalim e vënë në pozitë poshtëruese personin e ndaluar për shkak të ekspozimit ndaj shikimeve të të gjithë të punësuarve dhe qytetarëve të cilët vijnë për të denoncuar ngjarje të caktuara. Në këto stacione policore ambientet për ndalim ose ambienti ndihmës për ndalim (SP Kriva Pallankë) janë locuar në katin përdhes, pranë zyrës së pranimit, i ndarë nga ambienti tjetër me grila metalikë, pa ndarje me mur.

MPN hasi edhe në dy situata tjera ku ambientet për ndalim, edhe pse të locuara në pjesën përdhese të stacionit policor, nuk i përmbushnin standardet elementare minimale për ndalimin e personave, sa i përket madhësisë dhe depërtimit të dritës natyrore (SPKP Draçevë), ndërsa si problem shtesë ishte ngrohja dhe ventilimi (SPKP Kumanovë). Në Stacionin Policor Koçan ambientet për ndalim, edhe pse me higjienë të përmirësuar, ndodhen në pjesën e qilart-bodrumit ku nuk ekziston sistemi për thirrje dhe nuk janë përmbushur standardet për ndriçim dhe ventilim. Gjendja është shumë më serioze në Stacionin Policor Kriva Pallankë ku vendet për ndalim janë dy nivele nën katin përdhes të ndërtesës dhe nuk kanë qasje në dritën natyrore, ka depërtim të vogël të ajrit të pastër, nivel të ulët të ventilimit dhe kundërmim të madh nga lagështia, nuk ka instalim adekuat të ndiçimit, ndërkaq veçanërisht shqetëson mosekzistimi i sistemit për ngrohje.

Në Stacionet policore, në të cilat janë ndërtuar ambiente të reja për ndalim, gjendja, sa u përket kushteve dhe mundësive materiale-teknike, është përmirësuar dukshëm krahasuar me periudhën para implementimit të Projektit të mbështetur financiarisht nga fondet e BE-së. Objektivi specifik i

këtij Projekti ka qenë mbështetja e zhvillimit të stacioneve policore, me vëmendje të veçantë në ambientet e arrestimit, ambientet e pranimit dhe ambientet e inspektorëve për parandalim, në përputhje me standardet e BE-së dhe Ligjit për Policinë, duke iu përgjigjur parimeve të shoqërisë demokratike, sundimit të së drejtës, mbrojtjes së qytetarëve dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të tyre fundamentale.

MPN-ja konsideron se në masë të madhe është realizuar ky objektiv, duke e pasur parasysh shkallën e lartë të masave të sigurisë-mbrojtjes të cilat janë ndërmarrë me zgjedhje e materialeve dhe rinovimin e ambienteve të pranimit dhe zhvillimin e bisedave me personat e arrestuar dhe të ndaluar. MPN-ja konstatoi se këto ambiente janë ndërtuar në mënyrë dhe nga materiale të cilët mundësojnë shkallë të lartë të mbrojtjes nga lëndimet, ndërsa si masë mbrojtëse shtesë është video-mbikëqyrja në ambientet e reja dhe krevatet e fiksuar për dysheme me çka pamundësohet shfrytëzimi i tyre i padrejtë dhe keqpërdorimi. Në lidhje me madhësinë e ambienteve, në numrin më të madh të rasteve janë përmbushur standardet ndërkombëtare, më saktësisht standardet e dëshiruara të inkuorporuara nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT), sepse janë me sipërfaqe prej ose mbi 6m² (ambient individual për ndalim), ndërsa për çdo person të ndaluar të radhës përmbushet standardi i dëshiruar prej 4m² shtesë për person¹². Megjithatë, janë konstatuar edhe përjashtime ku madhësia e ambientit për ndalim individual është nën standardin e dëshiruar prej 6m².

Asnjë nga 12 ambientet e vizituar në stacionet policore nuk kishte ambient të veçantë për ndalimin e personave të mitur, dhe si rrjedhojë nuk janë implementuar dispozitat e Ligjit për të drejtat e të miturve¹³. Vetëm Stacioni Policor në Kriva Pallankë ka ambient të veçantë të pajisur dhe të dedikuar ekskluzivisht për bisedë me persona të mitur.

Sa i përket mobilimit të ambienteve për ndalim, u konstatua se ambientet e reja janë pajisur me krevate të standardizuar, të fiksuar për dysheme dhe pajise të unifikuar për pushim gjatë natës të përbërë prej: dyshekut, mbulesës së plastifikuar, batanijes, shtrojës dhe jastëkut. Mirëpo, pajisja e plotë për pushim nuk shfrytëzohet në të gjitha ambientet, sepse diku nuk ka batanije e diku nuk ka shtroje.

Në lidhje me ambientet e vjetër për ndalim gjendja është krejt ndryshe. MPN-ja hasi në stacione policore në të cilat ambientet kanë vetëm stol prej druri dhe nuk ka kurrfarë pajisje për pushim gjatë orëve të natës (Aerodrom), ndërsa këqyrja në regjistrat e këtij stacioni nxori në pah se në ambientet, në të cilët nuk ka kushte elementare minimale, personat e ndaluar qëndrojnë më shumë se 8 orë. U evidentua edhe një numër i caktuar i ndalimeve gjatë

orëve të natës. Gjendje e ngjashme u konstatua edhe në Stacionin Policor Makedonski Brod, ku personat ndalohen në zyrë të improvizuar zyrtare pa pajisje adekuate për pushim, ndërsa gjatë këqyrjes në evidencë u konstatuan 9 raste të ndalimit gjatë natës. Së këtejmi, seriozisht nevojitet pajisja e ambienteve për ndalim e cila do t'i përmbush standardet minimale të përcaktuara. Gjithashtu, edhe gjatë vizitës në Stacionin Policor Çair u konstatuan ndalime prej 19 deri 24 orë, ndërsa për të mitur edhe ndalim maksimal prej 12 orësh, në ambient i cili është joadekuat për qëndrim më të gjatë. Duke e pasur parasysh faktin se ambienti për ndalim nuk i përmbush standardet minimale, MPN-ja shpreh shqetësim të veçantë në lidhje me ndalimet e natës duke e ditur se ambienti nuk ka në dispozicion pajisje dhe mjete për pushim gjatë orëve të natës (krevat, dyshek, shtrojë dhe ngjashëm).

MPN-ja konstatoi se në 7 stacione policore me kompetencë të përgjithshme është instaluar sistemi për thirrje, përmes së cilit në raste urgjente ose nevojë tjetër, personi i ndaluar e alarmon nëpunësin policor në zyrën e kujdestarisë ose përgjegjësën e turnit. Në stacionet policore ku ka ambiente të vjetër të parinovuar për ndalim ekzistimi i një sistemi të këtillë është i rrallë. Megjithatë, ekipi i MPN konstatoi se në Stacionin Policor Kumanovë sistemi i këtillë funksionon në rregull, ndërsa në Stacionin Policor Kriva Pallankë aparati për sinjalizim (alarmi) në ambientet e ndalimit gjatë kohës së vizitës nuk funksiononte. Në të gjitha stacionet policore me ambiente të rinovuara për ndalim janë instaluar sisteme përkatës për thirrje, mirëpo gjatë kohës së vizitës së MPN-së u vërejt se në disa prej tyre ai nuk ishte vënë në përdorim, ndërsa në disa të tjerë nuk funksiononte (SP Kisela Voda dhe SP Tetovë).

MPN-ja shpreh shqetësim sa u përket stacioneve policore ku nuk ka ose nuk funksionon sistemi për thirrje. Në mungesë të video-mbikëqyrjes dhe sistemit për thirrje shtrohet pyetja: në ç'mënyrë personat e privuar nga liria mundin me urgjencë dhe me kohë t'i njoftojnë nëpunësit policorë me nevojat e tyre, si dhe si realizohet mbikëqyrja e vazhdueshme e gjendjes së personave të ndaluar?

Video-mbikëqyrje ka vetëm në stacionet policore me ambiente të rinovuara për ndalim. Mbikëqyrja zbatohet në ambientet për ndalim, ambientin për pranim, ambientin për bisedë dhe marrje në pyetje dhe në korridor, ndërsa këqyrja në kamerat bëhet përmes monitorit të vendosur në shërbimin e kujdestarisë. Video mbikëqyrja nuk bëhet në nyjat sanitare dhe tualete për shkak të respektimit të privatësisë së personit të privuar nga liria. Ruajtja e të dhënave është qendrore, përkatësisht ato nuk ruhen në stacionin policor por në Ministrinë e Punëve të Brendshme. MPN-ja konstatoi se video-mbikëqyrja funksiononte në të gjitha 5 SPKP ku ishin të instaluar, me probleme të caktuara në Stacionin Policor Prilep ku video-mbikëqyrja e natës ishte vështirësuar për shkak të ndriçimit të dobët dhe pamundësisë që kamerat ta regjistronjë gjendjen në ambient. Ekipi i MPN-së konsideron se duhet të gjendet zgjidhje e cila nuk do ta pengonte pushimin e natës për personin e ndaluar (ndriçimi artificial nuk guxon të jetë i fortë gjatë orëve të natës), por që do të mundësonte pandërprerë video-mbikëqyrje edhe gjatë orëve të natës.

Në stacionet policore ku janë ndërtuar ambiente të reja për ndalim

¹² Standarde të dëshiruara të Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës: Shkëputje nga Raporti i 2-të i Përgjithshëm (CPT/Inf (92) 3): 43. Kriteri i ardhshëm (i cili konsiderohet si nivel i dëshiruar dhe jo standard minimal) momentalisht shfrytëzohet gjatë vlerësimit të ambienteve policore për ndalim, të cilët shfrytëzohen për një person për qëndrim prej më shumë se disa orë: për madhësi prej 7 metra katrorë, 2 metra distancë midis mureve, 2,5 metra distancë midis dyshemesë dhe tavanit.

¹³ Neni 109 f. 10 nga Ligji për drejtësi të të miturve ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 87/2007 dhe nr. 145/2010)

nevojitet që ambientet e vjetër, aty ku akoma ekzistojnë të njëjtët, të ridedikohen dhe të shfrytëzohen për qëllime tjera (magazina, arkiv etj.). Në të kundërtën, ekziston rreziku që nëse ndihet mungesë për vende, këto ambiente të cilët nuk i përmbushin standardet minimale, përsëri të shfrytëzohen për ndalimin e personave. Kështu, ekzistojnë dyshime të bazuara se edhe pas hapjes së ambienteve të reja, në SP Gostivar të jetë shfrytëzuar edhe ambienti i vjetër për ndalim, i cili nuk i plotëson standardet minimale për personat e privuar nga liria dhe të njëjtit duhet të jenë jashtë përdorimit.

Në pjesën e qasjes në stacionet policore, MPN-ja konstatoi se në pjesën më të madhe të rasteve (gjithsej 6), nuk ekziston rampë e pjerrët për personat me nevojat të veçanta në hyrje të stacionit policor. Edhe pse ambientet e reja për ndalim kanë hyrje të pasme, ka raste kur deri tek e njëjta nuk mund të ketë qasje sepse bllokohet nga automjetet e shërbimit zjarrfikës (SP Bit Pazar), ose është pjesërisht e qasshme (SP Prilep). Në hyrjen e pasme në ambientet për ndalim të këtij stacioni policor, përmes së cilës hyjnë personat e privuar nga liria, ka rampë të pjerrët për persona me nevoja të veçanta, e cila në momentin e vizitës ishte e bllokuar nga sende (vendosja e përkohshme e sendeve të vjedhura) të cilat e pengonin qasjen.

Në SPKP nuk ekzistojnë ambiente të veçanta për persona të ndaluar, ndërsa vetëm në ambientet e rinovuar për ndalim ekzistojnë arka të veçanta për ruajtjen e sendeve të sekustruara përkohësisht. MPN-ja konsideron se MPB-ja vëmendje të veçantë duhet t'i kushtojë pajisjes së një ambienti të veçantë (gardërobë) me qëllim që kontrolli i personave të bëhet larg shikimeve të nëpunësve tjerë policorë ose publikut.

Nyjat sanitare

Gjendja me nyjat sanitare është e ndryshme dhe varet nga ndërtimi i stacionit policor, ndarja e ambienteve për ndalim dhe nga fakti se a janë rinovuar ato ose jo. Në pjesën më të madhe të SPKP-ve të vizituara, ku vendet për ndalim nuk janë të rinovuara, u konstatua se nuk ekziston ndarje e nyjave sanitare sepse të njëjtat i shfrytëzojnë edhe personat e ndaluar edhe nëpunësit e punësuar. MPN-ja konstatoi gjendje shqetësuese të keqe, sa u përket nyjave sanitare në disa nga stacionet policore (SP Draçevë, SP Makedonski Brod), të cilat shfrytëzohen edhe nga personat e ndaluar dhe paraqesin rrezik për vetëlëndim ose lëndim.

Në SPKP-të, ku ambientet për ndalim janë të reja, në pjesën e rinovuar të stacionit policor ekzistojnë edhe toaleta të veçantë të cilët shfrytëzohen kryekëput për personat e ndaluar. Vlerësim i përgjithshëm është se ato janë të reja, të ndërtuara në kuadër të Projektit për rinovimin e vendeve për ndalimin e personave dhe higjiena është në nivel të kënaqshëm. Megjithatë, me përjashtim të dy stacioneve policore (Tetovë dhe Kisella Vodë), MPN-ja konstatoi ekzistimin e materialeve lehtësisht të thyeshëm: qelq, mbajtës metalik

për letrën higjienike, ndërsa diku edhe zorrë për dush, të cilët nga personat e ndaluar mund të keqpërdoren lehtë me qëllim të vetëlëndimit ose shkakimit të plagëve. MPN-ja konkludoi se gjatë projektimit të ndërtimit të toaleteve në vendet e reja të ndalimit nuk janë parashikuar rreziqet e sigurisë. MPN-ja gjatë çdo vizite sugjeronte të drejtën e privatësisë dhe intimitetit, konform të cilëve personat e privuar nga liria në toalet duhet të hynë pa shoqërim.

Vetëm në dy raste, MPN-ja konstatoi mbrojtje të plotë të personave të privuar nga liria nga lëndimet e mundshme ose vetëlëndimet në toalet, gjë që është shembull pozitiv (SP Kisella Vodë dhe SP Tetovë).

Ambientet për biseda dhe marrje në pyetje

Sa u përket ambienteve në të cilët zhvillohen biseda me personat e arrestuar dhe të ndaluar, ekziston dallimi midis vendeve të reja për ndalim dhe ambienteve të vjetra të parinovuara për ndalim. Ekipi i MPN-së konstatoi se praktika në lidhje me vendin në të cilin personi informohet me të drejtat ose të njëjtat i bëhen me dije, si dhe praktika në lidhje me vendin në të cilin zhvillohet biseda dhe marrja në pyetje e personit të arrestuar ose të ndaluar, nuk është e unifikuar dhe varet nga kushtet materiale-teknike të vet stacionit policor, si dhe nga sjellja, koordinimi dhe bashkëpunimi i ndërsjellë i nëpunësve policorë të uniformuar me inspektorët e punësuar në të ashtuquajturën zyrë e jashtme, e cila është në kompetencë të drejtpërdrejt të komisarit të policisë përkatëse të SPB-së, të cilët zhvillojnë bisedë me personat për të cilët ekzistojnë baza se kanë kryer veprë penale.

Kur bëhet fjalë për stacione të vjetra policore, së pari personi udhëzohet për të drejtat në zyrën e pranimit, ku gjendet përgjegjësi i turnit, kompetent për mbikëqyrjen e gjendjes së personave të ndaluar, ndërsa pastaj nëse bëhet fjalë për veprim me elemente të veprës penale bisedën, në lidhje me veprën e kryer, zakonisht e kryen inspektori kompetent në zyrën oficiale. MPN-ja konsideron se një gjë e tillë është e palejueshme sepse personat e privuar nga liria duhet të lëvizin vetëm në ambiente të caktuara dhe për këtë qëllim janë caktuar ambiente në stacionet policore (zyrat për bisedë). MPN-ja, në përputhje me metodologjinë e përcaktuar të punës, me zgjedhje të rastit bëri kontrollin e zyrove oficiale të inspektorëve. Në njërin nga ambientet zyrtar (Kumanovë), për të cilin u bë me dije se shfrytëzohet edhe si zyrë për zhvillimin e bisedës me persona, u vërejt se ishin regjistruar kablo dhe shu-fra si sende të sekustruara për të cilat procedura akoma është në rrjedhë. MPN-ja sugjeroi se sendet e tilla duhet të shënohen në mënyrë të rregullt dhe të ruhen në lokale adekuate, me qëllim të reduktimit të rrezikut nga keqpërdorimi i mundshëm i tyre.

Automjete transportuese

Gjatë vizitave të SPKP-ve, MPN-ja realizon këqyrjen e automjeteve zyrtare të policisë, të cilët i has gjatë kohës së vizitës. Edhe pse disa nga stacionet janë pajisur me automjete të reja-furgonë për transportin e personave të arrestuar dhe të ndaluar (Folksfagen Transit), të cilët i përmbushin standardet sa i përket mbrojtjes, sigurisë dhe ventilimit, megjithatë disa SPKP nuk kanë në dispozicion automjetet përkatëse për transportin e kësaj kategorie të personave. MPN-ja sidomos është e brengosur në lidhje me transportimin e personave me automjete të vjetra dhe të amortizuara për shkak të kushteve joadekuate të tyre, si dhe për mënyrën e zbatimit të transportimit. MPN-ja konsideron se të gjitha SPKP-të, të cilat janë përcaktuar me aktvendim si vende për ndalim, në mënyrë përkatëse duhet të jenë të pajisur me automjete të reja për transport, ndërsa si shembull për përmbushjen e standardeve janë automjetet e tipit Folsfagen Transit, me të cilët tanimë është pajisur një pjesë e stacioneve.

Realizimi i të drejtave të personave të ndaluar***Informatat dhe udhëzimi për të drejtat***

Përgjegjësi i turnit (nëpunësi policor për praninë), në përputhje me Rregulloret për mënyrën e kryerjes së punëve policore dhe Procedurave standarde operative për ndalim dhe veprim me personat e ndaluar, është kompetent për pranimin e personave, udhëzimin dhe realizimin e të drejtave të tyre, si dhe për mbikëqyrjen e vazhdueshme, derisa qëndron i/e ndaluar, me qëllim të mbrojtjes dhe sigurisë së tij në stacionin e policisë.

Pas 12 vizitave të realizuara gjatë vitit dhe bisedave të zhvilluara me përgjegjësit e turnit ose kryerësit e detyrës - përgjegjës të turnit në SPKP të vizituara, MPN-ja konstatoi se bashkimi i rolit të përgjegjës të turnit me rolin e nëpunësit policor për praninë nuk është i përshtatshëm dhe nuk është në drejtim të mbrojtjes së sigurisë dhe realizimit të të drejtave të personit të ndaluar. MPN-ja do të ofrojë propozime shtesë dhe do të ndërmerr masa konkrete në drejtim të sigurimit të mirëfilltë të rolit të nëpunësit për praninë dhe mbikëqyrjen e personave të ndaluar.

Informatat për të drejtat janë shpërndarë dhe vendosur nëpër vende të theksuara në të gjitha SPKP-të. Ekzistojnë dy lloje të pllakateve për të drejtat e personave – njëri është në tri gjuhë ndërsa tjetri në shtatë gjuhë. Nuk ka ndonjë rregull se cili pllakat në cilin SPKP vendoset ndërsa kjo, para së gjithash, varet nga mënyra e zbatimit të shpërndarjes së pllakateve dhe cilat pllakate i ka në dispozicion vet stacioni. Mirëpo, vërehet mosekzistimi i standardeve për vendin se ku duhet të vendosen/theksohen të drejtat e personave të arrestuar dhe të ndaluar ndërsa kjo, pikë së pari, varet nga ka-

pacitetet hapësinore dhe mundësitë materiale të stacionit policor. Në pjesën më të madhe pllakatet për të drejtat e personave të ndaluar janë vendosur në mënyrë përkatëse në hyrje të stacionit, por në situata më të rralla ato janë vendosur edhe në zyrën e pranimit (dhoma e punës së përgjegjës të turnit) ose në zyrën për biseda me personat e ndaluar (në SPKP-të ku ambientet për ndalim janë të reja ose të rinovuara). MPN-ja konsideron se MPB-ja duhet të bëjë përpjekje në drejtim të theksimit të të drejtave në çdo zyrë praninë, zyrë për bisedë dhe në çdo ambient për ndalim, me çka do të sigurohej këqyrje e drejtpërdrejt, e vazhdueshme dhe papengesë e personave të ndaluar në listën e të drejtave të cilat i takojnë gjatë kohës së procedurës policore.

Kodeksi i etikës së policisë është vendosur në ambientet e përbashkëta dhe është i dukshëm për të gjithë nëpunësit policorë me uniformë.

E drejta për ushqim dhe ujë

Në përputhje me Procedurat standarde operative, personit të ndaluar i takon minimum një racion, nëse ndalimi zgjat më shumë se 6 orë. Sipas informatave të siguruar kjo e drejtë realizohet në mënyra të ndryshme. Në numrin më të madh të rasteve kjo e drejtë realizohet nga mjetet personale financiare të personit të ndaluar ose nga familja, ndërsa në numër më të vogël të rasteve, ushqimin e siguron SPKP-ja nga mjetet e veta të DSP (informata nga nëpunësit policorë).

MPN-ja konsideron se SPKP-ja duhet të ketë buxhet vetjak për ushqimin e personave të ndaluar dhe çdo SP duhet të mbajë shënim të veçantë zyrtarë për realizimin e të drejtës për ushqim, si dhe ta bashkëngjis faturën fiskale me të cilën do të vërtetohet realizimi i së drejtës për racion gjatë kohës së ndalimit. Si shembull pozitiv janë: SP Prilep dhe SP Makedonski Brod, ku dosjet individuale për ndalimin e personave kishin edhe shënime zyrtare për të drejtën e ushqimit me faturë fiskale për racionin e blerë.

MPN-ja vlerëson se ushqimi duhet të rregullohet me ligj, bashkë me të drejtat e tjera të cilat janë të garantuara për personat e privuar nga liria, si dhe të caktohet zgjidhje sistemore për mënyrën e realizimit të kësaj të drejte, e cila nuk do të varet nga gjendja financiare e personit të ndaluar.

E drejta për mbrojtës dhe njoftim të familjes

Personat e ndaluar në stacionet policore rrallëherë e realizojnë të drejtën e mbrojtësit. Ndonëse në numrin më të madh të rasteve personat e arrestuar dhe të ndaluar udhëzohen në mënyrë përkatëse, vetëm një numër shumë të vogël vendosin ta shfrytëzojnë këtë të drejtë. MPN-ja konstatoi se në shumicën e SPKP-ve ekzistojnë lista me mbrojtës (avokatë), mirëpo është

evidente se edhe në raste të rralla, kur personi kërkon prezencën e avokatit, përzgjedhjen e bën vet ai.

Personi i ndaluar udhëzohet për të drejtën e tij për ta njoftuar anëtarin e familjes. MPN-ja konstatoi se për dallim nga e drejta për mbrojtës, personat e ndaluar më shpesh e shfrytëzojnë këtë të drejtë dhe në mënyrë përkatëse e informojnë bashkëshortin e tyre ose prindin, ndërsa tek të miturit ekziston obligimi, konform Ligjit për të drejtat e të miturve, për informim të detyrueshëm të prindit ose kujdestarit të ligjshëm.

E drejta për mjek

Përgjegjësi i turnit e ka për detyrë që gjatë pranimit, në mënyrë adekuate ta konstatojë gjendjen shëndetësore të personit të ndaluar dhe të njëjtën ta evidentojnë në mënyrë përkatëse në procesverbalin për ndalim. Përgjegjësi i turnit i evidenton lëndimet e dukshme, shenjat e dukshme të sëmundjes, alkoolizmit dhe veprimet të substancave psikotrope dhe në mënyrë adekuate e përcakton nevojën për ndihmë mjekësore. Gjatë bisedave të zhvilluara me përgjegjësit e turnit, SPKP-ve iu sugjerua që ta zbatojnë praktikën e thirrjes së detyrueshme të mjekut, në të gjitha rastet kur tek personi evidentohen lëndime të dukshme dhe shenja të dukshme të sëmundjes, si dhe gjithmonë kur personi i ndaluar do të kërkojë një gjë të tillë.

Por, praktika dëshmon gjendje tjetër, kështu që gjatë vizitës së SP Makedonski Brod dhe këqyrjes në evidencë, MPN-ja konstatoi se një person i ndaluar është pranuar me lëndime të dukshme në fytyrë, ndërsa për këtë nuk është njoftuar mjeku, më saktësisht në procesverbalin për ndalimin e personit është evidentuar se nuk ka pasur nevojë për mjek.

Në bazë të dokumentacionit (shënimit zyrtar për arrestim) ekipi i MPN konstatoi se mbi atë person janë përdorur mjete të dhunës. Në këtë drejtim MPN shprehu shqetësim në lidhje me vlerësimin e personave zyrtarë të policisë për llojin e lëndimit dhe nevojën për ndihmë mjekësore dhe sugjeroi se detyrimisht duhet të thirret mjeku në rastet kur personi ka lëndime të dukshme të cilat ndoshta janë shkaktuar nga shfrytëzimi i mjeteve të dhunës.

Në SP Koçan u konstatua një numër i caktuar i personave tek të cilët janë përdorur mjete të dhunës (këqyrja në dy dosje individuale për persona të ndaluar), pas çka është dhënë ndihma mjekësore. Në këto raste MPN-ja bëri vërejtje që të evidentohet në vlerësimin për justifikim se a është shkaktuar lëndimi nga aplikimi i mjeteve të dhunshme ose është shkaktuar paraprakisht.

Këqyrja në një lëndë të një SPKP-je tjetër la të dyshohet për mënyrën me të cilën janë shkaktuar lëndimet sepse vetëm 15 minuta para se të arresojë, personi është denoncuar për prishje të rendit, qetësisë publike dhe dhunë (detyrim), ndërsa vetëm 10 minuta pas denoncimit, deri në arrestimin e tij në stacionin policor është dërguar në gjendje pa ndjenja (alivanosje). Me

qëllim të analizimit të detajuar dhe me qëllim që këto raste të hetohen me rregull, nevojitet që lëndës t'i bashkëngjitet edhe shënimi përkatës mjekësor (pa hyrë në të dhënat që janë me karakter personal dhe të dhënat për gjendjen shëndetësore të personit) të bashkëngjitur nga institucioni shëndetësor ku është kryer intervenimi.

Për një person të ndaluar, në procesverbalin për ndalim (SP Bit Pazar), cekej se është përdorues i drogave dehëse, përkatësisht heroinës, por nuk është thirrur mjek për ta përcaktuar gjendjen e tij shëndetësore ose për dhënien e terapisë së nevojshme adekuate. Ekipi i MPN-së konsideron se në rastet e varësve nga alkooli ose droga, detyrimisht duhet të bëhet kontrolli mjekësor me qëllim të parandalimit të rreziqeve të mundshme gjatë ndalimit të kësaj kategorie të personave. Në rastin konkret, personi është ndaluar më shumë se 10 orë pa kurrfarë kontrolli mjekësor. Gjendje e ngjashme është vërejtur edhe në SP Kisella Vodë.

Në SP Kriva Pallankë edhe pse në procesverbalin për ndalim ishte konstatuar se personi ka pasur lëndime të dukshme dhe prezencë të sasisë së madhe të alkoolit në organizëm (3,62%), gjatë pranimit nuk i është ofruar ndihma mjekësore. Sipas evidencës, personit të njëjtë i është ofruar ndihma mjekësore vetëm pasi ka kërkuar ai vetë.

Në SP Prilep dhe SP Bit Pazar (një lëndë), MPN-ja konstatoi plotësim të pakompletuar të procesverbaleve për ndalimin e personave, përkatësisht nuk ishin plotësuar të gjitha rubrikat për lëndimet e personit dhe nevojën për mjek gjatë pranimit të personit. Në një rast në SP Kisella Vodë në procesverbalin për ndalim është cekur se personi është përdorues i mjeteve narkotike, por me këtë rast nuk është njoftuar mjeku, përkatësisht në procesverbal është cekur se nuk ka pasur nevojë për mjek.

Në SP Gostivar gjatë këqyrjes së një dosjeje u konstatuan parregullsi të cilat nxitën dyshim në lidhje me kohën e shkaktimit të lëndimeve dhe realizimit të të drejtës për ndihmë mjekësore. Njëherësh, në shënimin zyrtar për arrestim qartë dhe pa mëdyshje ishte evidentuar lëndimi i dukshëm në kraharor, ndërsa me kërkesën e personit është thirrur ndihma e parë, gjë që ishte kontradiktore me procesverbalin për personin e ndaluar, ku cekej se nuk ekzistojnë lëndime të dukshme tek personi.

Edhe pse SP Kumanovë duhet të theksohet si një shembull pozitiv, sa i përket udhëheqjes së shënimeve të veçanta zyrtare për ndihmë mjekësore, megjithatë gjatë vizitës MPN-ja hasi në një lëndë për të cilën në Regjistrin për persona të ndaluar ishte evidentuar nevoja për mjek, ndërsa në vet dosjen mungonin dokumentet të cilat do ta vërtetonin nevojën e këtyllë, më saktësisht mungonte procesverbali për ndalim dhe procesverbali për udhëzim, për të drejtën e mbrojtësit dhe të drejtat tjera. Praktika e këtyllë lë të hapur çështjen nëse personit, i cili ka pasur nevojë, i është ofruar ndihma mjekësore.

Për një person të mitur, të ndaluar mbi 12 orë në një SPKP (Makedonski Brod), MPN-ja konstatoi se i është ofruar ndihma mjekësore për goditje me send të fortë në pjesën e bërryllit të majtë (shënim i bashkëngjitur mjekësor), por gjatë pranimit të tij në SP nuk është evidentuar lëndimi i dukshëm, e as

nevoja për mjek. Në vërtetimin mjekësor për ndihmën e dhënë, në fund të shënimit të përpiluar nga mjeku, është shtuar: "nga persona të panjohur" (pjesa e shtuar pason pas përfundimit të fjalisë së shkruar me stilolaps tjetër). Duke e pasur parasysh këtë që u tha, ekipi i MPN-së dyshon për mënyrën e shkaktimit të lëndimeve tek ky person.

Në një lëndë në SPKP Çair janë konstatuar lëndime të dukshme në ballë, supin e majtë dhe në bërrylin e majtë të personit të ndaluar i cili ka qenë në gjendje të alkoolizuar dhe në Procesverbalin për persona të ndaluar është konstatuar në mënyrë përkatëse nevoja për mjek. Mirëpo, në Procesverbal nuk është cekur në mënyrë përkatëse se a i është dhënë dhe nga kush i është ofruar ndihma mjekësore, ndërsa në Regjistrin për persona të ndaluar është cekur se është thirrur ndihma e shpejtë fill pas privimit nga liria. Mospërputhjet dhe paqartësitë e këtilla doemos duhet të korrigojohen me qëllim që të fitohet pasqyrë e pastër për realizimin e të drejtës për ndihmë mjekësore për çdo rast individual, kur një gjë e tillë konstatohet dhe/ose e kërkon personi i ndaluar.

Evidenca e regjistrave për personat e ndaluar

Gjatë këqyrjes në dosjet e veçanta për personat e ndaluar, MPN-ja konstatoi shkelje serioze të normave pozitive ekzistuese. Njëkohësisht, në dy raste u vërejt ndalimi i personit të mitur prej 22 orë (SP Makedonski Brod), ndërsa situatë e ngjashme u konstatua edhe në SP Gostivar, ku në një rast është vërejtur ndalimi i personit të mitur madje për 24 orë, gjë që është në kundërshtim me limitin e përcaktuar maksimal kohor prej 12 orësh, në përputhje me nenin 109 të Ligjit për të drejtat e të miturve.

SP Kumanovë dhe SP Makedonski Brod nuk mundën t'i sigurojnë të gjitha dosjet për personat e ndaluar të cilat u kërkuan për këqyrje nga ekipi i MPN-së, ndërsa në disa stacione, në pjesën më të madhe të dosjeve, dokumentacioni nuk ishte i plotë dhe nuk ishte plotësuar në mënyrë të rregullit. Kështu, në dosjet për persona të ndaluar në SP Kumanovë janë vërejtur lëshime të caktuara si: mospasje të procesverbalit për ndalim, mospasje të procesverbalit për udhëzim, për mbrojtës dhe të drejta tjera, procesverbal për persona të ndaluar të plotësuar në mënyrë jo të rregullit dhe jo të plotë, si dhe dosje individuale me dokumente nga persona tjerë të ndaluar. Në SP Gostivar shqetëson fakti se një pjesë e procesverbaleve për persona të ndaluar të mitur nuk janë të kompletuar, në regjistrat për ngjarjet e ditës dhe për personat të cilëve u është kufizuar liria e lëvizjes ekzistojnë lëshime gjatë plotësimit, ndërsa në Regjistrin për shfrytëzimin e mjeteve për dhunë nuk ka vlerësim arsyetimi.

Mangësi janë konstatuar edhe në SP Aerodrom, ku një dosje për person të ndaluar nuk ishte plotësuar tërësisht, ndërsa gjatë kontrollit të një dosjeje tjetër u konstatua mospasje të procesverbalit për udhëzimin për të drejtat dhe nuk ishte shënuar emri i personit të transferuar në stacion tjetër policor.

Faqja e dytë dhe e tretë e dosjes për persona të ndaluar nuk plotësohen çdoherë, përkatësisht nuk cekën dokumentet të cilët janë si shtojcë të dosjes, ndërkohë që ekziston tendencë për formimin e dosjeve kolektive për më tepër persona të ndaluar sipas lëndës së njëjtë. Përjashtim janë SPKP-të në të cilët janë evidentuar me rregull dokumentet të cilët i bashkëngjiten dosjes.

Gjatë vizitës së SPKP Çair në një nga dosjet kishte shënim zyrtar të përpiluar nga nëpunësi policor në të cilën cekej se nëse ka nevojë që personi të ndalohet më shumë se 24 orë duhet të transferohet në stacion tjetër policor. Edhe pse shënimi nuk ishte nënshkruar nga nëpunësi i autorizuar policor, ekipi i MPN i sugjeroi personit udhëheqës se është e palejueshme përpilimi i shënimit me përmbajtje të tillë sepse kjo shpie në veprime jopërkatëse dhe joadekuate të strukturave policore.

MPN-ja konstatoi se në pjesën më të madhe të SPKP-ve të vizituara shfrytëzohen dy formular të ndryshëm të procesverbaleve për udhëzimin dhe realizimin e të drejtave. Njëri procesverbal ekskluzivisht ka të bëjë me udhëzimin për të drejtën e mbrojtësit, por jo edhe për udhëzimin e realizimit të të drejtave tjera në stacionin policor. MPN-ja konsideron se MPB-ja duhet të jep sqarime dhe orientime shtesë në pjesën e shfrytëzimit të këtij procesverbal.

Në disa SPKP në Regjistrin për ngjarjet e ditës, si dhe në Regjistrin për persona të thirrur, arrestuar dhe të ndaluar, nuk është shënuar qartë se për cilën kategori të personave bëhet fjalë (personi a është thirrur, arrestuar ose ndaluar) prej çka më tej varet se cilat të drejta rezultojnë për personin në procedurën që pason.

Në numrin më të madh të SPKP-ve të vizituara është përdorur korrektori për ndryshimin e të dhënave, përkatësisht fshirjen e gabimeve nëpër dosjet e personave të ndaluar dhe në regjistrat e tjerë të policisë. MPN-ja konsideron se me praktikën e këtillë është e mundshme të bëhen keqpërdorime me të dhënat prandaj sugjeron që në asnjë rast të mos përdoret korrektori, por të dhënat e pasakta të nënvizohen me një vijë dhe të jenë të lexueshme. Në SP Prilep, kopja me indigo e procesverbalit për ndalim në disa lëndë dallohej nga origjinali. Në numrin më të madh të SPKP nuk mbahet rikapitullari mujor për numrin e personave të thirrur, arrestuar dhe ndaluar në regjistrin përkatës në mënyrën e përcaktuar me Procedurat standarde operative për ndalimin dhe veprimin me personat e ndaluar.

Sa i përket evidencës policore, si pozitive mund të theksohet praktika e SP Prilep ku janë përpiluar shënime të veçanta zyrtare për ndihmë e kërkuar mjekësore për realizimin e të drejtës për ushqim. Gjithashtu, edhe SP Tetovë përpilon shënim të veçantë zyrtar për ndihmën e kërkuar dhe të ofruar mjekësore për personin e ndaluar dhe shënim të veçantë zyrtar për realizimin e të drejtës për ushqim, ndërsa në SP Koçan në ambientet për ndalim, gjithashtu edhe në çdo dosje për person të ndaluar, ka listë për vizita nga nëpunësit policorë, gjë që vë në pah vizitën dhe mbikëqyrjen e shpeshtë të personave të ndaluar. SP Koçan dhe SP Kumanovë përpilojnë edhe shënim të veçantë zyrtar për ndihmën mjekësore që i jepet personit të ndaluar.

Regjistri për përdorimin e mjeteve të dhunshme mbahet në përputhje

me formularin e përcaktuar me aktin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Megjithatë, MPN-ja konstatoi evidentimin jo në kohë të të dhënave në këtë regjistër dhe përpilimin e pa azhurnuar të raportit për vlerësimin e bazës, arsytimit dhe rregullshmërisë së përdorimit të mjeteve të dhunshme nga ana e organit udhëheqës. MPN-ja me zgjedhje të rastit realizoi këqyrje dhe kontroll në më tepër lëndë individuale nga ky regjistër dhe konstatoi se në numrin më të madh të rasteve bëhet fjalë për përdorimin e mjeteve të përcaktuara të dhunës (forcë fizike me levë në dorë të majtë ose dorë të djathtë, pranga si mjet për lidhje, ndërsa në disa raste edhe shufër gome). MPN-ja konsideron se edhe në rastet, ku ekziston vlerësim për bazë dhe arsye për përdorimin e mjeteve të dhunës, ajo është e njëanshme dhe bazohet ekskluzivisht në raportet e dërguara nga personi i autorizuar zyrtar, i cili ka përdorur mjete të dhunës, pa u marrë parasysh qëndrimi ose mendimi i palës tjetër, përkatësisht personit ndaj të cilit janë përdorur këto mjete.

B. INSTITUCIONET NDËSHKUESE-KORREKTUESE DHE EDUKUESE-KORREKTUESE

Në vitin 2011 Mekanizmi Parandalues Nacional vizitoi 3 burgje dhe 1 ent edukues-korrektues. Vizitat u realizuan në: Burgun Shkup, Burgun Gjevgjeli, Burgun Ohër dhe Entin Edukues-Korrektues Tetovë (përkohësisht i vendosur në objektin e Burgut Veles).

Nga katër vizitat, njëra ishte e paralajmëruar dhe u realizua në periudhë prej tri ditësh, ndërsa vizitat e tjera ishin të paparalajmëruara. Gjatë këqyrjes në burgje u përfshinë edhe repartet e burgjeve si dhe ato të paraburgimit, ndërsa në Entin Edukues-Korrigjues u zbatua këqyrje në Repartin e Hapur dhe në Repartin për Mbikëqyrje të Përforcuar. Në INK dhe EEK Mekanizmi Parandalues Nacional hasi në bashkëpunim të plotë tek drejtoritë, me ç'rast realizoi këqyrje papengesë në të gjitha vendet sipas zgjedhjes së tyre dhe zhvilloi biseda konfidenciale me personat e burgosur, të paraburgosur dhe personat e përkujdesur.

Kushtet materiale

Reparti i pranimit

Burgu Shkup nuk ka në dispozicion repart të veçantë për personat e sapo pranuar. Në momentin e vizitës u vërejt se me vetiniciativë dhe me mjete vetjake ka filluar ndërtimin e objektit i cili duhet të jetë në funksion të repartit të pranimit. Për shkak të mospasjes së repartit të veçantë për pranim, per-

sonat vendosen në Repartin e Mbyllur dhe në njërin nga dhomat në pjesën përdhese (XA-5). Shërbimi i sigurimit sqaroi se në atë ambient vendosen personat të cilët gjenden në repartin e pranimit, por të punësuarit e Sektorit për risocializim vunë në pah se dhoma XA-5 nuk është vetëm repart klasik i pranimit, por se aty vendosen edhe "rastet problematike" për të cilët nevojitet izolimi nga të burgosurit e tjerë.

Mosekzistimi i repartit të veçantë për pranim dhe vendosja e personave të sapo pranuar në Repartin e Mbyllur shpie në çrregullimin e procesit të pranimit dhe adaptimit të personave, me ç'rast u ekspozohen shkallës së lartë të infektimit kriminologjik.

Kapacitetet e vendosjes në Burgun Gjevgjeli në Repartin e Pranimit i plotësojnë standardet e vendosjes së personave të privuar nga liria.

Dhomat dhe nyjat sanitare janë në rregull dhe të pastra, megjithatë në dhomën e parë ekziston mundësia për mbipopullim në qoftë se në të njëjtën kohë vendosen 6 persona (janë vendosur 6 krevate).

Burgu Ohër ka Repart të ndarë pranimi, i cili gjendet në pjesën e Repartit të Paraburgimit por, gjatë këqyrjes, ekipi i MPN-së nuk vërejtë ambiente të veçanta për pranimin e personave.

Reparti i Pranimit në Entin Edukues-Korrektues Tetovë nuk është i ndarë nga repartet e tjerë dhe është i vendosur në një dhomë gjumi me kapacitet prej tre krevatesh. Gjatë këqyrjes në Repartin e Pranimit, ekipi i MPN-së konstatoi se ambienti nuk është i ngrohur mjaftueshëm dhe se ka shkuar edhe pse trupat ngrohës janë vendosur në mënyrë adekuate (radiatorët dhe soba me dru). Por, për shkak të buxhetit të shkurtuar dhe sasisë së pamjaftueshme të mazutit, ngrohja bëhet vetëm me dru, ndërsa kujdesi për sobën është nën kontrollin e mbikëqyrësit.

Reparti i Hapur

Për kapacitetet e vendosjes në Repartin e Hapur të Burgut Shkup u konstatua se ai i përmbush standardet minimale për vendosjen e personave të privuar nga liria. Dhomat e rinovuara për vendosje kolektive duhet të jenë shembull pozitiv gjatë zbatimit të aktiviteteve për rinovimin dhe përmirësimin e kushteve në dy repartet tjerë për vendosjen e personave të dënuar në këtë burg.

Në Repartin e Hapur të Entit Edukues-Korrektues, ambientet e vendosjes i kënaqin pjesërisht kushtet minimale sa i përket vendosjes, sepse krevatat, dyshekët dhe mobilet janë të vjetra, ndërsa ngrohja dhe izolimi ngrohës nuk kënaqin. Nyjat sanitare janë në gjendje tejet të keqe, dushet janë krejtësisht të prishur, ndërsa nëpër toaleta nuk ka ujë të ngrohtë. Në kushte të këntilla të miturit me vështirësi e mirëmbajnë higjienën personale.

Reparti Gjysmë i Hapur

Në Burgun Shkup u konstatua mbipopullim në Repartin Gjysmë të Hapur, një pjesë e kapaciteteve të vendosjes janë rinovuar dhe mirëmbahen në nivel të kënaqshëm, mirëpo pjesa më e madhe e dhomave nuk i përbushin kushtet themelore minimale për vendosje. Nyjat sanitare janë në gjendje jashtëzakonisht të keqe.

Në Burgun Gjevgjeli u vu re mbipopullimi në Repartin Gjysmë të Hapur me çka nuk janë plotësuar kushtet minimale në lidhje me madhësinë e ambientit për vendosje, sepse në dhoma jo më të mëdha se 20m² janë vendosur madje 10 persona, me çka nuk janë përbushur parakushtet vendase prej 9m³ për person, e as standardet e Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT) për 4m² për person.

Sa i përket mirëmbajtjes së higjienës, u vërejt se ajo ishte në nivel të kënaqshëm. Për higjienën kujdesen personat e dënuar të Repartit Gjysmë të Hapur. Të gjitha krevatet kanë shtroje e cila mirëmbahet në gjendje të mirë dhe u përgjigjet kushteve klimatike. Nëpër ambiente ka të instaluar trupa ngrohës, ventilimi është natyror, ndërsa dritaret janë rinovuar me çka izolimi është përmirësuar dukshëm. Nyjat sanitare në Repartin Gjysmë të Hapur janë në nivel të kënaqshëm, në gjendje të përdorshme, ndërsa pllakat dhe toaletet para do kohe janë rinovuar. Dushet janë në rregull dhe në gjendje të mirë, por rekomandohet edhe sanimi dhe mirëmbajtja e tyre e rregullt me qëllim të përbushjes së nevojave higjienike të personave të dënuar.

Gjatë këqyrjes në Repartin Gjysmë të Hapur në Burgun Ohër, ekipi i MPN-së konstatoi se ambientet janë pajisur në mënyrë solide, të gjithë personat e vendosur kanë krevate dhe dyshek, mund të shfrytëzojnë shtroje të tyre dhe t'i zbukurojnë muret me fotografi dhe simbole fetare dhe për këtë kanë leje nga Drejtoria e Burgut. Në lidhje me mirëmbajtjen e higjienës u vërejt nivel i kënaqshëm, ndërsa për këtë kujdesen vet personat e dënuar të Repartit Gjysmë të Hapur.

Reparti i Mbyllur

Gjatë vizitës së MPN-së, në vitin 2011, u vërejt se kushtet materiale nëpër repartet e mbyllur janë më të këqija prandaj, me vendosjen në kushte të tilla, personat e dënuar ndëshkohen në mënyrë plotësuese.

Në Burgun Shkup u konstatua mbipopullim në Repartin e Mbyllur dhe mosrespektim i ligjit për vendosjen e maksimum 5 vetave në një dhomë, e as minimumit ligjor prej 9m³ për person¹⁴, ndërsa njëherësh gjendja e toaleteve është tejet e keqe.

Ekipi i MPN-së realizoi këqyrje në dhomën për trajtim të mbyllur

¹⁴ Standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës përcaktojnë 4m² për person.

(dhomën e izolimit) në Burgun Gjevgjeli e cila, krahasuar me pjesën tjetër të kapaciteteve të vendosjes, është në gjendje më të pavolitshme. Në këtë dhomë mund të vendosen 6 persona, por në momentin e vizitës ishin vendosur dy persona me të cilët ekipi i MPN zhvilloi bisedë. Depërtimi i ndriçimit natyror është i kufizuar, ekzistojnë trupa për ngrohje (radiatorë) të cilët shfrytëzohen për ngrohje gjatë periudhës së dimrit, ndërsa ventilimi është natyror, por në momentin e vizitës ndihej se nuk ishte ajrosur.

Në Burgun Ohër, Reparti i Mbyllur është më dobët i pajisur krahasuar me Repartin Gjysmë të Hapur dhe vërehet mirëmbajtje më e dobët e higjienës (personat e dënuar informuan se ata janë të ngarkuar me mirëmbajtjen e higjienës). Gjatë këqyrjes, ekipi i MPN-së konstatoi se të gjithë personat e dënuar kanë krevate, në çdo dhomë janë vendosur aparate shtesë – televizorë, DVD dhe kompjuter (në një ambient kompjuteri nuk ishte në funksion). Tavolinat e punës dhe karriget janë të vjetra dhe të amortizuara.

Në Repartin për Ndikim të Përforcuar Riedukues (RNPR) në Entin Edukues-Korrektues nuk janë plotësuar parakushtet dhe standardet minimale elementare. Reparti nuk ka madhësi adekuate e as ndriçim dhe ventilim përkatës, ndërsa ambienti nuk ka orendi adekuate.

Në ambientin e njëjtë, në momentin e vizitës ishin vendosur 11 persona, prej të cilëve njëri nuk kishte as krevat e as shtroje adekuate, prandaj u konstatua se ai natën e kishte kaluar në dysheme para derës së dhomës.¹⁵ Ambienti për vendosje nuk ishte më i madhe se 20m² dhe në të përveç krevateve kishte tavolinë me kompjuter dhe tavolinë me televizor, si dhe ambient ndihmës për ruajtjen e sendeve personale të personave të vendosur. Në këtë ambient vërehej mbipopullim, gjë që ndikon negativisht dhe në mënyrë kundërproduktive në realizimin e qëllimeve të cilat duhet të arrihen me këtë masë edukuese. Dyshekët e të gjitha krevateve ishin të vjetër dhe të dëmtuar apo tërësisht të amortizuar, nuk ka dollapë të veçantë për ruajtjen e sendeve personale prandaj të njëjtat janë shpërndarë nëpër dysheme dhe në një ambient ndihmës. Depërtimi i ndriçimit natyror është i kufizuar, edhe pse ambienti ka dritare, por pozita e lokalit dhe mbipopullimi nuk mundësojnë nivel të kënaqshëm të ndriçimit natyror.

Ky Repart parashikohet edhe me nenin 64 të Rendit të shtëpisë të Entit Edukues-Korrektues i cili e rregullon materien për hapjen e procedurës disiplinore, me ç'rast për personin për të cilin është shqiptuar masa "vendosje në dhomë izolimi" deri në momentin e sigurimit të mendimit nga mjeku, në rast të dyshimit të bazuar për arratisje ose largim nga enti, i mituri mund të vendoset në Repartin e lartpërmendur. Koha e kaluar në Repartin për Ndikim të Përforcuar Riedukues nuk llogaritet si kohë e vuajtjes së ndëshkimit disiplinor. MPN-ja sugjeroi se në këtë mënyrë personi "dënohet" dyfish sepse dy herë izolohet nga personat e tjerë të vendosur në ent (herën e parë derisa vendo-

¹⁵ Ambienti nuk i plotëson Standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës të cilat përcaktojnë minimum 4m² për person në dhomat për vendosje, e as standardet vendase me të cilat parashikohen 9m² sipas LES.

set në RNPR deri në momentin e sigurimit të mendimit nga mjeku ose nëse ekziston dyshim i bazuar se do të ikë, ndërsa herën e dytë derisa ekzekutohet masa disiplinore dërgim në dhomë izolimi). Edukatori theksoi se në ambientin e njëjtë vendosen edhe të miturit të cilët dërgohen në Ent me shoqërim policor (të cilët nuk kanë shkuar vullnetarisht për ta ekzekutuar masën e entit), si dhe personat e mitur të cilëve tanimë u është shqiptuar masa e izolimit dhe këtu e vuajnë të njëjtën (vendosen në këtë dhomë për shkak të kushteve të këqija në ambientet të cilat dedikohen për masën disiplinore në dhomë izolimi).

Dhomat e izolimit

Johumane dhe skajshëm poshtëruese u vlerësuan kushtet e vendosjes në dhomat e izolimit në INK dhe EEK të cilat u vizituan nga Mekanizmi Parandalues Nacional në vitin 2011.

Në Burgun Shkup dhomat e izolimit janë të parregulluara, higjiena është në nivel të ulët dhe të njëjtat shfrytëzohen jashtë standardeve, sepse personat, në mungesë të krevateve, detyrohen të flenë nëpër dyshekë. Dhomat e izolimit në Burgun Gjevgjeli nuk kanë ndriçim të mjaftueshëm natyror, me ç'rast në mënyrë shtesë shfrytëzohet ndriçimi artificial. Dhomat e izolimit janë të pa ajrosura dhe nuk kanë ventilim të mjaftueshëm. Vërehet se mirëmbajtja e ambienteve është e dobët dhe jo e rregullt, krahasuar me pjesën tjetër të vendosjes në këtë Burg.

Në Burgun Ohër, sa u përket dhomave të izolimit, u konstatua: 1) mosplotësim i standardeve minimale për madhësinë e ambientit për qëndrimin e personit, 2) mosekzistim i trupave për ngrohje në dhomë, 3) mospasje të nyjës së veçantë sanitare, 4) mospasje të ndriçimit të mjaftueshëm të dritës natyrore dhe artificiale, 5) mospasje të depërtimit të dritës së mjaftueshme të ajrit dhe ventilimit të ambienteve, si dhe 6) mospasje të sistemit për thirrje dhe alarm.

Për shkak të kushteve të këtilla të cilat ekzistojnë në këto ambiente, MPN-ja konstatoi se mund vijë deri te rrezikimi i shëndetit fizik dhe psikik i të miturve ose personave më të rinj të moshës madhore, prandaj rekomandoi që të njëjtit të mos shfrytëzohen. Në pikën 67 të Rregullave të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria ceket: "...masat disiplinore të cilat përmbajnë trajtim brutal, jonjerëzor ose nënçmues duhet të ndalohen rreptësisht, ndërsa këtu përfshihet edhe vendosja në dhomë izolimi ose çdo formë tjetër e ndëshkimit me çka mund të vihet në pikëpyetje shëndeti fizik dhe mendor i personave të mitur". Njëherësh u konstatua se gjendja e dhomave të izolimit në burgun për të mitur nuk i plotëson as kushtet e përcaktuara me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve.

Përkatësisht, në nenin 181, paragrafin 2 ceket se "Ambienti në të cilin ekzekutohet dënimi disiplinor vendosje në dhomë izolimi doemos duhet të ketë madhësi prej më së paku 9m2, të ketë ndriçim natyror, të ketë nyje sani-

tare, ujë për pije, krevat me shtroje si dhe të jetë i ngrohur".

Gjatë këqyrjes u konstatua se dhomat e izolimit në EEK Tetovë nuk i plotësojnë standardet minimale ndërkombëtare dhe vendase, ndërsa vendosja në to mund të konsiderohet si trajtim johuman dhe poshtëruese me personat e mitur dhe të rinjtë e moshës madhore. Prandaj, MPN-ja rekomandoi të bëhen ndryshime përkatëse ligjore me qëllim të abrogimit të dënimit disiplinor vendosje në dhomë izolimi për person të mitur.

Repartet e paraburgimit

Në Burgun Shkup pjesa e paraburgimit përfshinë krahët e vjetër dhe të rinj. Krahët e vjetër të paraburgimit janë nën standardet minimale për vendosjen e personave të paraburgosur, ndërsa tek krahët e ri të paraburgimit vërehen dëmtime të inventarit dhe mureve. Zilet e instaluar për alarm nuk funksionojnë në të gjitha ambientet – diku janë dëmtuar dhe thyer nga personat e paraburgosur, ndërsa në ambiente tjera janë hequr me qëllim sepse, sipas informatave të shërbimeve, personat e paraburgosur shpeshherë i kanë shfrytëzuar si ambiente për fshehjen e sendeve të ndaluara (celularë, karrikuet etj.).

Gjatë vizitës së Burgut Gjevgjeli, ekipi i MPN-së realizoi këqyrje në njërin nga ambientet e Repartit të Paraburgimit në të cilin, në momentin e realizimit të vizitës, ishte vendosur një person i paraburgosur – shtetas i huaj. Ambienti i përmbush standardet ndërkombëtare sa i përket madhësisë, mirëpo ka depërtim të dobët të ndriçimit natyror, nuk ka ventilim, prandaj dhe është i pa ajrosur, ndërkaq gjendja me nyjat sanitare nuk është në nivel të kënaqshëm.

Në Burgun Ohër pjesa e paraburgimit është e rinovuar, në çdo dhomë ka dritare të reja dhe ndriçimi natyror depërton nga dritaret të cilat hapen nga ana e korridorit. Nëpër dhoma ka nyje të veçanta sanitare të cilat janë rinovuar, aty ka guacë toaleti dhe lavaman të cilët pjesërisht fizikisht janë të ndarë nga pjesa tjetër e ambientit. Në ambiente ka tavolinë, por nuk ka karige, prandaj të paraburgosurit ushqimin e konsumojnë të ulur në krevat.

Sikurse edhe në pjesën e të dënuarve, ashtu edhe në pjesën e paraburgimit të Burgut është vërejtur ngrohje e dobët e ambienteve. Në krevat ka dyshek, shtroje dhe batanije për secilin person të cilët duken në rregull dhe të pastër, mirëpo është evidente mirëmbajtja jo me rregull e ambienteve si dhe muret e pa bojatisur dhe të dëmtuar.

Ambientet tjera

Gjatë vizitës së burgjeve dhe të Entit Edukues-Korrektues, MPN-ja vëmendje të veçantë u kushtoi dhomave të ambulancave, kuzhinave dhe men-save, dhomave për takime, dhomave për kontroll, si dhe ambienteve tjera në të cilat qëndrojnë personat e privuar nga liria. Me këtë rast u konstatua se në këto burgje nuk ekzistojnë ambiente të dedikuara ekskluzivisht për kontrollin dhe ekzaminimin e personit të dënuar ose paraburgosur, prandaj shpeshherë kontrolli kryhet në ambiente të improvizuara ose nëpër korridorët para hyrjes në institucione.

Ambulanca

Në Burgun Shkup ka dy ambulanca të cilat janë në gjendje të mirë. Njëra është ndërtuar e re, ndërsa tjetra është rinovuar tërësisht. Inventari dhe pajisjet mjekësore janë të reja, ambientet janë të pastër dhe të mirëmbajtur, si dhe plotësisht u përgjigjen nevojave për të cilat janë dedikuar. Sipas mjekëve, në ambulanca mungon aparati EKG dhe furnizimi i mjaftueshëm me medikamente dhe alkool.

Gjatë vizitës së Burgut Ohër, ekipi i MPN-së realizoi këqyrje në ambulancën e burgut, me ç'rast konstatoi se ambienti është pjesërisht i amortizuar, i vjetër dhe me pajisje të pamjaftueshme. Në ambulancë ka një krevat, tavolinë të vjetër pune, dy karrige/kolltukë, si dhe dy dollapë për pajisjen mjekësore. Nga pajisja mjekësore në ambulancë ruhen: doreza, aparati për matjen e tensionit, aparati për sterilizim dhe pajisjet elementare mjekësore. Ambienti ka lagështi të madhe e cila vihet re nga muret.

Gjatë këqyrjes në EEK Tetovë, ekipi i MPN-së konstatoi se ambienti është i pastër, i thatë, i mirëmbajtur dhe u përgjigjet nevojave për të cilin është dedikuar. Në këtë ambient ka tre krevate, medikamente të cilat ruhen në dollap, ndërsa kartonët e shëndetësisë ruhen të mbyllur në tavolinën e punës. Sipas Ligjit për të drejtat e të miturit, në rastet kur aplikohet masa edukuese mund të shqiptohet edhe masa e sigurisë – mjekim i detyrueshëm i alkoolikëve dhe përdoruesve të mjeteve narkotike¹⁶. Mjekimi i domosdoshëm parashikohet në repartin e specializuar të institucionit, por në këtë institucion për momentin nuk ekzistojnë kushte për ndërtimin e këtij lloji të repartit të specializuar.

Në Burgun Gjevgjeli ambulanca e burgut është e pastër, e thatë dhe e mirëmbajtur, si dhe u përgjigjet nevojave për të cilën është dedikuar. Ambulanca është e pajisur me barnatore të posaçme, në të cilën ruhen dhe magazinohen medikamentet, mirëpo nuk ka dollap të veçantë për ruajtjen e dosjeve (kartonëve) shëndetësore. Në këtë mënyrë vihet në pikëpyetje konfidencialiteti i të dhënave që i përmbajnë kartonët, si dhe i personat të cilëve u mundësohet qasja në to.

Kuzhina dhe mensa

Nëpër burgje mund të vërehet nivel i kënaqshëm i higjienës nëpër kuzhina, ku në mënyrë adekuate është theksuar lista e ushqimeve, e aprovuar nga mjeku dhe drejtori i burgut.

Në EEK Tetovë, ekipi i MPN-së i kontrolloi kushtet në mensë dhe në kuzhinë ku gatuhet ushqimi për të gjithë personat e mitur. Higjiena është në nivel të kënaqshëm, ndërsa inventari, kazanët dhe pajisjet tjera, në të cilat gatuhet ushqimi, mirëmbahen me rregull dhe janë të përdorshëm. Gjatë këqyrjes në mensë u vu re ngrohja e pamjaftueshme, tavolinat dhe karriget e vjetra, të cilat nuk janë fiksuar për dyshemeje, me çka paraqesin rrezik të mundshëm për sigurinë e personave të mitur dhe të punësuarit.

Në veçanti shqetëson mënyra e konsumimit të racioneve nga ana e personave të vendosur në RNPR (Reparti për Ndikim të Përfortuar Riedukues). Ekipi i MPN-së vuri në pah se të miturit e vendosur në këtë repart racionet e tyre nuk i marrin në mesë, por në korridor (i cili është në afërsi të drejtpërdrejt me dhomën në të cilën janë të vendosur), ku është vendosur një tavolinë dhe disa karrige. Gjatë vizitës, MPN-ja i hasi duke ngrënë drekë të miturit, me ç'rast u konstatua se nuk ka numër të mjaftueshëm të karrigeve, e as qasje adekuate deri tek tavolina për ngrënie për të gjithë personat e vendosur në këtë Repart. Njëherësh konstatoi se mënyra e marrjes së racionit në korridor, si ambient i improvizuar, është johumane, me ç'rast duhet që personat e vendosur në RNPR ushqimin ta marrin në mensën e pajisur në mënyrë adekuate.

Punëtoritë

Në Burgun Shkup u vizituan dy punëtoritë: zdrukthëtaria dhe bravan-dreqësia. Në momentin e vizitës, personat e dënuar nuk ishin të angazhuar me punë për shkak të mungesës së instruktorit i cili shfrytëzonte pushimin vjetor. Punëtoritë janë të vendosura në ndërtesa të vjetra të parinovuara, pa ventilim adekuat (ventilimi bëhet përmes dyerve dhe dritareve të hapura), pa trupa të veçantë për ngrohje (shfrytëzohen dy soba me dru). Në të dy punëtoritë, në vende të dukshme është theksuar urdhri nga Drejtoria e Burgut për masat mbrojtëse gjatë punës, ndërkaq gjatë bisedës, të dënuarit e punësuar thanë se kur angazhohen me punë marrin pajisje përkatëse.

Në Burgun Ohër ekziston punëtori për përpunimin e letrës higjienike, e cila gjatë kohës së vizitës nuk ishte në funksion¹⁷. Në Burgun Gjevgjeli puna e personave të dënuar organizohet në rrethin e institucionit dhe njësinë ekonomike "Toplik 2011", ndërsa të angazhuar me punë janë edhe personat e Repartit Gjysmë të Hapur.

Ambientet tjera

Në Burgun Shkup ekzistojnë shëtitore për personat e dënuar dhe të paraburgosur. Në përbërje të pjesës së Paraburgimit ka gjithsej 8 shëtitore

¹⁶ Neni 8 i Ligjit për drejtësi të të miturve ("Gazeta Zyrtare e RM"-së, nr. 87/2007)

¹⁷ Konform informatës së marrë nga shërbimet e burgut

për personat e paraburgosur. Ekipi i MPN-së realizoi këqyrje në njërin nga shëtitoret (shëtitoren B) dhe konstatoi se madhësia e saj është e kënaqshme dhe se e njëjta disponon edhe me sipërfaqe të gjelbër, nuk ka mjete për pushim (stol, karrige dhe ngjashëm), ndërkohë që është e mbuluar vetëm një pjesë e vogël (në vazhdim të konstruksionit të ndërtesës), me çka pjesërisht mundësohet shëtitja kur kushtet klimatike janë të këqija. Në Burgun Gjevgjeli hapësira për shëtitje në ambient të hapur, për personat e vendosur në repartin Gjysmë të Hapur, siguron mundësi për shëtitje dhe aktivitete sportive (basketboll) në natyrë, mirëpo nuk ka pjesë të mbuluar e cila do të mundësonte shëtitje pa pengesë jashtë nga ndërtesa në rastet kur kushtet klimatike janë të këqija.

Në Burgun Ohër shëtitoret siguron mundësi për shëtitje në natyrë dhe aktivitete sportive për personat e vendosur në Repartin Gjysmë të Hapur, mirëpo nuk ka pjesë të mbuluar e cila do t'u mundësonte shëtitje papengesë gjatë kushteve të këqija klimatike.

Në shëtitoren për personat e dënuar ka vegla për ushtrim. Problemi më i madh, jo vetëm për këndin e lojërave por edhe për burgun në përgjithësi, është vendndodhja e tij. Burgu gjendet në mes të ndërtesave të banimit prandaj, me çdo dalje ose lëvizje e personave të dënuar në fushën e sportit (të miturit ose personat e rinj të moshës madhore), ata u ekspozohen shikimeve të drejtpërdrejta të personave tjerë, gjë që mund të ketë efekt përcmues për personat e vendosur në Burg dhe në këtë mënyrë të cenohen të drejtat e tyre të garantuara të privatësisë.

Hapësira për shëtitje në natyrë për personat e vendosur në Repartin për trajtim të përforcuar (RNPR), në Entin Edukues-Korrektues, ka madhësinë e nevojshme, siguron mundësi për shëtitje në natyrë dhe për aktivitete rekreative, por nuk ka pjesë të mbuluar e cila do të mundësonte shëtitje papengesë në natyrë në kushte klimatike të këqija. Rrezik potencial për të përkujdesurit është dalja e parrethuar kah shëtitoret, shkallët e së cilët nuk kanë gardh mbrojtës adekuat dhe lehtësisht mund të ndodhin lëndime fizike.

Të drejtat e personave të privuar nga liria

Mbrojtja shëndetësore

Në Burgun Shkup mbrojtjen shëndetësore e kryejnë 2 mjekë dhe 2 infermiere, prej të cilëve njëri ekip punon me personat e dënuar, të cilët vuajnë dënim me burgim, ndërsa ekipi tjetër punon me personat të cilëve u është përcaktuar masa e paraburgimit. Gjatë kontrolleve mjekësor gjithmonë është prezent personi zyrtar i cili, varësisht nga vlerësimi i mjekut, mund të jetë i pranishëm gjatë kontrollit. Prezenca e këtillë bëhet me qëllim të garantimit të sigurisë.

Në përputhje me Udhëzuesin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë¹⁸ një nga standardet themelore të mbrojtjes shëndetësore përcakton: "personat, të cilët janë në burg i kanë të drejtat e njëjta të mbrojtjes shëndetësore sikurse edhe çdo person tjetër. Personeli mjekësor duhet të veprojë me personat e dënuar sikur me pacientë, e jo si me të burgosur", prandaj MPN-ja konsideron është e nevojshme që kontrollet mjekësore të kryhen pa prezencën e personave zyrtarë.

Gjatë vizitës në Burgun Shkup, MPN vërtetoi mangësi plotësuese për të cilat dha rekomandime adekuate deri te sektori për mbrojtje shëndetësore. MPN konsideron se evidenca e përgjithshme mjekësore, duke përfshirë këtu dokumentacionin e përgjithshëm mjekësor raportet dhe mendimet specialitike duhet të jenë gjithmonë në atë institucion në të cilën personi është duke vuajtur dënimin me burgim apo masën e paraburgimit. Në Burgun Shkup nuk zbatohen vizita ditore ndaj personave të cilët janë duke mbajtur masën disiplinore vendosje në dhomë izolimi, që është në kundërshtim me detyrimet të cilat dalin nga neni.181 paragrafi.4 nga Ligji i Sanksioneve Ekzekutive, dhe gjithashtu MPN vuri në dukje nevojën e ushqimit të veçantë për personat që vuajnë nga diabeti- nevojë për kontroll të zgjeruar ndaj kësaj mase sepse në kohën e vizitës mënyrë të veçantë të ushqimit pranonin vetëm ato persona me diabet të cilët pranonin insulin. Ekipi i MPN konsideron se mënyra e veçantë e ushqimit është e domosdoshme për të gjitha kategoritë e personave që vuajnë nga kjo sëmundje, pavarësisht nga trajtimi mjekësor që ata marrin.

Në Burgun Gjevgjeli nuk ka mjek të punësuar, por i njëjti angazhohet me kontratë në vepër nga praktika e përgjithshme e Qendrës Shëndetësore në Gjevgjeli, i cili në çdo 3-4 ditë (jo më shpesh se dy herë në javë) vjen në Burg dhe kryen kontrolle të rregullta të personave të dënuar. Sistemi i kontrolleve është vendosur dhe organizuar në atë mënyrë që personat lajmërohen tek zyrtarët e burgut, dhe konform listës së përpiluar, kontrollet realizohen në ditën kur vjen mjeku. Në Burg gjatë natës nuk ka kujdestari të shërbimit mjekësor, ndërsa sipas nevojës për intervenim urgjent thirret Ndihma e shpejtë. Gjatë bisedës me disa nga të punësuarit në Sektorin e Sigurisë, MPN-ja u informua se ata janë të trajnuar në mënyrë përkatëse për t'u ofruar të lënduarve ndihmë të parë derisa të arrijë ndihma përkatëse mjekësore.

¹⁸ Health in prison - A WHO guide to the essentials in prison health

Në Burgun Gjevgjeli qasje në dokumentacionin mjekësor ka edhe Sektori për Siguri. Qasje në dosjet mjekësore duhet të ketë vetëm mjeku ose person tjetër mjekësor, i cili është i angazhuar në Burg, për shkak se nevojitet vendosja e marrëdhënies midis mjekut dhe pacientit. Në Rekomandimin nr. 98, në pjesën e aspekteve etike dhe organizative të mbrojtjes shëndetësore në burg të Këshillit të Evropës¹⁹, parashikohet konfidencialiteti i të dhënave të pacientëve të cilët janë të vendosur në burg dhe vendosja e standardeve të pavarësisë profesionale, me çka do të sigurohet mbrojtje e njëjtë shëndetësore sikurse ajo që është në komunitet. Po ashtu edhe në Rregullat Evropiane të Burgjeve²⁰, në pikën 42.3, si detyrë e mjekëve theksohet konfidencialiteti i marrëdhënies dhe veprimi konform rregullave të etikës mjekësore gjatë kontrollit të personave të dënuar.

Në Burgun Gjevgjeli u konstatua se mjeku nuk e kryen çdoherë kontrollin e personit përpara ekzekutimit të masës "vendosje në izolim" e që është bazë ligjore. Të dënuarit, të cilët kanë qenë në izolim, potencuan se kontrolli i parë mbi bazë të të cilit jepet mendimi për vendosjen në izolim është formal, ndërsa ditëve tjera, përkatësisht derisa qëndrojnë në izolim mjeku nuk bën vizitë, siç parashikohet me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve. Në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe vendase²¹, para ekzekutimit të dënimit disiplinor "vendosje në izolim" duhet të sigurohet mendimi nga mjeku për gjendjen shëndetësore të personit të dënuar. Situata e kundërt është konstatuar nga këqyrja në kartonët mjekësorë dhe gjatë bisedave me personat të cilët në momentin e vizitës e vuanin dënimit disiplinor me izolim. Edhe gjatë këqyrjes së dosjeve profesionale të personave të cilët ishin vendosur në izolim u konstatua se aktvendimi, me të cilin shqiptohet kjo masë disiplinore, nuk mbështetet në mendimin e mjekut, e që përcaktohet me dispozitën ligjore në pjesën e ekzekutimit të sanksioneve. Personat në dhomat e izolimit vetëm informohen se nuk ekziston vizitë e përditshme e mjekut gjatë kohës derisa janë në izolim, siç parashikohet me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve.

Në Burgun Ohër nuk ka mjek të punësuar e as infermiere në marrëdhënie të rregullt pune, por në marrëveshje me qendrën lokale mjekësore, angazhohet mjeku i cili një herë në javë (çdo të hënë) e viziton Burgun dhe bën kontrollin e personave të dënuar dhe të paraburgosur. Gjithashtu, personi i angazhuar me profesion është psikiatër, kështu që në mënyrë plotësuese e mbulon edhe domenin e mbrojtjes së shëndetit mendor. Në ambulancë mjeku udhëheq librin për kontrollet dhe kartonët shëndetësor për personat e dënuar dhe të paraburgosur, ndërkaq terapinë mjekësore të caktuar nga mjeku e shpërndan Shërbimi për Sigurim. Shërbimi për Sigurim ka qasje në kartonët mjekësor me çka shkelet parimi i konfidencialitetit ndërmjet mjekut dhe pacientit.

¹⁹ Recommendation No R (98) 7 concerning the ethical and organizational aspects of health care in prison – Council of Europe – Committee of ministers adopted on 8 April 1998, at the 627 meeting of the Deputies.

²⁰ Të miratuara nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, më datë 11.01.2006

²¹ Neni 179 f. 4 nga Ligji për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 02/2006)

Në burgun për të mitur, gjatë kontrollit të disa kartonëve mjekësorë, u konstatua se gjatë pranimit të personit të dënuar kryhet kontrolli, se janë bërë analiza të gjakut me qëllim që të konstatohet nëse personi vuan nga Hepatiti B dhe janë evidentuar të gjitha kontrollet e specialistit të realizuara për personin e mitur.

Në EEK Tetovë ka të punësuar një mjek i cili është përfshirë edhe në mbikëqyrjen e ushqimit i cili u shpërndahet të përkujdesurve në Ent dhe udhëheq librin e kontrolleve, si dhe kartonët shëndetësorë për çdo person. Gjatë kontrollit të disa kartonëve mjekësorë u konstatua se gjatë pranimit të personit të mitur kryhet kontrolli, bëhet analiza e gjakut me qëllim të ekzaminimit nëse personi vuan nga Hepatiti B dhe evidentohen të gjitha kontrollet e specialistit, të realizuara për personin e mitur. Mjeku informoi se kontrolli bëhet pa prezencën e të punësuarve të Shërbimit të Sigurimit, ndërsa me qëllim të parandalimit të sëmundjeve ngjitëse kontrollet sistematike bëhen në çdo gjashtë muaj.

Meqë në EEK mjekët punon në turne prej 24 orë, të cilët ndërrohen në çdo 4 ditë, u parashtrua pyetja për vizitën e përditshme të personave të cilëve u është shqiptuar masa disiplinore vendosje në dhomë izolimi. Sipas mjekut, nëse në dhomë izolimi ka "të mitur problematik", ai i viziton çdo ditë, ndërsa mbikëqyrjen e përditshme mbi personat e tjerë, të cilët e vuajnë masën disiplinore në dhomë izolimi, e zbatojnë shërbimet. Ekipi i MPN-së sugjeroi se është i nevojshëm angazhim i vazhdueshëm i personit mjekësor ose mjekut i cili për çdo ditë do të kujdesej për shëndetin dhe gjendjen e personave të mitur.

E drejta për arsim

Në përgjithësi, sa u përket burgjeve, e drejta e arsimit nuk realizohet ashtu siç parashikohet me rregullat ligjore, duke e pasur parasysh arsimin e obliguar fillor dhe të mesëm. Në veçanti shqetëson fakti se procesi arsimor nuk zbatohet as në burgun për të mitur e as në Entin Edukues-Korrektes.

Nëse ndiqen Rregullat Evropiane të Burgjeve, secili burg duhet të bëjë përpjekje që personave të dënuar t'u mundësojë qasje në programet arsimore, ndërkaq prioritet kanë të dënuarit të cilët janë analfabet ose të cilët nuk kanë arsim fillor ose profesional (vokacion).

E drejta për punë

Në burgjet, të cilët u vizituan nga MPN-ja në vitin 2011, u konstatua angazhim i pjesshëm me punë i personave të privuar nga liria. Së këtejmi u vërejt se nuk ekziston angazhim me punë i personave të dënuar në repartet e mbyllur (Burgu Shkup dhe Burgu Gjevgjeli), si dhe në repartet e paraburgimit.

Për shkak të numrit të pamjaftueshëm të instruktorëve, në Burgun Shkup personat e angazhuar me punë në punëtorinë e zdrakthëtarisë dhe bravandregësisë nuk kanë mundësi që vazhdimisht dhe pa ndërprerje t'i kryejnë aktivitetet e punës (gjatë vizitës së ekipit të MPN-së instruktorët ishin në pushim, ndërsa të dënuarit nuk ishin angazhuar me punë).

Në Burgun Gjevgjeli personat e dënuar të vendosur në Repartin Gjysmë të Hapur, në përputhje me normat ligjore dhe të drejtën që u garantohet, në mënyrë adekuate janë shpërndarë nëpër vendet e punës në rrethin e institucionit ndëshkues-korrektues, ndërsa një pjesë (7 persona të dënuar, sipas përgjigjes së dhënë në pyetësor të cilin MPN-ja e dërgoi Burgut) janë shpërndarë nëpër vende pune jashtë rrethit të Burgut.

Në momentin e vizitës së Burgut Ohër nga 21 persona të dënuar, 9 ishin angazhuar jashtë institucionit, ndërsa 5 ishin angazhuar për nevojat brenda Burgut (gjithsej 14 të angazhuar me punë), që është mbi 50% e personave të angazhuar me punë në burgun e të miturve. Ekipi i MPN-së e përshëndeti këtë gjendje të angazhimit me punë të personave në burgun për të mitur dhe mbështet mbajtjen e mëtutjeshme të këtij trendi sepse angazhimi me punë paraqet faktor të rëndësishëm, si në aspekt të risocializimit ashtu edhe në aspekt të riintegritimit në shoqëri.

Gjatë vizitës së EEK një numër i caktuar i personave ishin angazhuar për kryerjen e punëve konkrete, më së shumti në kuzhinë dhe mirëmbajtjen e higjienës. Në Ent janë të punësuar 6 instruktorë, në të ekzistojnë veglat e nevojshme për zbatimin e angazhimit me punë, por nuk ka lokale adekuate (punëtori) ku do të mund të zbatohet aktiviteti i punës²². Instruktorët u ligjëronin të përkujdesurve pjesën teorike, mirëpo nuk kishin mundësi ta zbatonin pjesën praktike. Ekipi i MPN-së konsideron se gjendja e këtillë është shqetësuese dhe nuk ndikon pozitivisht në kontekst të arsimit dhe edukimit të personave të vendosur në këtë institucion.

E drejta për qëndrim dhe rekreacion në ambient të hapur

Personat e paraburgosur, të vendosur në Burgun Shkup, u ankuan se u kufizohet e drejta e shëtitjeve në ambient të hapur sipas terminit të përcaktuar prej dy orësh. Si kufizim real në praktikë paraqitet dispozita ligjore e cila parashikon që të mos vijnë në kontakt ose të vendosen bashkë personat të cilët janë të dyshuar ose të akuzuar se kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës së njëjtë penale, gjë që në mënyrë shtesë e vështirëson realizimin e kësaj të drejte. Sidoqoftë, një pjesë e madhe e personave të intervistuar konsiderojnë se kjo e drejtë e tyre zbatohet në mënyrë joadekuate dhe një pjesë e tyre u ankuan se u kufizohet koha, vetëm në një orë ose në një orë e gjysmë, ndërsa disa të tjerë u ankuan për pjesën e ditës kur dalin në shëtitje (shumë herët në mëngjes).

²² Konform informatës së marrë nga të punësuarit e EEK

Edhe në Burgun Gjevgjeli ekipit të MPN-së iu ankuan personat e Repartit Gjysmë të Hapur në lidhje me madhësinë e fushës për rekreacion sportiv, si dhe mosekzistimit të palestrës së brendshme, ndërsa ankesat e personave të Repartit të Mbyllur ishin në kontekst të kohëzgjatjes së shëtitjeve ditore dhe qarkullimit të kufizuar në kuadër të dhomës së izolimit ku janë vendosur. Sa i përket kohës së shëtitjes dhe qëndrimit në ambient të hapur të personave të Repartit Gjysmë të Hapur, ekipi i MPN-së konstatoi se pjesën më të madhe të ditës e kalojnë jashtë, në ambient të hapur, varësisht nga kushtet klimatike, ndërsa për personat e Repartit të Mbyllur koha është e kufizuar sipas minimumit ligjor prej dy orësh²³. Gjithashtu, kjo e drejtë kufizohet në minimumin ligjor prej dy orësh edhe për personat e paraburgosur, të cilët të drejtën e shëtitjes e realizojnë në shëtitoren me dimensione të vogla, të rrethuar me mure të larta, pa stole për pushim dhe pa pjesë të mbuluar, e cila do të mundësonte shëtitje edhe në kushte të këqija klimatike.

Në Burgun Ohër personat e dënuar të Repartit të Mbyllur dhe Gjysmë të Mbyllur pohuan se u mundësohet qëndrimi në ambient të hapur, si dhe pushimi, në përputhje me rregullat ligjore dhe rendin e ditës së institucionit. Ekipi i MPN-së konstatoi se pjesa më e madhe e personave të dënuar lëvizin lirisht në shëtitore, ndërsa një pjesë e tyre janë të përfshirë edhe në aktivitete sportive.

Personat e paraburgosur pohuan se u mundësohet e drejta ligjore për shëtitje prej 2 orësh në ditë. Të drejtën e qëndrimit në ambient të hapur e shfrytëzojnë në shëtitoren e posaçme për persona të paraburgosur në të cilën njëra pjesë ishte rrethuar dhe e mbrojtur nga moti i keq.

Të përkujdesurit në Repartin e Pranimit dhe Repartin e Hapur të EEK Tetovë, pohuan se u mundësohet e drejta e qëndrimit në ambient të hapur, si dhe e drejta e pushimit në përputhje me rregullat ligjore dhe rendin e shtëpisë. Personat e mitur, të vendosur në Repartin për Ndikim të Përfortuar Riedukues, vunë në pah se rrallëherë dalin jashtë, por Shërbimi për Sigurim potencoi se personat e mitur kanë të drejtë, çdoherë kur kanë dëshirë, të dalin në shëtitje në shëtitore. Të drejtën e qëndrimit në ambient të hapur ata mund ta shfrytëzojnë në shëtitoren e posaçme të këtij Reparti, një pjesë e së cilës është e rrethuar. Gjatë kohës së pushimit, të përkujdesurve u lejohet të luajnë letra dhe të kenë radioaparate në më tepër dhoma.

E drejta për ushqim

Marrë në përgjithësi njëra nga kritikantët më të mëdha të cilat vijnë nga personat e privuar nga liria kishte të bënte me sasinë dhe cilësinë e ushqimit të cilin e konsumojnë.

Në Burgun Shkup pjesa më e madhe vuri në dukje se ushqimi është i

²³ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve dhe Ligji për procedurë penale e përcaktojnë kohën prej minimum 2 orësh të cilën gjithsecili person i dënuar ose i paraburgosur çdo ditë duhet ta kalojë në ambient të hapur.

pamjaftueshëm dhe se për vaktin e mëngjesit marrin racione të vogla. Në Burgun Gjevgjeli pjesa më e madhe e ankesave kishte të bënte me ushqimin. Të dënuarit nuk ishin të kënaqur nga sasia e ushqimit që u jepej në Burg, prandaj shumica e tyre marrin dërgesa nga familjarët e tyre. Vërejtje të këtilla shprehën të dënuarit e: Repartin të Pranimit, Gjysmë të Hapur dhe Repartin të Mbyllur, me ç'rast u bë këqyrja e listës me ushqime, nga e cila mund të shihej se ekziston shumëllojshmëri e ushqimit e cila, për fat të keq, nga aspekti i sasisë është i pamjaftueshëm për shkak të buxhetit të kufizuar për këtë dedikim.

Në Burgun Ohër në kuzhinë është vendosur lista e ushqimeve, e cila është e nënshkruar me rregull nga drejtori, mjeku dhe kuzhinieri i Burgut. Sipas listës, shërbehet ushqim i shumëllojshëm, por të dënuarit u ankuan në aspekt të sasisë e cila ndahet në racionet e caktuara. Ankesë të njëjtë paraqitën edhe personat e paraburgosur të cilët u ankuan për ushqim të pamjaftueshëm, i cili nuk i plotëson nevojat e personave të rritur.

Në Entin Edukues-korrektues u vërej se në kuzhinë higjiena mirëmbahet në nivel të lartë dhe në të është potencuar lista e ushqimeve, e aprovuar nga mjeku dhe drejtori i Burgut. Në përputhje me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve, personit të mitur i sigurohet ushqim të cilin duhet ta konsumojë brenda një dite, përkatësisht që duhet të ketë më së paku 14.600 xhaul. Sipas informatës së edukatorit, të miturit marrin 4 racione bashkë me zëmëren, ndërsa në Ent janë të punësuar dy kuzhinierë. Sipas listës së ushqimit, në Ent ka ushqim të shumëllojshëm, një pesë e të miturve janë të kënaqur nga ushqimi, por një pjesë tjetër u ankua për sasinë e ushqimit, sidomos të bukës e cila ndahet gjatë racioneve të parashikuara. Ankesë të njëjtë shprehën edhe të miturit e vendosur në Repartin për Ndikim të Përfortuar Riedukues duke theksuar se ushqimi i cili ndahet është i pamjaftueshëm për t'i kënaqur nevojat e tyre.

Veprimi me personat e privuar nga liria

Nga Burgu Shkup, varësisht nga repartet, janë dhënë përgjigje të ndryshme nga personat e dënuar dhe të paraburgosur në lidhje me trajtimin e shërbimeve të burgut. Në Repartin e Hapur dhe Gjysmë të Hapur personat me të cilët u zhvillua bisedë nuk u ankuan sa i përket trajtimit dhe sjelljes së shërbimeve në këtë burg, por personat e Repartin të Mbyllur informuan për keqtrajtim fizik dhe trajtim jonjerëzor nga ana e Sektorit për Sigurim.

MPN-ja u informua nga personat e vendosur në reparte të ndryshëm (në Repartin e Mbyllur, Gjysmë të Hapur dhe Repartin e Paraburgimit) për ekzistimin e dhomës ku disa persona janë keqtrajtuar fizikisht nga ana e personave zyrtarë. Në këtë burg janë vërejtur edhe persona të cilët vetëlëndohen ose kanë bërë përpjekje për vetëvrasje dhe për këtë arsye MPN-ja sugjeroi nevojën për përfshirjen e programeve të veçanta për reduktimin e rreziqeve

nga vetëlëndimi i personave të privuar nga liria.

Personat e privuar nga liria u ankuan edhe për mbrojtjen shëndetësore dhe sjelljen e shërbimeve mjekësore, si dhe ndaj edukatorëve sepse nuk u kushtojnë vëmendje të mjaftueshme në procesin e risocializimit.

Personat e paraburgosur cekën se gjyqtarët nuk hyjnë në dhoma kur bëjnë vizitën e personave të paraburgosur dhe se personave të mitur nuk u lejohet t'i vizitojnë personat e paraburgosur.

Në Burgun Gjevgjeli personat e vendosur në Repartin e Pranimit u shprehën të kënaqur dhe nuk patën vërejtje për kushtet e vendosjes dhe për trajtimin e tyre nga ana e personave zyrtarë. Personat e vendosur në Repartin Gjysmë të Hapur përgjithësisht nuk kishin vërejtje, sa i përket torturës ose trajtimeve tjera brutale, jonjerëzore ose nënçmuese nga ana e shërbimeve të Burgut. Personat e vendosur në Repartin e Mbyllur nuk kishin ankesa në lidhje me veprimin dhe trajtimin, por më tepër për realizimin e të drejtës së tyre për shëtitje ditore për shkak të kufizimit të kohës nën minimumin ligjor. Dy persona, të cilët vuanin masën disiplinore "vendosje në dhomë izolimi", u ankuan për dhunë fizike nga Shërbimi i Sigurimit gjatë kthimit së tyre në Burg për shkak të arratisjes paraprake.

Në Burgun Ohër, sipas personave të vendosur në Repartin e Mbyllur, sjellja e Sektorit për Sigurim në përgjithësi është korrekte, por sipas një personi tjetër kjo sjellje mund të jetë akoma më e mirë sepse ndonjëherë, një pjesë e të punësuarve, sillen në mënyrë përcmuese, ndërsa në rast të dhunës midis personave të dënuar përdoren edhe mjete të dhunës. Sektori për Sigurim theksoi se kohëve të fundit nuk ka pasur ankesa për sjelljen e tyre ndaj personave të dënuar, por një pjesë e të dënuarve cekën se nuk mund të ankojnë tek drejtori për sjellje jonjerëzore dhe përcmuese të shërbimeve sepse e kanë për detyrë që bisedën ta paralajmërojnë në Shërbimin e Sigurimit. Pjesa më e madhe e personave të dënuar dhe të paraburgosur nuk patën vërejtje në lidhje me veprimin e të punësuarve në Burg dhe vetëm një pjesë e vogël reagoi për sjelljen e një pjese të të punësuarve në Sektorin për Sigurim. Numri më i madh i ankesave vjen nga ana e personave të paraburgosur. Personat e paraburgosur u ankuan në shërbimet e burgut sa i përket sigurimit të mjeteve higjienike, sasisë së vogël të ushqimit, si dhe ngrohjes së dobët të ambienteve të paraburgimit.

Në Entin Edukues-Korrektues të miturit e vendosur në Repartin e Pranimit nuk patën vërejtje për kushtet e vendosjes dhe trajtimin e tyre nga personat zyrtarë. Personat nga ky Repart nuk patën kurrfarë ankesash ndaj sjelljes së të punësuarve. Një pjesë e personave të vendosur në Repartin e Hapur konsideronin se sjellja e Sektorit për Sigurim është korrekte, në përgjithësi nuk kishte vërejtje sa i përket dhunës fizike ose formave tjera të trajtimit jonjerëzor ose përcmues nga shërbimet e Burgut, ndërsa një pjesë e të miturve vunë në dukje se disa të punësuar janë sjellë në mënyrë përcmuese ndaj tyre.

Personat e vendosur në Repartin për Ndikim të Përforcuar Riedukues në përgjithësi kishin më shumë vërejtje ndaj sjelljes së shërbimeve të EEK. Sjelljen e Sektorit për Sigurim ndaj tyre e vlerësuan si jo korrekte sa duhet, numri më i madh i personave të mitur kishin ankesa në lidhje me sjelljen e shërbimeve për sigurim, madje u ankuan edhe për dhunë fizike.

Ankesa pati edhe sa i përket vendosjes së personit të mitur individualisht në dhomë izolimi, gjë që është në kundërshtim me dispozitat ligjore, si dhe me ekzistimin e rasteve për tentativë për vetëlëndim. Personat e vendosur në këtë Repart u ankuan se shpeshherë lahen me ujë të ftohët, rrallëherë u lejohet të dalin jashtë dhe mbahen të mbyllur e të izoluar në një pjesë të vogël të institucionit, ndërsa në raste të caktuara nuk informohen, e as nuk thirren kur prindërit e tyre i kërkojnë në telefon.

Evidenca dhe regjistrat

Në Burgun Shkup u konstatua mbajtja me rregull e evidencave për personat e dënuar, si dhe dosjeve elektronike për gjithsecilin person të dënuar, me të gjitha informatat në lidhje me dënimin e shqiptuar, si dhe sjelljen e personit të dënuar.

Në Burgun Gjevgjeli u konstatua mbajtja me rregullt e evidencës amë për personat e dënuar në të cilën përmbahen të gjitha informatat që kanë të bëjnë me shqiptimin e masës dhe sjelljen e personit të dënuar, ndërsa konstatimi i njëjtë ka të bëjë edhe me Burgun Ohër.

Në Burgun Ohër dosjet profesionale të personave të dënuar udhëhiqen me rregull dhe në to është përfshirë programi për risocializim. Në bazë të informatave për përdorimin e mjeteve të dhunës u konstatua se në evidencë nuk ekzistojnë shënime përkatëse për përdorimin e mjeteve të dhunës e as raporte përkatëse me shkrim për përdorimin e forcës ndaj personave të dënuar.

Ekipi i MPN-së realizoi këqyrje në disa libra dhe evidenca, ndërsa konkluzion i përgjithshëm është se regjistrat në EEK Tetovë, në përgjithësi udhëhiqen me rregull dhe në përputhje me rregullat ligjore. MPN-ja realizoi këqyrje në programin për aktivitete të lira dhe në evidencën e veçantë për punën dhe trajtimin në grupe, me ç'rast konstatoi se një herë në javë mbahen takime grupore në të cilin diskutohen të gjitha çështjet më të rëndësishme me interes për fëmijët, si dhe për problemet rrjedhëse.

Konkluzion i përgjithshëm për institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe edukuese korrektuese është se jo gjithmonë dhe as tërësisht nuk plotësohen librat për përdorimin e mjeteve të dhunës, si dhe librat për ankesa. Nevojitet që edhe ankesat gojore të evidentohen në librin për ankesa (në EEK libri ishte bosh për vitin 2011), ndërkaq çdo përdorim i dhunës, ku përfshihen edhe

mjetet për lidhje, të evidentohet në Librin për përdorimin e këtyre mjeteve (në Burgun Ohër libri ishte bosh për vitin 2010 dhe 2011, e njëjta situatë u vërejt edhe në Burgun Gjevgjeli). Vetëm në Burgun Shkup, në Librin për përdorimin e mjeteve të dhunshme, ishin shënuar me rregull të gjitha masat e ndërmarra në rastet kur këto mjete aplikohen për kohë të shkurtër ose më të gjatë. Në këtë Burg për çdo përdorim të mjeteve të dhunës ekziston dokumentacion i rregullt, si dhe vlerësim për justifikimin e përdorimit të mjeteve të dhunës.

C. VENDE TJERA TË VIZITUARA

Në vitin 2011 MPN-ja realizoi vizita të rregullta të paparalajmëruara në Institucionin Publik - Qendrën për Vendosjen e Personave Azilkërkues dhe Institucionin Publik Entin për Përkujdesje, Edukim dhe Arsim të Fëmijëve dhe të Rinjve "Ranka Milanoviq" – Shkup. Edhe pse Qendra dhe Enti janë institucione publike me karakter të hapur, përkatësisht të llojit gjysmë të hapur, nën kompetencë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Avokati i Popullit, si Mekanizëm Parandalues Nacional, vendosi t'i vizitojë këto institucione në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga neni 4 dhe neni 20 i Protokollit Fakultativ.

Qendra për Azilkërkues

Qendra është institucion publik, i themeluar me vendim të Qeverisë²⁴ së Republikës së Maqedonisë, me qëllim të vendosjes, të ushqyerit, shërbimeve të punëve sociale, aktiviteteve kulturore-zbavitëse dhe shërbimeve tjera, konform standardeve minimale për pranimin e azilkërkuesve, të përcaktuara me akte ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë. Gjatë vizitës, MPN-ja konstatoi se numri i të punësuarve në Qendër (gjithsej 11) nuk është i mjaftueshëm, si dhe se nuk ka profile përkatëse të cilët mund t'u përgjigjen nevojave të azilkërkuesve.

Kapacitetet e Qendrës për pranim përbëhen nga tri ndërtesa me ndërtim të fortë, në cilat e para është ndërtesa administrative në përbërje të së cilës gjenden: zyrat ku pranohen personat, qendra kompjuterike, kuzhina e vogël, mensa, dhoma për ndihmë juridike dhe ambulanca e Kryqit të Kuq. Ndërtesa e dytë dhe e tretë përbëhen nga kapacitetet e vendosjes në Qendër. Kapaciteti i përgjithshëm është 150 persona, ndërsa gjatë kohës së vizitës ekipi i MPN-së konstatoi se ndërtesa e dytë ishte mbyllur sepse i ishte nënshtruar rinovimit të plotë dhe të thellë. Gjendja e këtyre, pashmangshëm ka kontribuar për rritjen

²⁴ Vendimi për themelimin e Institucionit Publik për Vendosjen e Personave Azilkërkues, Nr. 19-5620/1 ("Gazeta Zyrtare e RM"-së" nr. 122/2007)

e konsiderueshme të kapaciteteve ekzistuese përmes numrit më të madh të krevateve në ndërtesën e parë, që të mund t'u përgjigjet në mënyrë adekuate obligimeve ligjore për vendosjen e personave azilkërkues. Kështu, si problem i mundshëm paraqitet mbipopullimi sepse ekzistojnë dhoma edhe me nga 8 dhe 9 krevate, pa shtroje dhe jastëkë, e as mobile shtesë (tavolina dhe karrige) dhe dollapë shtesë për ruajtjen e sendeve personale.

Edhe pse objekti është me ndërtim të fortë dhe është lëshuar në përdorim 3 vjet përpara, ai është në gjendje relativisht të keqe, me instalime të amortizuara dhe pajisje jofunksionale. Pjesa përdhese e ndërtesës është dukshëm më e amortizuar sesa pjesa e sipërme, për çka, përkundër kualitetit të materialeve dhe mënyrës së ndërtimit, kontribuojnë edhe personat e vendosur. Në gjendje më të keqe janë nyjat sanitare, rubinetet e çezmave dhe dushet të cilat ose nuk punojnë ose janë të thyer²⁵ ndërkohë që edhe higjiena është në nivel tejet të pakënaqshëm. Familjet e pranuar u ankuan për mjetet e pamjaftueshme për mirëmbajtjen e higjienës personale, si dhe higjienës së toaleteve.

Gjatë vizitës së ndërtesës së dytë për vendosje, MPN-ja konstatoi se e njëjta rinovohet dhe sapo të lëshohet në përdorim do t'i përmbush të gjitha standardet për vendosjen e kësaj kategorie të personave.

MPN-ja konstatoi se personat e mitur të pashoqëruar jo çdoherë vendosen ndaras nga personat e rritur, si dhe nuk vendosen ndaras as meshkujt nga femrat dhe nënat e vetme (me përjashtim të vendosjes familjare).

Mbrojtja shëndetësore primare, në kuadër të Qendrës, realizohet me mjek të praktikës së përgjithshme të cilin e angazhon Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë, përmes kontratës me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale. MPN-ja konsideron se mënyra e këtillë e angazhimit të mjekut nuk është zgjidhja më adekuate dhe se Qendra duhet të ketë mjek të punësuar të përhershëm. Mbrojtja shëndetësore primare u ofrohet azilkërkuesve në kohëzgjatje prej 9 orë në javë, më saktësisht nga tri orë gjatë tri ditëve të javës. MPN-ja konsideron se mbrojtja shëndetësore duhet të zbatohet jo vetëm sipas nevojës, por edhe në mënyrë parandaluese, ndërsa për këtë qëllim mjekut duhet t'i sigurohet lista e azilkërkuesve të sapo pranuar, me qëllim që të mund të organizojë kontroll përkatës mjekësor dhe të udhëheqë evidencë adekuate shëndetësore gjatë pranimit. Ekipi i MPN-së vuri re se, sa i përket evidencës shëndetësore, nuk udhëhiqen kartonët shëndetësorë për secilin person, por gjendja e tyre shëndetësore paraprahe, kontrolli i kryer, gjendja e konstatuar momentale dhe trajtimi i ofruar shënohen në librin unik të ambulancës për kontrolle dhe terapi. Me praktikën e këtillë deri diku lehtësohet dhe përshpejtohet puna e mjekut, mirëpo mund të ndikojë në ndjekjen e vazhdueshme dhe me kohë të gjendjes shëndetësore të personave dhe të ndikojë në kualitetin dhe trajtimin e tyre. Mjeku nuk është i përfshirë në përpilimin e listës javore dhe mujore të ushqimeve e cila do të mund t'i kënaqte nevojat energjike për

²⁵ Nga përfaqësuesi i Qendrës së Pranimit u informuam se nga buxheti i MPPS janë siguruar mjete për rubinete, çezma dhe masha për ngrohjen e ujit të bojlerëve dhe se pajisjet e dëmtuara do të zëvendësohen me të reja.

ushqim dhe karakteristikat kulturologjike të kësaj kategorie të personave.

Me qëllim të njoftimit të drejtë dhe në kohë të personave me të drejtat e tyre, MPN-ja konsideron se duhet të sigurohen informata më të hollësishme dhe në kohë për rendin e shtëpisë në gjuhën të cilën e kuptojnë personat, duke i përkthyer ato në disa gjuhë të cilat më së shpeshti i flasin azilkërkuesit. Për përmirësimin e gjendjeve duhet të parashikohet edhe formular i veçantë për ankesa dhe regjistër i veçantë për ankesat gojore.

Në mënyrë që të eliminohen rastet e dhunës fizike midis personave azilkërkues, si dhe rastet e lëndimit ose vetëlëndimit të mundshëm, duhet të përcaktohet protokollin për veprim në raste të dhunës dhe incidenteve midis personave të vendosur në Qendër. MPN-ja sugjeroi nevojën e vendosjes së koordinimit me MPB-në në pjesën e lëshimit me kohë të dokumentit të identifikimit për azilkërkuesit, konform obligimit nga neni 40 i Ligjit për azil dhe mbrojtje të përkohshme.

Konstatimet dhe rekomandimet konkrete e të detajuara janë përfshirë në raportin e veçantë për vizitën e realizuar, i cili i është i dërguar Qendrës dhe MPPS.

Enti për Përkujdesje, Edukim dhe Arsim të Fëmijëve dhe të Rinjve "Ranka Millanoviq"

Enti përbëhet nga tri ndërtesa të ndara – ndërtesa administrative, ndërtesa për mësim (ku gjendet edhe pjesa e vendosjes së vashave) dhe ndërtesa për vendosjen e personave meshkuj (ku në katin e sipërm janë vendosur personat e zhvendosur të brendshëm). Kapaciteti i institucionit është 75 të përkujdesur, ndërsa në momentin e vizitës ishin gjithsej 27 persona të mitur, që të gjithë të gjinisë mashkullore. Sa i përket strukturës etnike, MPN-ja u informua se pjesa më e madhe e tyre janë romë²⁶. Të gjithë të punësuarit, të cilët janë të përfshirë në procesin edukativ-arsimor, janë maqedonas dhe vetëm një edukator është shqiptar, ndërkohë që nuk kishte asnjë rom, me ç'rast mund të konstatohet se struktura etnike e të punësuarve nuk përkon me strukturën e shumicës së fëmijëve të cilët janë të vendosur në këtë institucion.

Gjatë vizitës u vërejt prezenca e më pak se 50% e të përkujdesurve, nga numri i përgjithshëm i personave të vendosur, përkatësisht vetëm 12 të përkujdesur, ndërsa sipas kontrollit të gjendjes së numrit të të miturve, në mëngjes mungonin pa leje madje 11 fëmijë, gjë që e vë në pikëpyetje efikasitetin dhe qëllimin e procesit të edukimit dhe zhvillimit të drejtë të të miturve të përkujdesur në këtë institucion.

Pjesa më e madhe e fëmijëve mësimin e ndjekin në paralele të kombi-

²⁶ Në momentin e vizitës 20 fëmijë ishin të bashkësisë rome (ose rreth 75% nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të vendosur).

nuar (nga klasa e 1 - 5), gjë që në mënyrë plotësuese vë në dukje nivelin e ulët të arsimit të kësaj kategorie të fëmijëve dhe nevojën për punë plotësuese të përforcuar në procesin edukativ-arsimor. Klasat dhe dhomat për zbavitje janë të rinovuara, ndërsa mobilet janë standarde sikurse edhe në klasat e tjera për mësim të rregullt në arsimin fillor.

MPN-ja konsideron se dhomat në repartin e meshkujve nuk janë të pajisura sa duhet dhe i përmbushin vetëm parakushtet elementare minimale për vendosje (krevat dhe dollap për sende personale), ndërkaq mungojnë edhe parakushtet e tjera materiale-teknike dhe pajisjet tjera ndihmëse, gjë që mund të ndikojë negativisht në procesin e edukimit, riedukimit dhe zhvillimit të drejtë të fëmijëve. Higjiena në dhoma nuk mirëmbahet me rregull dhe nuk është në nivel të kënaqshëm. Edhe pse dhomat janë rinovuar para pak kohësh, megjithatë mund të vërehen dëmtime të caktuara të ambientit për vendosje, ndërsa urgjentisht duhet të bojatisen muret. MPN-ja konsideron se gjendja e toaleteve dhe dusheve në kapacitetet e vendosjes për meshkuj është shqetësuese (fëmijët pohuan se dushet nuk punojnë dhe se detyrohen të marrin ujë me kova ose të bëjnë dush në repartin e femrave).

Reparti i femrave përbëhet nga tri dhoma gjumi, të cilat në momentin e vizitës nuk ishin në funksion sepse të gjithë fëmijët e institucionit ishin meshkuj.

Nga bisedat e zhvilluara, MPN-ja konstatoi se fëmijët kryesisht janë të kënaqur me kushtet dhe trajtimin e të punësuarve ndaj tyre. Asnjë fëmijë nuk u ankua për trajtim të keq ose për dhunë fizike apo lloj tjetër të dhunës nga të punësuarit në institucion. Ekipi i MPN-së konstatoi se të gjithë fëmijët janë të veshur në mënyrë adekuate, konform kushteve klimatike dhe në kuadër të mundësive dhe buxhetit të cilin e ka në dispozicion institucioni. Fëmijët kërkuan që konstruksionet e hekurt të krevateve të zëvendësohen me materiale tjera, ndërsa sa i përket ngrohjes disa nga fëmijët u ankuan se ngrohja është e dobët dhe se nuk ka ngrohje të kënaqshme. Numri më i madh i ankesave ka të bëjë me kushtet materiale nëpër dhomat e vendosjes dhe në toaletet, gjë që u konstatua edhe nga ekipi i MPN-së gjatë inspektimit të drejtpërdrejtë në këto ambiente.

Mbrojtjen shëndetësore primare e realizon mjeku amë tek i cili janë të regjistruar fëmijët (mjeku amë për të përkujdesurit në këtë institucion është mjeku i ambulancës së Autokomandës), ndërsa ndihma dhe kujdesi i përditshëm shëndetësor zbatohet në kuadër të institucionit nga personi mjekësor me punë të përhershme në Ent. Duke e pasur parasysh se personi i punësuar nuk është mjek, në dhomën e ambulancës nuk ruhen kartonët e mjekësor të fëmijëve – ato i plotëson dhe ruan në mënyrë adekuate mjeku amë në ambulancën në Autokomandë.

Si problem më i madh paraqitet zgjidhja me të cilën secili fëmijë i siguron kartonët për sigurim shëndetësor të cilët i merr direkt nga qendra për punë sociale (QPS), në vendin prej ku vjen. Në praktikë kjo zgjidhje është vështirë e zbatueshme dhe e pengon qasjen e rregullt në shërbimet shëndetësore dhe trajtimin me kohë të fëmijëve për shkak se kartonët e kaltër që

vijnë nga qytetet e tjera, vonohen rregullisht madje edhe nga disa javë. Kjo kontribuon në humbjen e besimit të vendosur mes mjekut dhe fëmijëve²⁷.

Gjatë vizitës, MPN-ja shprehu shqetësim edhe në lidhje me organizimin e punës dhe zbatimin e aktiviteteve në institucion sepse fitoi përshtypje se mësimi zhvillohet me prezencë të një numri të nxënësve që nuk kënaq, ndërsa të miturit (me përjashtim të 3-4 fëmijëve) nuk ishin angazhuar në asnjë aktivitet, por bënin gjumë, qëndronin nëpër dhomat e tyre të gjumit ose shikonin televizor në dhomën e përbashkët për qëndrim ditor.

MPN-ja konsideron se ekziston nevoja për pajisje shtesë, përkatësisht ambiente me dedikim në të cilët do të zhvilloheshin aktivitete të lira për fëmijët, si dhe do të zhvillonin trajnime duke u nisur nga trajnimet më elementare për aftësimin në jetë, për motivimin e fëmijëve, për zhvillimin e shkathtësive teknike dhe angazhimin e personelit përkatës.

MPN-ja u informua se në këtë institucion nuk janë regjistruar raste të dhunës mbi fëmijët nga ana e personave të punësuar²⁸, mirëpo ka pasur raste të lëndimeve gjatë kontakteve fizike të ndërsjella të fëmijëve, e që sipas informatave, nuk ka qenë rezultat i dhunës fizike. MPN-ja konsideron se të gjitha rastet e dhunës fizike mes fëmijëve, dhunës drejt/nga të punësuarit ose personave të tretë dhe rastet e vetëlëndimeve duhet evidentohen në regjistër/libër të veçantë.

Konstatimet dhe rekomandimet konkrete e të detajuara janë prezantuar në raportin e veçantë për vizitën dhe i njëjti i është dërguar Entit dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale.

²⁷ MPN-ja konsideron se zgjidhja e këtillë është në kundërshtim të drejtpërdrejt dhe e pengon realizimi e obligimeve të shtetit të cilat përcaktohen me nenin 24, paragrafin 1 dhe paragrafin 2 (a) të Konventës së KB-së për të Drejtat e Fëmijës, sipas së cilës shteti duhet të sigurojë se asnjërit fëmijë nuk do t'i merret/kufizohet qasja në shërbime shëndetësore, si dhe se shteti duhet të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme me të cilat do të mundësojë ndihmën e domosdoshme mjekësore dhe mbrojtjen shëndetësore me theks të veçantë në zhvillimin e mbrojtjes shëndetësore primare.

²⁸ MPN-ja potencon se asnjëri nga disa fëmijët, me të cilët u zhvillua bisedë, nuk u ankua në aspekt të trajtimit ndaj tyre nga të edukatorët dhe kuadri mësimor i punësuar.

4 MBROJTJA E TË MITURVE NË VENDET E PRIVIMIT NGA LIRIA

Veprimi me të miturit, si dhe realizimi të drejtave të tyre gjatë periudhës së privimit nga liria, u shqyrtuan në mënyrë të veçantë gjatë vizitave të realizuara nga Mekanizmi Parandalues Nacional.

Gjatë vizitave parandaluese, të realizuara në vitin 2011, u mor parasysh Konventa për të Drejtat e Fëmijës, si dhe të ashtuquajturat Rregullat e Pekinit ose Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e të Miturve, të cilat janë rregulla bazë për mbrojtjen e të miturve të cilët bien ndesh me ligjin.

Gjatë vizitave të stacioneve policore njëkohësisht u përfshinë edhe aktet juridike të shtetit, me të cilët rregullohet veprimi me personat e mitur. Këtu vëmendje e veçantë iu kushtua zbatimit të Ligjit për të drejtat e të miturve, si dhe aktet nënligjore gjatë veprimit policor me të cilët rregullohet materia që ka të bëjë me të drejtat e personave të mitur.

Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e të miturve e rregullojnë kontaktin e parë të privimit nga liria të të miturit.²⁹ Kjo çështje përfshihet edhe në Ligjin për të drejtat e të miturve³⁰. Ligji për të drejtat e të miturve, në vitin 2010, pati dy zvarritje dhe ndryshime të cilat pasuan pas vlerësimeve të opinionit të ekspertëve për efikasitetin e thirrjes së mbrojtësit në procedurën me të mitur. Në Ligj është rregulluar çështja e njoftimit, kur bëhet fjalë për fëmijë në rrezik i cili ka kryer veprë e cila me ligj përcaktohet si veprë penale për të cilën parashikohet dënim deri tre vjet, me ç'rast Ministria e Punëve të Brendshme përmes prokurorit publik dërgon njoftim pranë qendrës për punë sociale.

Neni 109, nga Ligji i njëjtë, e rregullon problematikën e ndalimit të personit të mitur dhe përcakton se biseda me të miturit mund të zgjasë më së shumti 4 orë, ndërsa ndalimi të jetë deri 12 orë. Gjatë vizitave në dy stacione policore (SP Gostivar dhe SP Makedonski Brod), MPN-ja konstatoi ndalim të të miturve më gjatë sesa afati i lejuar me ligj. Në dy raste u evidentua ndalim i personit të mitur madje 22 orë, e që është në kundërshtim me përcaktimin

²⁹ Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për zbatimin e procedurave gjyqësore ndal të miturve – 1985: pika 10 – Kontakti i parë: (1) Për privimin nga liria të të miturit, duhet të njoftohen menjëherë prindërit e tyre, përkatësisht kujdestari. Nëse nuk është e mundur të bëhet njoftimi menjëherë, atëherë kjo duhet bërë në afat sa më të shkurtër kohor. (2) Gjyqtari ose nëpunësi ose organi kompetent doemos duhet pa prolongim, ta shqyrtojë mundësinë e lëshimit në liri. (3) kontakti mes shërbimeve të cilët e zbatojnë ligjin dhe të miturit duhet të realizohet me zbatimin e statusit ligjor, kujdesin për interesat e tij dhe shmangien e shkaktit të vuajtjeve, me këtë rast duke mbajtur llogari për rrethanat specifike të rastit individual.

³⁰ Ligji për të drejtat e të miturve ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 87/2007 dhe nr. 145/2010)

kohor maksimal prej 12 orësh, në përputhje me nenin 109 të Ligjit për të drejtat e të miturve.

Nëpunësit e autorizuar zyrtarë mund të ndalojnë të mitur nëse ekziston bazë se ka kryer veprim i cili përcaktohet me ligj si veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, nëse haset duke e kryer veprën ose kur kundër tij është lëshuar urdhër-arrest për veprë të tillë. Në rast të prishjes së rendit dhe qetësisë publike personi i mitur mund të ndalohej 8 orë.

Së këtejmi, nëpunësit policorë e kanë të detyrë ta njoftojnë gjyqtarin për të mitur, prindërit, përkatësisht kujdestarin, mbrojtësin e caktuar nga i mituri ose nga prindërit e tij dhe qendrën për punë sociale, ndërsa gjatë kohës së ndalimit nuk mund të zhvillohet bisedë pa prezencën e mbrojtësit. Me ndryshimet e Ligjit për të drejtat e të miturve nga viti 2010 edhe pse parashikohet prezencë e detyrueshme e mbrojtësit gjatë kohës së zhvillimit të bisedës me të miturin, kjo e drejtë në mënyrë të konsiderueshme u pamundësua me përcaktimin që shpenzimet për mbrojtësin të bien mbi barrën e të miturit ose prindit, ndërsa në rastet kur nuk kanë mundësi t'i mbulojnë vet, këto shpenzime bien mbi barrën e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (për çka duhet të paraqitet provë pranë qendrës për punë sociale në përputhje me Ligjin për mbrojtje sociale). Në rastet kur i mituri ose prindërit e tij nuk mund të sigurojnë mbrojtës, nëpunësit policorë të MPB-së duhet të kërkojnë nga qendra që menjëherë të caktojë mbrojtës nga lista e avokatëve e dërguar nga Dhoma e Avokatëve³¹.

Nga vizitat e realizuara në vitin 2011, u konstatua se në të shumtën e rasteve nëpunësit policorë i njoftojnë prindërit dhe qendrën për punë sociale, por nuk mund të sigurojnë prezencën e mbrojtësit. Bisedat zhvillohen në zyrat në të cilat, në numrin më të madh të rasteve, gjenden edhe inspektorë të tjerë (SP Koçan, dhe SP Kriva Pallankë), prandaj në situata të kështilla ndodh që inspektori për delikuencë të të miturve të kërkojë nga kolegët e tij ta braktisin ambientin derisa zhvillohet biseda me të miturin, mirëpo në praktikë ka situata kur biseda zhvillohet në prezencën e inspektorëve tjerë. Në Republikën e Maqedonisë ka stacione policore në të cilat ambientet e inspektorëve për delikuencë të të miturve fizikisht janë të ndarë nga inspektorët e tjerë (stacionet policore: Kumanovë, Aerodrom, Tetovë, Prilep) dhe vetëm në ato ambiente zhvillohen bisedat me personat e mitur, edhe pse nuk janë të rregulluara në mënyrë adekuate për këtë dedikim. Nga stacionet e vizituara policore, vetëm në Stacionin Policor Kisella Vodë kishte ambient të veçantë të rregulluar për biseda me personat e mitur.

Autorizimet policore ndaj personave të mitur i zbatojnë nëpunësit policore të cilët janë të aftësuar për luftimin e delikuencës tek të miturit³². Në raste të jashtëzakonshme, autorizime policore ndaj personave të mitur mund

³¹ Neni 109, paragrafi 7 nga Ligji për drejtësi të të miturve ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 87/2007 dhe nr. 145/2010)

³² Neni 37 nga Ligji për polici ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 114/2006 dhe nr. 06/2009)

të zbatojnë edhe nëpunës tjerë policorë, nëse për shkak të rrethanave të rastit nuk mund të veprojnë nëpunësit policorë të aftësuar dhe të caktuar për punë me të miturit.

Në Rregulloren për mënyrën e kryerjes së punëve policore³³ ceket se zbatimi bëhet nga nëpunësit policorë me rroba civile, si dhe me automjete pa bishkrime, ndërsa Procedurat Standarde Operative për ndalim dhe procedurat me personat e ndaluar imponojnë që në procedurën me të mitur të njoftohet inspektori kompetent, prindi ose kujdestari, avokati, qendra për punë sociale dhe prokurori kompetent publik. Përgjegjësi i turnit i stacioni policor kujdeset për trajtimin e personit të mitur, ndërsa për procedurën në përgjithësi është kompetent inspektori për delikucencë të të miturve.

Gjatë vizitave në vitin 2011, ishte evidente se në numrin më të madh të stacioneve policore ka të caktuar inspektorë për delikucencë të të miturve, të cilët mjaft mirë e njohin Ligjin për të drejtat e të miturve, si dhe Ligjin për polici. Nga 12 stacionet e vizituara, në dy stacione policore, u konstatua mospasje të inspektorit për drejtësinë e të miturve (Draçevë dhe Kriva Pallankë) dhe në këto raste thirret inspektor nga stacion tjetër policor ose me të miturin vepron inspektori për krime të përgjithshme, i cili paraprakisht është i trajnuar për të vepruar me persona të mitur.

Në disa stacione policore inspektorët për delikucencë të të miturve punojnë në turne dhe bëjnë kujdestari në orët e natës dhe vikendeve, por në disa stacione këta inspektorë angazhohen vetëm në turnin e parë, kështu që vihet në pikëpyetje veprimi me të miturit kur inspektorët nuk janë në punë.

Nga këqyrja në dokumentet e punës dhe gjatë bisedave me inspektorët për delikucencë të të miturve u konstatua bashkëpunim solid me qendrën për punë sociale. Në stacione të caktuara policore u potencua se personat zyrtarë të qendrës marrin pjesë kur prindërit nuk kanë mundësi të jenë prezent me personin e mitur, por në një stacion u tha se Ligji për të drejtat e të miturve vështirë zbatohet për shkak të pamundësisë që pas orës 16:00 (pas orarit të rregullt të punës) të sigurohet prezenca e personave zyrtarë të qendrës për punë sociale.

Ligji për të drejtat e të miturve, në nenin 109 përcakton se personat e autorizuar zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme e ndalojnë personin e mitur në ambient për ndalimin e të miturve. Gjatë vizitave, MPN-ja konstatoi se stacionet policore nuk kanë ambient të veçantë për ndalimin e të miturve, përkatësisht diku ndalohen në ambientet ekzistuese për ndalim, ndërsa diku në ambientet zyrtare ose sallat e mbledhjeve me prezencën e nëpunësve policorë pa uniformë, e që në të vërtetë paraqet mosrespektim të obligimit të nenit 109 të Ligjit për të drejta të të miturve.

Problem më i madh në procedurën me të mitur në stacion policor, i konstatuar nga MPN-ja, është sigurimi i mbrojtësit. Edhe pse Ligji imponon prezencën e mbrojtësit, si dhe nënshkrimin e tij në procesverbalin për ndalim,

në këqyrjen në evidencë, gjatë veprimit me të miturit nuk u vërejtën raste të prezencës së mbrojtësit. Tendencë e përgjithshme është mosardhja e avokatëve në rastet me të miturit për shkak të mospajësimit ose sigurimit jo në kohë të kompensimit të shpenzimeve.

Përkatësisht, në pjesën e thirrjes së mbrojtësit praktika është e ndryshme – disa stacione policore drejtpërsëdrejti i njoftojnë avokatët, ndërsa ata refuzojnë të shkojnë, ndërkaq stacionet e tjera i njoftojnë qendrat për punë sociale të cilat, sipas tyre, janë të obliguara ta njoftojnë avokatin. Korniza ligjore parashikon zgjedhjen e avokatit nga ana e prindit, ndërsa nëse nuk realizohet kjo, nevojitet që qendra për punë sociale të caktojë avokat nga lista e avokatëve e dërguar nga Dhoma e Avokatëve. Nëse ndiqet Ligji dhe strukturimi organizativ i qendrave, ajo që u tha gjatë bisedës me inspektorët është mospasja e qasjes deri te qendrat në interes të të miturve, me të cilët policia duhet të punojë dhe të zhvillojë bisedë.

Në pjesën e veprimit policor me të mitur, duke i ndjekur dispozitat e Ligjit për të drejtat e të miturve, si dhe standardet ndërkombëtare, si dobësi mund të ceket: 1) mospasja e ambienteve të veçanta për ndalimin e të miturve, 2) mos ndarja hapësinore e zyrës së inspektorëve për delikucencë të të miturve dhe prezencës së mundshme të inspektorëve tjerë gjatë zhvillimit të bisedës me personin e mitur, e që mund të ndikoj në frikësim dhe stres tek të miturit dhe 3) sigurimi i mbrojtësit për personin e mitur i cili është në konflikt me ligjin. Struktura ekzistuese ligjore përcakton të drejtën për të pasur mbrojtës, i cili detyrimisht duhet të merr pjesë në bisedën me personin e mitur, kur i njëjti ndalohet, por edhe obligimin që shpenzimet të jenë mbi barrën e të miturit ose prindërve të tij. Si zgjidhje është paraparë që mbulimin e shpenzimeve për avokat ta bëjë Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, atëherë kur prindi nuk mund t'i paguajë të njëjtat, por nuk është zgjidhur pjesa kur prindi nuk dëshiron t'i pranojë shpenzimet për mbrojtës të fëmijës së vet. Njëkohësisht, që të mund të sigurohet mbrojtësi mbi barrë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale duhet të paraqitet provë pranë qendrës për punë sociale konform Ligjit për mbrojtje sociale por, në këtë pjesë të procedurës për përcaktimin e ndihmës juridike për fëmijën, përkatësisht të riun ose të miturin më të madh në rrezik, nuk është përfshirë elementi i urgjencës, duke e pasur parasysh periudhën maksimale të ndalimit në stacion policor deri më 12 muaj.

Në vitin 2011, ekipi i MPN-së vizitoi tre burgje dhe një ent edukues-korrektues. Në njërin nga burgjet kishte një person të mitur të paraburgosur i cili ishte vendosur vet dhe ndaj të cilit, për shkaqe sigurie, zbatohet video-monitorim i pandërprerë. Për shkak të situatës me vendosjen e personit të mitur (i vetëm në dhomën e paraburgimit) ekziston shqetësim për ruajtjen e gjendjes psiko-fizike të personit, sepse kohën në paraburgim e kalon i vetëm, pa kontakte me persona tjerë (përveç shërbimeve të burgut, mbrojtësit dhe vizitës nga familjarët), pa kontakte me moshatarë, pa aktivitete të organizuara të cilat në mënyrë produktive do ta plotësonin kohën e kështu me radhë. Në këtë pjesë, edhe pse standardet ndërkombëtare kërkojnë ndarjen

³³ Rregullorja për mënyrën e kryerjes së punëve policore ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 149/2007,110/2011)

e personave të mitur nga personat e moshës madhore, nevojitet gjetje dhe aplikim i masave shtesë me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe integritetit personal të personit të mitur.

Vitin e kaluar MPN-ja vizitoi Burgun Ohër, institucion ndëshkues-ko-rrektues në të cilin vendosen të rinjtë e moshës madhore dhe personat e mitur meshkuj, të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm me burgim për të mitur, si dhe persona meshkuj dhe femra ndaj të cilëve është përcaktuar paraburgim nga juridiksioni i gjykatave themelore: Dibër, Ohër dhe Strugë, përveç paraburgimit të përcaktuar për vepra penale për të cilat është përcaktuar dënim me burgim prej më së paku 10 vjet ose burgim i përjetshëm. Dënimi, burgim për të mitur, mund të shqiptohet për të mitur më të rritur me përgjegjësi penale, i cili ka kryer vepër penale për të cilën është shqiptuar dënim me burgim prej pesë vjetësh ose dënim më i rëndë, nëse vepra është kryer nën rrethana veçanërisht të rënduara dhe me shkallë të lartë të përgjegjësisë penale të kryerësit.

Përkufizimi ligjor dhe përcaktimi i dënimit me burgim për të mitur fillon nga momenti kur kryhet vepra penale, e jo nga momenti i zbatimit të dënimit, me ç'rast në institucion të posaçëm për të mitur, ku ekzekutohet dënimi me burgim për të miturin, vendosen edhe personat deri në moshën 23 vjeçare, të cilët janë persona të moshës së re madhore dhe nuk i përkasin kategorisë së personave mitur. Në këtë mënyrë vjen deri në përzierjen e personave të mitur dhe të moshës madhore, si dhe rreziku nga ndikimi negativ në procesin e risocializimit të personave të mitur deri në moshën 18 vjeçare. Zgjidhja më e mirë do të ishte të bëhej ndarja e plotë e personave të mitur nga personat e moshës madhore, përkatësisht vendosja nëpër institucione të veçanta, por duke u nisur nga fakti se personat e mitur, të dënuar me burgim për të mitur, janë në numër shumë të vogël, si solucion adekuat për mbrojtjen e personave të mitur është ndarja e tyre nga personat e rinj të moshës madhore në vet institucionin.

Gjatë vizitës së ekipit të MPN-së në burgun për të mitur, kishte vetëm një person të mitur i cili ishte vendosur në Repartin e Mbyllur bashkë me personat e rinj të moshës madhore. Në Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për zbatimin e procedurave gjyqësore ndaj të miturve³⁴ ceket se të miturit në burgje duhet të vendosen ndaras nga personat e rritur, në institucione të veçanta ose në pjesë të veçanta të institucionit në të cilin janë vendosur të burgosurit e rritur.³⁵ Rregullat e KB-së për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria përcaktojnë se "në të gjitha vendet e privimit nga liria, të miturit duhet të ndahen nga personat e rritur, përveç në rastet kur janë pjesë e familjes".³⁶

³⁴ Të ashtuquajtura Rregulla të Pekinit të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e KB-së në vitin 1985

³⁵ Kapitulli 26, pika 3 nga Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për zbatimin e procedurave gjyqësore ndaj të miturve

³⁶ Pika 29 nga Rregullat e BE-së për Mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria

Edhe në Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve, shfrytëzohet terminologjia të miturit e dënuar, të cilët detyrimisht dënimin për të mitur e vuajnë në institucion të veçantë për të mitur. Duke e pasur parasysh se burgimi për të mitur shqiptohet për të mitur më të madh me përgjegjësi penale (i cili në momentin e kryerjes së veprimit ka mbushur 16 vjet), për dënim me burgim prej pesë vjet ose dënim më të rëndë i cili nuk mund të zgjatë më shumë se dhjetë vjet, realisht ekzekutimi i dënimit të burgimit për të mitur, në masë më të madhe i përfshinë personat më të rinj të moshës madhore, të cilët mund të qëndrojnë në institucion të njëjtë deri në moshën 23 vjeçare. Prandaj, nevojitet harmonizimi i legjislacionit me rregullat dhe standardet ndërkombëtare, me ç'rast gjithnjë duhet të merret parasysh interesi më i mirë i të miturit në procesin e risocializimit të tij dhe të sigurohet ndarja e të miturve nga personat e moshës madhore të cilët janë privuar nga liria.

Në burgun për të mitur nuk zbatohet procesi arsimor, e as nuk mbahen punëtori profesionale dhe trajnime për profesione të ndryshme të cilët janë tejet të rëndësishëm për procesin e risocializimit të personave të mitur.

Gjatë vizitës në Entin Ndëshkues-Korrektues u vu re gjendje e njëjtë e cila nuk mundëson proces edukativ-arsimor. Qëllimi i ekzekutimit të masave edukuese është që përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes, si dhe përmes arsimit dhe edukimit të të miturve - kryerës të veprave penale, t'u sigurohet zhvillim i drejtë i personit të tyre. Arsimi i detyrueshëm fillor dhe i mesëm nuk realizohet në kuadër të Entit Edukues-Korrektues Tetovë. Marrë në përgjithësi, ky është problemi më i madh i Entit kur kemi parasysh se arsimit fillor dhe i mesëm janë të detyrueshëm. Së këtejmi, nuk respektohen rregullat ligjore për organizimin e arsimit të detyrueshëm fillor dhe të mesëm si pjesë e sistemit të përgjithshëm të arsimit dhe edukimit. Sipas nenit 311 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, puna në Entin Edukues-Korrektues organizohet në atë mënyrë që personit të mitur t'i sigurohen kushte për edukim dhe arsimit fillor dhe të mesëm, për zhvillimin dhe fitimin e shprehive pozitive, vlerave dhe attributeve dhe për profesionalizimin e punës dhe aftësimin e profesioneve të caktuara³⁷. Me këtë rast, në nenin 318 parashikohet që edukimi dhe arsimimi fillor, si dhe arsimimi i mesëm në EEK zbatohet me organizimin e mësimin të llojit përkatës, punëtorive dhe ekonomive për trajnim praktik. Personit të mitur mund t'i lejohet vazhdimi i shkollimit jashtë institucionit, nëse me sjelljen dhe angazhimin e tij është shembull për të tjetër. Në momentin e vizitës, vetëm një person ishte si ndjekës i mundshëm i mësimin me korrespondencë në shkollën për arsim të mesëm jashtë institucionit. Nuk ekziston nivel i kënaqshëm sa i përket angazhimit me punë të personave të mitur. Një numër i caktuar i personave janë angazhuar në pjesën e mirëmbajtjes së higjienës. Edhe pse në EEK janë të punësuar 6 instruktorë, angazhimet ekonomike-instruktoresh mungonin për shkak të mungesës së lokaleve adekuate ku do të mund të zhvillohej aktiviteti.

Gjatë vizitës, ekipi i MPN-së zhvilloi bisedë me personat e mitur dhe

³⁷ Neni 311, paragrafi nga Ligji për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 2/2006)

me personat e rinj të moshës madhore, të cilët në atë kohë ishin vendosur në Entin Ndëshkues-Korrektues³⁸, me ç'rast konstatoi se nuk ekziston ndarje e të miturve nga personat e rinj të moshës madhore. Gjendja e këtyre u konstatua edhe nga përgjigjet e Pyetësorit të dërguar nga Enti Edukues-Korrektues Tetovë, në muajit gusht të vitit 2011, në të cilin qartë është cekur se në Ent, në atë periudhë kanë qenë të vendosur 11 të mitur dhe 15 persona të rinj të moshës madhore.

Në vitin 2011, MPN-ja vizitoi edhe institucione për përkujdesjen e fëmijëve dhe të rinjve me sjellje problematike dhe probleme edukative-sociale. Me këtë rast u zbatua vizitë pa paralajmërim në Institucionin Publik për Fëmijë dhe të Rinj me Sjellje Problematike "Ranka Milanoviq", i cili konform kornizës ligjore kryen përkujdesje, edukimin dhe arsimimin fillor të personave të mitur me sjellje problematike të moshës nga 10 deri në 18 vjeçare, ndërsa arsimit mesëm sigurohet në institucione të veçanta arsimore. Të miturit kryesisht ishin të kënaqur nga veprimi i të punësuarve në institucion. Asnjëri nga fëmijët, me të cilët u zhvillua bisedë, nuk u ankua për trajtim të keq ose lloj tjetër të dhunës fizike nga ana e të punësuarve në institucion. Në këtë institucion ankesat shkonin në drejtim të sigurimit të mbrojtjes shëndetësore për shkak të vonësës së kartonëve të kaltër nga qendrat për punë sociale.

Edhe pse në këtë institucion, sikurse edhe në Institucionin për Fëmijë dhe të Rinj me Probleme Edukative-Sociale, zhvillohet procesi edukativ-social dhe procesi arsimor³⁹, megjithatë u vu re se ndërrimi dhe transferimi i shpeshtë nga institucioni në institucion i personave të mitur, e vë në pikëpyetje kualitetin e procesit të edukimit dhe riedukimit. MPN-ja konsideron se bartja e këtyre të miturve dhe kategorizimin tyre si: "të dhunshëm, të pashpresë dhe problematikë". Në këtë mënyrë nuk bëhet locimi thelbësor dhe sanimi i problemit për sjelljen e këtyre të miturve të kësaj kategorie të fëmijëve, të cilët gjithë jetën ose pjesën më të madhe të jetës e kalojnë nëpër institucione për mbrojtje sociale dhe jo rrallëherë përfundojnë në entin edukues-korrektues ose në burgjet për të mitur.

Ankesat kishin të bënin edhe me dhunën mes të përkujdesurve, me ç'rast shtrohet pyetja për masat parandaluese që i ndërmarrin shërbimet për reduktimin e sjelljes së këtyre, si dhe përgjegjësisë së drejtorisë së këtyre institucioneve për të siguruar mbrojtjen e të miturve të vendosur në këto institucioneve edukuese.

Në vitin 2011 MPN-ja e vizitoi edhe Qendrën e Pranimit për Vendosjen e Azilkërkuesve, ndërsa gjatë inspektimit vuri në pah se pjesa më e madhe e personave të mitur janë vendosur me familjet e tyre, përkatësisht prindërit,

³⁸ Në përputhje me nenin 40 të Ligjit për të drejtat e të miturve, në entin edukues-korrektues i mituri qëndron më së paku një vit, ndërsa më së shumti pesë vjet, përkatësisht deri sa të mbush moshën 23 vjet.

³⁹ Gjykata ose qendra për punë sociale, të miturin e vendos në institucion edukues që të kryhet mbikëqyrje e vazhdueshme nga ana e personave profesionist me qëllim të edukimit, riedukimit dhe zhvillimit të drejtë.

por gjithashtu u vërejt edhe një i mitur më i rritur i cili në Republikën e Maqedonisë kishte ardhur pa prindërit e tij.

Duke i pasur parasysh obligimet dhe standardet ndërkombëtare, të cilat rezultojnë për shtetit në kontekst të kësaj kategorie të personave (persona të mitur të pashoqëruar), MPN-ja konstatoi se personi nuk ishte vendosur veçmas nga personat e tjerë të rritur, e as nuk u njoftua se a i ishte caktuar kujdestar. Ligji për azil dhe mbrojtje të përkohshme parashikon dispozita të posaçme me të cilat e përforcon mbrojtjen e kësaj kategorie vulnerabile të personave, kështu që parashikon përcaktimin e kujdestarit, sa më shpejtë të jetë e mundur, në përputhje me Ligjin për familjen, si dhe interesat më të mira të fëmijës të merren parasysh gjatë vlerësimit të kërkesës për njohjen e së drejtës së azilit të personave të mitur pa shoqërim. Nga biseda e zhvilluar me personin e mitur u informuam se ai nuk e dinte se a i është caktuar kujdestar, ndërsa të punësuarit e Qendrës na informuan se veprojnë në përputhje me rregullat vendase, sa i përket sigurimit të kujdestarit për personat e mitur.

Përkatësisht, për këtë qëllim pas pranimit dërgohet kërkesë me shkrim pranë qendrës për punë sociale e cila e cakton kujdestarin, mirëpo në praktikë nuk ka ndodhur që ndonjëri nga personat e mitur, të vendosur në këtë qendër, të vizitohet dhe informohet nga kujdestari i caktuar për të drejtat e tij ose për rrjedhën e procedurës.

Përgjithësisht, në Republikën e Maqedonisë dispozitat ligjore të cilat e përkufizojnë këtë problematikë të veprimit dhe trajtimit të personave të mitur që janë privuar nga liria, si dhe personat e mitur të cilët janë vendosur në institucione tjera (të përkujdesur në institucione edukuese dhe të mitur të pashoqëruar azilkërkues), megjithatë nevojitet vëmendje më e madhe gjatë veprimit dhe zbatimit konsekuent të rregullave ligjore në praktikë, si dhe angazhimin të kuadrove profesional të trajnuar në mënyrë adekuate për veprimin me këtë kategori të personave.

Implementimi i tërësishëm i Ligjit për të drejtat e të miturve, si dhe standardevë ndërkombëtare për të drejtat e të miturve të cilët privohen nga liria, ose të cilëve u kufizohet liria e lëvizjes do të rezultonte me mbrojtje më të madhe të kësaj popullate vulnerabile, si dhe shkallë më të lartë të realizimit të të drejtave të cilat i kanë personat e mitur të privuar nga liria.

5 REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

Националниот превентивен механизам, согласно своите овластувања кои Меканизми Parandalues Nacional, në përputhje me autorizimet e veta të cilat përcaktohen nga OPKAT-it dhe Ligji për Avokatin e Popullit, pas çdo vizite të realizuar dërgon raport të veçantë i cili përmban analizë të detajuar të gjendjeve dhe masave konkrete për përmirësimin e mangësive dhe eliminimin e rreziqeve të identifikuar. Rekomandimet që i përmban ky raport paraqesin orientim të përgjithshëm, në përputhje me gjendjet dhe tendencat e konstatuara gjatë zbatimit të vizitave në 2011, ndërkaq me qëllim të veprimit preventiv të organeve të shteteve konkrete.

MPN-ja jep rekomandime të përgjithshme për gjendjen në vendet e privimit nga liria, si vijon:

Stacionet policore:

1. Ambientet e SPKP-ve për ndalimin e personave doemos duhet t'i përmbushin standardet minimale për vendosjen dhe mbrojtjen e personave të privuar nga liria. Ambientet detyrimisht duhet të jenë të pajisura në mënyrë adekuate, të kenë qasje të drejtpërdrejt në dritën natyrore, ventilim dhe ngrohje adekuate. Toaletet doemos duhet të ndërtohen në mënyrë dhe me materiale të cilët sigurojnë mbrojtje të plotë të personave të privuar nga liria sa u përket lëndimeve ose vetëlëndimeve.

2. Respektim i rigoroz i kohëzgjatjes së përcaktuar me Kushtetutë dhe ligje për privimin nga liria në procedurë policore. Në asnjë rast nuk guxon të tejkalohet afati kohor prej 24 orësh për personat e rritur, përkatësisht 12 orë për të miturit për të cilët ekzistojnë dyshime se kanë kryer vepër penale, llogaritur nga momenti i privimit nga liria.

3. Të përkushtohet vëmendje e përfurcuar gjatë veprimit dhe realizimit të të drejtave të popullatës së mitur duke e pasur parasysh vulnerabilitetin e posaçëm të kësaj kategorie të personave. Nevojitet pajisje shtesë materiale-teknike dhe ekipim kadrovik i stacioneve policore, si dhe trajnime në pjesën e zbatimit të Ligjit për të drejtat e të miturve për të gjithë të punësuarit në SPKP.

4. Për personat të cilët kanë shenja të dukshme të plagëve ose shenja të sëmundjeve, alkoolizmit ose substancave psikotrope, kontrolli mjekësor të ketë karakter të detyrueshëm parandalues në mënyrë që të pengohen rreziqet e mundshme për lëndim ose vetëlëndim, ndërkaq me qëllim të mbrojtjes me kohë të gjendjes së tyre shëndetësore.

5. E drejta për ushqim dhe ujë duhet të rregullohet me ligj, bashkë me të drejtat e tjera të cilat u garantojnë personave të privuar nga liria, si dhe të caktohet zgjidhje sistemore për mënyrën e realizimit të kësaj të drejte e cila do të varet nga gjendja financiare e personit të ndaluar.

6. Tërësisht, në detaje dhe me kohë të plotësohen evidencat për personat e ndaluar, me theks të veçantë të procesverbalit për ndalimin e personit dhe procesverbalin për udhëzimin dhe realizimin e së drejtës për mbrojtës dhe të drejtave tjera. Çdo parregullsi ose paqartësi në evidencë lë hapësirë për dyshim në lidhje me veprimin e nëpunësve policorë ndaj personave të ndaluar.

7. Nevojitet unifikimi i praktikave të mira në mënyrën e udhëheqjes së regjistrave dhe evidencave dhe veprimin me personat e privuar nga liria në nivel të territorit të Republikës së Maqedonisë.

Institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe enti edukues-korrektues:

8. Mekanizmi Parandalues Nacional sugjeron nevojën për zbatimin e plotë të Rregullave Evropiane të Burgjeve, si dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e personave të privuar nga liria.

9. Me qëllim të pengimit të shfaqjes së dukurive të torturës ose formave tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues, si dhe parandalimit të vetëlëndimit të popullatës së burgjeve, nevojitet ndërmarrja me kohë e masave për analizimin dhe përcaktimin e të gjitha rrethanave në raste individuale, si dhe masave për përcaktimin e përgjegjësisë së kryerësve të mundshëm. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet programeve të posaçme për reduktimin e rreziqeve për vetëlëndimin e personave të privuar nga liria.

10. Respektim i rekomandimeve të organeve ndërkombëtare për shfrytëzimin e masës disiplinore "vendosje në dhomë izolimi" dhe kushteve në të cilat zbatohet e njëjta. Njëherësh, duhet të harmonizohet legjislacioni vendas me Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e personave të mitur të privuar nga liria, të cilat e parashikojnë ndalimin e plotë të zbatimit të masave disiplinore ndaj personave të mitur të cilat përmbajnë trajtim brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues, me ç'rast përfshihet edhe vendosja në dhomë izolimi ose çdo formë tjetër e ndëshkimit që do të mund ta vinte në pikëpyetje shëndetin fizik dhe mendor të personave të mitur.

11. Harmonizimi i kornizës ligjore me rregullat dhe standardet ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me personat e mitur ku potencohet ndarja e të miturve nga personat e moshës madhore të cilët janë privuar nga liria, me ç'rast çdoherë duhet të merret parasysh interesi më i mirë i personit të mitur.

12. Formimi i reparteve të pranimit në institucionet ndëshkuese-korrektuese të cilët do të të ishin fizikisht të ndarë nga repartet e tjerë me qëllim që të mundësohet proces kualitativ i pranimit dhe adaptimit, si dhe të reduktohet shkalla e infektimit kriminologjen.

13. Përmirësim i kushteve në repartet e burgjeve dhe paraburgimit ku

vendosen personat e privuar nga liria dhe reduktim i mbipopullimit, me qëllim të përmbushjes së parakushteve themelore për zbatimin e masës së paraburgimit ose masës edukuese e cila zbatohet në entet edukuese-korrektuese.

14. Në veçanti nevojitet mbrojtje shëndetësore e vazhdueshme dhe kualitative nëpër institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe edukuese-korrektuese konform rregullave të KB-së, Rregullave Evropiane të Burgjeve, Rekomandimit të Këshillit të Evropës, si dhe Rekomandimeve të Organizatës Botërore Shëndetësore, sipas së cilave njëri nga standardet kryesore të mbrojtjes shëndetësore në burgje është "njerëzit të cilët janë në burg i kanë të njëjtat të drejta të mbrojtjes shëndetësore sikurse çdokush tjetër. Personeli mjekësor duhet të veprojë me personat e dënuar si me pacientë, e jo si të paraburgosur".

15. Përkushtim më i madh ndaj arsimimit në institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe edukuese-korrektuese për shkak të rolit të tij në efikasitetin e procesit të risocializimit dhe riintegrimin përmes krijimit të programeve arsimore dhe kurseve profesionale, në veçanti tek popullata e mitur.

16. Rritje e angazhimit me punë të personave të privuar nga liria të cilët janë vendosur në INK dhe EEK me qëllim të risocializimit, veçanërisht në repartet e burgimit, si dhe respektim i parimit të angazhimit pandërprerë të personit të dënuar, me qëllim që të mos lihet hapësirë për ndikime të cilat do ta rrezikonin qëllimin e trajtimit.

17. Udhëheqje me rregull e evidencës së personave të privuar nga liria, si dhe plotësim me kohë dhe në mënyrë të plotë të regjistrave në të cilat evidentohej aplikimi i mjeteve të dhunës.

Vendet të tjera:

18. Përmirësim i organizimit të punës dhe zbatim i aktiviteteve në institucion për përkujdesje fëmijësh, me çka do të kontribuohet drejt rritjes së efikasitetit dhe qëllimit të procesit të edukimit, riedukimit dhe zhvillimit të drejtë të të përkujdesurve të mitur. Evidentim i të gjitha rasteve të dhunës fizike ndërmjet fëmijëve, dhunës ndaj ose nga të punësuarit ose personave të tretë dhe rasteve të vetëlëndimit, në regjistër të veçantë me qëllim të hulumtimit të tyre dhe marrje të masave konkrete.

19. Riparim dhe pajisje e kapaciteteve të vendosjes në institucionin për përkujdesje, edukim dhe arsimim i fëmijëve dhe të rinjve, me qëllim të përmbushjes së nevojave në drejtim të edukimit të suksesshëm, riedukimit ose përmirësimit të sjelljes së çrregulluar të fëmijëve të cilët vendosen në institucion, si dhe pajisje e ambienteve me dedikim shtesë për aktivitete të lira të fëmijëve.

20. Në institucionet për përkujdesje, edukim dhe arsimimin e fëmijëve dhe të rinjve të punësohet kuadër nga pjesëtarë etnisë përkatëse, të cilët do të veprojnë me strukturën etnike të fëmijëve shumicë të vendosur në institucion.

21. Rinovim i ndërtesës së parë të kapaciteteve për vendosje në Qendrën për Azilkërkues, me qëllim të tejkalimit të gjendjes ekzistuese me kushtet joadekuate për vendosjen e azilkërkuesve.

22. Ndarje e personave të mitur të pashoqëruar nga personat e moshës madhore në Qendrën për Azilkërkues, si dhe ndarje dhe vendosje veçmas të personave të gjinisë femërore dhe nënave të vetme (përveç tek vendosjet familjare).

23. Sigurim i informatave të detajuara dhe me kohë për rendin e shtëpisë në Qendrën për Azilkërkues në gjuhën të cilën e kuptojnë, përmes përkthimit të rendit të shtëpisë në disa gjuhë të cilat përdoren më së shpeshti nga azilkërkuesit.

24. Formim i një formulari të posaçëm për ankesa dhe regjistër të veçantë për ankesa me gojë dhe formim i protokollit për veprim gjatë dhunës fizike dhe incidenteve ndërmjet personave të vendosur Qendrën për Azilkërkues.

25. Vendosje e koordinimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme, në aspekt të lëshimit me kohë të dokumentit për identifikim të azilkërkuesit, në përputhje me nenin 40 të Ligjit për azil dhe mbrojtje të përkohshme.

26. Përmirësim i mbrojtjes shëndetësore të azilkërkuesve përmes zgjidhjes së statusit të mjekut nga praktika e përgjithshme, punësimit të infermieres me orar të plotë pune dhe rritjes së mjeteve financiare për mjekim dhe kontrolle specialistike.

6 PIKËPAMJE PËRFUNDIMTARE

Parandalimi luan rol të rëndësishëm në luftën kundër torturës dhe formave tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor dhe ndëshkues. Vetëm përmes mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, të cilët kanë qenë viktimë të torturës ose trajtimit jonjerëzor, pa i vënë në pah me kohë rreziqet e mundshme, mangësitë dhe zbrazëtirat në legjislacion, nuk do të realizohet objektivi të cilin e kemi vendosur. Parandalimi dhe mbrojtja janë dy procese komplementare dhe paralele, të cilat vazhdimisht duhet të plotësohen dhe koordinohen në drejtim të çrrënjësjes së tërësishme të torturës. Vetëm përmes aktiviteteve parandaluese, të mbështetura me masa të ndërmarra në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të personave të ekspozuar në torturë, do të arrijmë ta mposhtim torturën si formë serioze të cenimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe do të sigurojmë ndëshkimin e kryerësve të këtyre veprave dhe do të vendosim sistem i cili do ta reduktojë rrezikun për recidivizmin e tyre.

Mekanizmi Parandalues Nacional për një kohë të shkurtër arriti ta gjejë vendin e vet në Republikën e Maqedonisë, ndërsa kompetencat dhe mandati i tij janë të njohur për organet e pushtetit të shtetit. Rezultatet e para, tanimë janë të dukshme – në vitin 2011 janë realizuar 18 vizita parandaluese dhe janë hartuar raporte të veçanta me rekomandime përkatëse, të cilat u janë dërguar organeve dhe institucioneve kompetente. MPN-ja ka kompetencë të pamohueshme që përmes zbatimit të vizitave t'i pasqyrojë gjendjet reale në vendet e privimit nga liria, të bëjë analizë për mangësitë e konstatuara dhe të propozojë rekomandime konkrete dhe të realizueshme me qëllim të përmirësimit të gjendjeve në ato vende. MPN-ja përmes vendosjes së dialogut konstruktiv do ta ndjek gjendjen në lidhje me zbatimin e rekomandimeve nga ana e organeve dhe institucioneve të shtetit.

Shteti ynë e ka për detyrë t'i vë në dispozicion resurset e nevojshme njerëzore dhe materiale-teknike, të domosdoshme për funksionimin normal të Mekanizmit Parandalues Nacional, i cili punon në kuadër të Avokatit të Popullit. Në këtë kontekst dhe me qëllim të përfundimit të kapacitetit të Mekanizmit Parandalues Nacional, nevojitet sigurimi i kushteve përkatëse të cilat do t'i mundësojnë zhvillim adekuat, për të siguruar objektivitet dhe profesionalizëm në punën e tij, ndërsa ato janë:

- pavarësia e plotë operative dhe financiare e MPN-së, përmes sigurimit të parakushteve të domosdoshme materiale-teknike, resurseve njerëzore dhe mjeteve buxhetore;
- sigurimi i karakterit multidisiplinar të vizitave, këqyrjeve dhe bisedave me personat e privuar nga liria përmes përfshirjes së ekspertizës së

jashtme profesionale nga fusha e: mjekësisë, psikologjisë, punës sociale; dhe

- shfrytëzimi i kapaciteteve të sektorit civil në Maqedoni, në bashkëpunim dhe me autorizim të Avokatit të Popullit, të ndërmarrin disa nga kompetencat e Mekanizmit Parandalues Nacional.

Aneksi 1: Pasqyra e aktiviteteve të Mekanizmit Parandalues Nacional në vitin 2011

Data	Vendi	Aktivite	Pjesëmarrës	Organizator
01.04.2011	Shkup	Fillimi i aktiviteteve nga ana e MPN	tre këshilltarë të MPN	AP i RM
prill/maj 2011	Shkup	Aktivite parapërgatitore dhe përpilimi i instrumenteve për punë	tre këshilltarë të MPN	AP i RM
10.05-13.05 2011	Shkup	Trajnim për realizimin e vizitës parandaluese në stacion policor, në bashkëpunim me përfaqësuesit e MPN të Spanjës	tre këshilltarë të MPN	Projekti "Tuining" në bashkëpunim me AP të RM-së
23.05-27.05 2011	Madrid, Spanjë	Vizitë studimore e MPN-së së Spanjës, vizitë në stacion policor, qendrën për të mitur dhe delikuent dhe burg	Ixhet Memeti, Anica Tomshiq Stojkovska dhe Donçe Boshkovski	Projekti "Tuining" në bashkëpunim me Ombudsmanin e Mbretërisë së Spanjës
01.06 -03.06 2011	Shkup dhe Prilep	Trajnim për realizimin e vizitës parandaluese të burgut në bashkëpunim me Ales Butala, ish-anëtar i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT)	tre këshilltarë të MPN	Misioni i OSBE-së në Shkup me AP të RM-së
10.06 – 11.06 2011	Ohër	Konferencë rajonale me temë: "Roli i Ombudsmanit në luftën kundër diskriminimit dhe parandalimit të torturës"	tre këshilltarë të MPN	AP i RM-së në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Shkup
14.06-16.06 2011	Talin, Estoni	Punëtori tematike me temë: "Grumbullimi dhe kontrollimi i informatave gjatë kohës së vizitës së realizuar nga Mekanizmi Parandalues Nacional"	Donçe Boshkovski	Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Ombudsmanin e Estonisë
22.06.2011	Shkup	Pres- konferencë promovimi i MPN-së	Ixhet Memeti, tre këshilltarë e MPN-së	AP i RM
30.06.2011	Shkup	Vizitë e MPN – Stacioni Policor Draçevë	tre këshilltarë të MPN	MPN
06.07-07.07 13.09. 2011	Shkup	Vizitë e MPN – Burgu Shkup	tre këshilltarë të MPN	MPN
13.07-14.07 2011	Shkup	Trajnim për realizimin e vizitës parandaluese në institucion psikiatrik në bashkëpunim me Dr. Vlado Ortakov, nënkryetar i parë i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT)	tre këshilltarë të MPN	Misioni i OSBE-së në Shkup në bashkëpunim me AP të RM-së
20.07.2011	Gostivar	Vizitë e MPN – Stacioni Policor Gostivar	tre këshilltarë të MPN	MPN
22.07.2011	Shkup	Vizitë e MPN – Stacioni Policor Çair	tre këshilltarë të MPN	MPN
26.07.2011	Koçan	Vizitë e MPN – Stacioni Policor Koçan	tre këshilltarë të MPN	MPN
16.09.2011	Shkup	Vizitë e MPN – Stacioni Policor Aerodrom	tre këshilltarë të MPN	MPN
20.09.2011	Gjevgjeli	Vizitë e MPN - burg	tre këshilltarë të MPN	MPN
28.09 – 30.09 2011	Manastir, Shtip dhe Tetovë	Tryeza të rrumbullakëta për të punësuarit në vendet e privimit nga liria, me temë: "Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional"	tre këshilltarë të MPN	MPN-ja në bashkëpunim me OSBE në Shkup
03.10-05.10 2011	Lubjanë dhe Murska Sobotë, Sloveni	Takim trepalësh i MPN-së: Sloveni, Shqipëri dhe Maqedoni dhe vizitë e përbashkët të burgut	Donçe Boshkovski Merita Aliu Alili	Këshilli i Evropës në bashkëpunim me MPN të Slovenisë
06.10-07.10 2011	Shkup	Konferencë me temë: "Përvoja komparative në fushën e privimit nga liria dhe roli i Avokatit të Popullit"	tre këshilltarë të MPN	Projekti "Tuining" në bashkëpunim me AP të RM-së
12.10.2011	Makedonski Brod	Vizitë e MPN – Stacioni Policor Makedonski Brod	tre këshilltarë të MPN	MPN

14.10 – 18.10 2011	Shkup	Vizitë pune e MPN-së së Spanjës të MPN-së të Maqedonisë	tre këshilltarë të MPN	Projekti "Tuining" në bashkëpunim me AP të RM-së
20.10 – 21.10 2011	Baku, Azerbajxhan	Takim tematik: "Mbrojtja e kategorive vulnerabile të personave në vendet e privimit nga liria"	Anica Tomshiq Stojkovska	Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Ombudsmanin e Azerbajxhanit
26.10.2011	Kumanovë	Vizitë e MPN – Stacioni Policor Kumanovë	tre këshilltarë të MPN	MPN
31.10.2011	Tetovë	Vizitë e MPN – Stacioni Policor Tetovë	tre këshilltarë të MPN	MPN
03.11.2011	Shkup	Tryezë e rrumbullakët për të punësuarit në vendet e privimit nga liria, me temë: "Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional"	tre këshilltarë të MPN	MPN-ja në bashkëpunim me OSBE në Shkup
08.11.2011	Kriva Pallankë	Vizitë e MPN – Stacioni Policor Kriva Pallankë	tre këshilltarë të MPN	MPN
10.11-11.11 2011	Gjenevë, Zvicër	Forumi Botëror për Protokollin Fakultativ të Konventës Kundër Torturës: Parandalimi i torturës dhe mbështetja e dinjitetit – nga angazhimet deri në aksion	Donçe Boshkovski	Asociacioni për Parandalimin e Torturës (APT)
11.11.2011	Shkup	Prezantim për rolin e MPN-së para studentëve të Universitetit Evropian	Anica Tomshiq Stojkovska dhe Merita Aliu Alili	MPN në bashkëpunim me Universitetin Evropian
16.11.2011	Tetovë	Prezantimi i rolit të MPN-së para studentëve të Universitetit të Evropës Juglindore	Merita Aliu Alili	MPN në bashkëpunim me Universitetin e Evropës Juglindore
17.11.2011	Ohër	Vizitë e MPN-së – Burgu Ohër	tre këshilltarë të MPN	MPN
21.11-24.11 2011	Varshavë, Poloni	Vizitë studimore e Mekanizmit Parandalues Nacional në Poloni, vizitë në stacion policor dhe qendrën për delikuent të mitur	tre këshilltarë të MPN	Ombudsmani i Republikës së Polonisë në bashkëpunim me MPN dhe Misionin e OSBE-së në Shkup
29.11.2011	Prilep	Vizitë e MPN – Stacioni Policor Prilep	tre këshilltarë të MPN	MPN
30.11.2011	Shkup	Prezantimi i rolit të MPN-së para studentëve të Fakultetit Juridik "Justiniani i Parë"	Donçe Boshkovski	MPN në bashkëpunim me Fakultetin Juridik "Justiniani i Parë"
02.12.2011	Shkup	Vizitë e MPN – Stacioni Policor Kisella Vodë	tre këshilltarë të MPN	MPN
06.12-07.12 2011	Lubjanë, Sloveni	Takim me personat për kontakt të Rrjetit Evropian të Mekanizmave Parandalues	Ixhet Memeti dhe Anica Tomshiq Stojkovska	Këshilli i Evropës
07.12.2011	Shkup	Prezantimi i rolit të MPN-së para studentëve të Universitetit FON	Donçe Boshkovski, Merita Aliu Alili	MPN në bashkëpunim me Universitetin FON
09.12.2011	Shkup	Vizitë e MPN – Stacioni Policor Bit Pazar	tre këshilltarë të MPN	MPN
12.12.2011	Shkup	Prezantimi i rolit të MPN-së para studentëve të Fakultetit për Siguri	Anica Tomshiq Stojkovska dhe Donçe Boshkovski	MPN në bashkëpunim me Fakultetin për Siguri
14.12.2011	Shkup	Vizitë e MPN-së – Qendra për Vendosjen e Azilkerkuesve	tre këshilltarë të MPN	MPN
16.12.2011	Veles	Vizitë e MPN-së – Enti Edukues-Korrektues Tetovë	tre këshilltarë të MPN	MPN
19.12.2011	Shkup	Vizitë e MPN-së – IP Enti për Përkudjesje, Edukim dhe Arsimit të Femijëve dhe të Rinjve "Ranka Milanova"	tre këshilltarë të MPN	MPN
21.12-22.12 2011	Mavrovë	Tryezë e rrumbullakët për gjyqtarë dhe praktikues të së drejtës me temë: "E drejta dhe praktika me refugjatët"	Donçe Boshkovski	UNHCR Shkup dhe Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve
26.12.2011	Shkup	Prezantimi i rolit dhe punës së MPN-së para përfaqësuesve të Ombudsmanit të Kosovës dhe sektorit joqeveritar	Ixhet Memeti dhe tre këshilltarë e MPN-së	MPN në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së të Kosovës

- vizita parandaluese

ANEKSI 2:

Formulari A

LISTA E KONTROLLIT (CHEKLIST) PËR PËRMBUSHJEN E STANDARDEVE, TË DREJTAVE DHE KUSHTEVE NË INSTITUCIONET NDËSHKUESE-KORREKTUESE (INK)

INK: _____

Data: _____

Koha e vizitës: prej _____ deri _____

HAPI 1: Bisedë me drejtorin e INK-së, zëvendës drejtorin ose me person tjetër udhëheqës

Ekipi, gjatë realizimit të vizitës, gjithmonë do ta respektojë rolin dhe funksionet e autoriteteve kompetente. Vendosja e respektimit të ndërsjellë me drejtorin dhe personat e tjerë udhëheqës në kuadër të institucionit ndëshkues-korrektues është themel për ndërtimin e dialogut konstruktiv dhe bashkëpunimit efikas.

Sa i përket **vizitës së paralajmëruar** biseda zhvillohet me drejtorin ose zëvendës drejtorin e INK-së dhe në përputhje me Propozim listën e pyetjeve dhe udhëzimeve për realizimin e bisedës me personat zyrtarë.

Sa i përket **vizitës së paparalajmëruar** biseda zhvillohet me personin udhëheqës me titull më të lartë, i cili në atë moment është në pozicionin më të lartë të hierarkisë në INK dhe në përputhje me Propozim listën e pyetjeve dhe udhëzimeve për realizimin e bisedës me personat zyrtarë.

■ Shfrytëzoheni formularin e mëposhtëm A.1.

HAPI 2: Vizitë në vendet e privimit nga liria

Vizita realizohet me qëllim të perceptimit të kushteve materiale për vendosje në institucionet ndëshkuese-korrektuese, kushteve në ambientet e për-bashkëta, ambienteve të punës dhe trajtimit të personave të privuar nga liria nga ana e nëpunësve të burgut.

Ekipi, i cili e realizon vizitën, me rastin e vizitës së kapaciteteve të vendosjes dhe ambienteve tjera, në veçanti do t'i kontrollojë rrethanat si vijojnë ⁴⁰:

1) Sa është numri i kapaciteteve/dhomave të vendosjes? _____.

2) A është siguruar për çdo person të dënuar krevat, dyshek dhe sh-troje? _____.

3) Mënyra e vendosjes nëpër dhoma dhe kapaciteti i tyre? _____.

4) Cili është numri maksimal i personave të vendosur në një dhomë gjumi⁴¹? _____.

5) A është madhësia e hapësirës sipas standardeve të SRT-së dhe dispozitës së LES (për një person 9 m³)?

Matni dhe shënoni parametrat: gjatësia: _____.

gjerësia: _____.

lartësia: _____.

6) A janë të pastra dhe të thata dhomat e vendosjes? Vlerësim i nivelit të higjienës. _____

7) A ka ndriçim adekuat (ndriçim me të cilin mund të lexohet)?

Po

Jo

Nëse përgjigjja është "Jo", përse nuk ka? Sqarim _____

8) A ka ndriçim natyror ose artificial? (rretho)

9) A ka kapakë ose tabela nëpër dritaret e dhomave të cilat e pengojnë depërtimin e dritës?

Po

Jo

10) A ka ventilim adekuat? (Sqarim) _____

11) A ka ngrohje adekuate të ambienteve?

Po

Jo

12) Regjimi i ngrohjes/freskimit. Sqarim _____

⁴⁰ Zhvilluar në përputhje me rekomandimet dhe standardet e KPT-së të cilët kanë të bëjnë me kushtet dhe trajtimin e personave në paraburgim dhe burg dhe legjisllacionin vendas.

⁴¹ Neni 104, paragrafi 3 nga LES – numri maksimal i lejuar 5 persona

13) A janë të mobiluara dhomat me pajisje për pushim (krevate, dyshekë, shtroje, jastëkë dhe batanije)

Po

Jo

14) A janë të pastra dhe në rregull pajisjet për pushim (dysheku, batanija, jastëku etj)?

Po

Jo

Pjesërisht

Sqarim: _____

15) Me çfarë elemente tjera janë të pajisura dhomat (komodina, tavolina, karrige etj.)?

Sqarim: _____

16) A ka veshmbathje adekuate sipas kushteve klimatike?

Po

Jo

17) Veshmbathja e personit të dënuar, në çfarë do qoftë mënyre, a ndikon në mënyrë degraduese ose nënçmuese?

Po

Jo

Sqarim: _____

18) A ka kushte themelore sanitare për mirëmbajtjen e higjienës personale në kuadër të dhomës? A ekziston nyje sanitare dhe në çfarë gjendje është?

Sqarim: _____

19) Në çfarë mënyre është bërë ndarja e nyjës sanitare nga pjesa tjetër e dhomës?

Sqarim: _____

20) Personat e dënuar a kanë në dispozicion mjete për higjienë?

Po

Jo

Nëse "Po", të njëjtat a sigurohen nga ana e shërbimeve të burgut ose nga vet personi _____

21) A i përmbushin standardet themelore dhomat e izolimit⁴²?

Po

Jo

Sqarim: _____

Nga fusha e marrëdhënieve të punës:

22) A janë të pajisura në mënyrë bashkëkohore ambientet dhe punëtoritë në të cilat punojnë personat e dënuar?

Po

Jo

Sqarim: _____

23) Në punëtori, a respektohen kushtet minimale teknike për mbrojtje gjatë punës?

Po

Jo

Sqarim: _____

24) Ambientet për punë a i përmbushin kushtet minimale për qëndrimin e personave të dënuar (ndriçim, higjienë, ventilim etj.)?

Po

Jo

Pjesërisht

Sqarim: _____

⁴² Ambienti në të cilin zbatohet ndëshkimi disiplinor dërgim në dhomë izolimi doemos duhet të jetë me madhësi prej më së paku 9 m³, të ketë dritë natyrore, të ketë nyje sanitare, ujë për pije, krevat me shtroje, tavolinë dhe të ketë ngrohje

Nga fusha e mbrojtjes shëndetësore:

25) Numri i personelit të trajnuar dhe kualifikimi i tyre-të përcaktohet aty për aty.

26) Orari i rregullt i punës i personelit shëndetësor _____ dhe a ka në dispozicion mjek për raste urgjente?

Po

Jo

27) Mbrojtja shëndetësore psikiatrike dhe stomatologjike - si realizohet në kuadër të institucionit?

Sqarim: _____

28) A respektohet parimi i barazisë gjatë mbrojtjes shëndetësore-dhënia e shërbimeve dhe trajtimit të njëjtë sikur për personat që janë në liri?

Po

Jo

Sqarim: _____

29) Gjatë pranimit, a kontrollohet detyrimisht personi nga mjeku?

Po

Jo

Sqarim: _____

30) Sa shpesh i mundësohet personit të dënuar vizita tek mjeku? Sistemi i vizitave të rregullta.

Sqarim: _____

31) Konfidencialitet gjatë kontrollit nga ana e mjekut - në çfarë mënyre sigurohet konfidencialiteti dhe ku ruhen raportet për gjendjen shëndetësore - kush ka qasje në këto dokumente?

Sqarim: _____

32) A kryen dhe sa shpesh kryen mbikëqyrje shërbimi shëndetësor sa i përket higjienës dhe rregullshmërisë së ushqimit?

Po

Jo

Sqarim: _____

33) Furnizimi me vegla, instrumente dhe medikamente mjekësore? Qasje deri te ambientet e ambulancës dhe qasje deri tek medikamentet?

Sqarim: _____

34) Mënyra me të cilën kryhen kontrollet?

Sqarim: _____ A merr pjesë në kontrolle

edhe shërbimi për sigurim i burgut?

Po

Jo

35) Trajtimi me kategoritë vulnerabile të të burgosurve (gra shtatzëna, adoleshentë, persona me çrregullime psikike, sëmundje të rënda)

Sqarim: _____

36) A i viziton mjeku-gjinekologu dhe sa shpesh i kontrollon femrat e dënuara?

Po

Jo

Sqarim: _____

37) Ambulanca dhe ambientet e tjera në të cilat bëhet mbrojtja shëndetësore a i përmbushin kushtet e përcaktuara me normat e përgjithshme?

Po

Jo

Sqarim: _____

Në pjesën e ambienteve të përbashkëta, kuzhina dhe ushqimi:

38) Ambientet për qëndrim të përbashkët, a i përmbushin kushtet minimale për qëndrimin e personave të dënuar (ndriçim, higjienë, ventilim etj.)?

Po
Jo
Pjesërisht
Sqarim: _____

39) A ekziston në institucion hapësirë dhe pajisje për sport dhe rekreacion?

Po
Jo

40) A kanë mundësi të ushtrojnë për çdo ditë në hapësirë të hapur në kohë të caktuar të ditës?

Po
Jo

41) A është i mbrojtur nga ndikimet klimatike rrethi/traseja për shëtitje?

Po
Jo

42) Sa kohë gjatë ditës personat e dënuar e kalojnë jashtë ambienteve të mbyllura?

Sqarim: _____

43) Furnizimi i bibliotekës me libra, revista dhe gazeta ditore:

44) A është ushqimi i shumëllojshëm dhe a është në përputhje me shprehitë kulturore dhe fetare të personave të dënuar?

Po
Jo

45) Kush e përpilon menynë për racionet ditore, kush e aprovon dhe a respektohet e njëjta?

Sqarim: _____

46) A kryen mjeku kontroll të rregullt të kuzhinës, ushqimit dhe higjienës të të punësuarve? Sa shpesh e bënë këtë?

Po
Jo
Sqarim: _____

47) A caktohet dhe a zbatohet dietë e posaçme për personat e sëmurë dhe gratë shtatzëna?

Po
Jo

Sqarim: _____

48) Kontrollimi i higjienës dhe mënyra e mirëmbajtjes së takëmit për ngrënie.

Sqarim: _____

49) A i është marrë ndonjërit nga personat e dënuar takëmi për ngrënie dhe për çfarë shkaqesh?

Sqarim: _____

50) Kontrollimi i higjienës dhe mënyrës së gatimit të ushqimit në kuzhinë.

Sqarim: _____

51) Kontrollimi i ambienteve të përbashkëta sanitare-niveli i higjienës, mirëmbajtja e dusheve etj.

52) A kanë të dënuarit ujë të nxehtë për të bërë dush dhe sa shpesh u lejohet bërja dush?

Po
Jo

Sqarim: _____

53) Kontrollimi i dhomave për larje/tharjen e rrobave

54) A janë të rregulluara dhe a kënaq higjiena e ambienteve për takime dhe ambienteve të tjera për qëndrim ditor?

Po

Jo

Pjesërisht

Sqarim: _____

Në pjesën e ndëshkimeve disiplinore dhe dhomën e izolimit:

55) A janë rregulluar shkeljet disiplinore me Rregullore të pushtetit administrativ kompetent?

Po

Jo

Sqarim: _____

56) A janë përcaktuar me ligj ose rregullore të veçantë llojet dhe kohëzgjatja e sanksioneve të cilat mund të shqiptohen?

Po

Jo

Sqarim: _____

